

BIBLIOTEKA

F

844-32

M 36

GJIROKASTËR

SHTETI

XHA FER  
MARTINI

*Fytyra  
e miqësisë*

---

tregime

## Pëllumbi përplaste krahët në ajër

Kishte rënë mbrëmja, një mbrëmje e butë dhe e ëmbël. Për pak kohë pushuan cijatjet e zogjve dhe ra një qetësi joshëse, që të dukej se nuk do të prishej kurrë. Dëgjohej veç gurgullima e ujit, që edhe ajo kishte diçka të veçantë, se lumi dukej si i lodhur. Shelgjet e verrinjtë ndanë tij kishin ndehur degët e njoma mbi valë sikur donin t'i përkëdhelnin.

Ajo kohë që ndan ditën me natën është e vogël, zgjat pak dhe është vështirë të matet. Më mirë atë e përcakton ndërrimi i ngjyrave dhe i dritave, i zhurmave dhe i zërave. Fletët e verrinjve në pragmbrëmje marrin një ngjyrë të kaltër, të errët, kurse kurorat e plepave ende ruajnë një ndriçim të ëmbël, duken si të verdheme. Poshtë, ndanë lumit, nata sikur vrapon e ngjyrat ndërrohen më shpejt. Lumi tashmë nuk është i errët si natën, as si qumësht i bardhë, si ditën, por merr një shkëlqim disi të verdhë, dhe, aty-këtu, duken ca purrinj të kaltër nëpër të.

Pasi nata të jetë bërë sunduese, fillojnë cijatjet e zogjve dhe zhurmat e kafshëve. Lepujt kanë rënë të flenë, grumbulluar në strofkat e tyre me

njërin sy hapur e tjetrin mbyllur, po dalin shqar-  
thi e dhelpira, nuselalat e vjedullat, derrat e egër  
dhe, tutje, në thellësi të pyllit, ujqërit. Nata nuk  
është prehje e qetësi për të gjitha qeniet e gja-  
lla.

Gjethet e gjelbra të misrave, që gjatë tërë di-  
tës kanë ndenjur të fishkura, gjallërohen e ma-  
rrin jetë, presin puthjen e ëmbël të vesës. Kur bie  
hëna, pikëzat e vesës duken si ca rruaza të vogla,  
të verdha. Tërfili i bardhë në atë sheshin pranë  
breglumit hap fletët, që dridhen vetiu. Nuk është  
era, që i bën të lëvizin, por vrulli jetësor dhe një  
hare e brendshme që ka qenë platitur nga vapa  
e madhe. Më shumë se lëvizje, ajo e fletëve të  
tërfilit është një dihatje e ëmbël, si një lutje për  
lumturi, që vjen e fashitet afër mëngjesit.

Lëndina që shtrihet gjatë tërë rriedhës së lu-  
mit është e mbushur me bar kali. Nga larg ajo  
ngjan me një fushë bilardoje, kaq e rrafshët dhe  
e butë është! Po në mbrëmje, duke ecur nëpër të,  
dallon ato udhëzat e holla, që janë sajuar nga  
këmbët e njerëzve, si vijat në pëllëmbët e duarve.  
Ke dëshirë të ecësh zbathur në këtë lëndinë, të  
prekësh barin e njomë me tërë shputat e këmbëve  
që korenti i gëzimit të ta dredhë shpirtin. Mi-  
dis lëndinës së bleruar kalon një rrjedhë uji e  
pastër që në muzg, bëhet krejt e kaltër.

Sa herë vete aty, malli i fëmijërisë më ndez  
të vrapoj këmbëzbathur. Matanë rrjedhës së  
ujit shtrihet fusha. Në ato vende kisha lindur, aty  
isha rritur, aty shërbeva si mësues për katër vjet  
me radhë pasi mbarova shkollën pedagogjike, aty  
u njoha dhe u dashurova me atë që tani është  
bërë gruaja ime. Pas mbarimit të fakultetit, më  
emëruan në qytet, po mua nuk më rrihet pa ar-  
dhur shpesh. Gruaja e diali kishin shkuar që në  
mëngjes në lagjen «Sushaj» matanë lumit, dhe

unë u kisha dalë para t'i prisja pikërisht në atë lëndinë. Ajo u duk me Andin për dore në urën e telit.

— Na prisje? — më pyeti gruaja sapo u afrua.

— Në këtë udhë të kam pritur gjithmonë, — i thashë.

Ajo buzëqeshi, dhe mua m'u duk se ishte pikërisht ajo buzëqeshja e takimit të parë. Vitet bëjnë të tyren, por buzëqeshjeve nuk kanë ç't'u bëjnë. Djali ka lindur në qytet dhe më shumë për këtë unë kam dëshirë t'ia tregoj vendet e mia të lindjes. Kjo dëshirë shpesh më kthehet në një këmbëngulje të çuditshme. E kapa Andin dhe e vura në krah.

— Ja, këtu kam kullotur lopët, — i thashë.

— Qumështin, që ne e marrim në dyqan, e bëjnë lopët.

Andi po vështronte lumin. Atë çast kishte dalë hëna nga qafa e malit dhe lumi vezullonte me ca reflekse të verdha.

— Babi, po lopa a hyn në lumë? — më pyeti ai.

— Hyn, si nuk hyn!

Një lakuriq nate, si një dardhë e madhe ishte varur kokëposhtë në një mollë që kishim pranë.

— U babi! Si rrika ky zogu! — tha Andi i habitur.

— Është lakuriq nate. — i shpjegova. — Kështu rrinë ata, kokëposhtë.

Pyetjet e Andit nuk kishin të mbaruar, por atë çast pranë nesh vrushulloi një dhëlpër me një lepur të vogël në gojë. Lepuri nuk bënte as gëk, as mëk, sado që dukej se nuk kishte ngrordhur. Ia pashë sytë e trembur nën dritën e hënës. Ata sy shprehnin tmerr. Andi nuk e kuptoi ç'kishte ndodhur dhe unë nuk pata dëshirë

t'ia tregoja, se në përralla lepurushët mbrohen nga kafshët e mëdha si ariu, elefanti etj.

— Ikim, se është vonë, — tha gruaja, — na presin. — Po mua nuk më ikej.

— Vështroje fushën me lakra, — i thashë gruas

— E çfarë?! Fushë me lakra është!

Në të vërtetë nuk ishte vetëm një fushë me lakra dhe aq. Ngastra me lakra nga njëra anë kufizohej me pyllin e vogël të shelgut të bardhë, nga ana tjetër me gardhin e dendur të hideve. Lakrat natën, nën dritën e hënës, kanë një bukurri të veçantë. Tutje, përtej asaj ngastre, ishte një tjetër me bostanë. Me Andin në krah dhe me gruan që më vinte pas, u futa në një udhëz të ngushtë që shkonte ndanë gardhit të hideve. Kurorat e plepave ndanë asaj rruge ndriçonin sikur të ishin përflakur nga një zjarr i padukshëm.

Poshtë, në fund të asaj udhëze, është një burim, që fshatarët i thonë «shtonë». Sa herë isha flladitur në vapën përvëluese tek ajo shtonë! Sa herë kisha ngrohur duart në ciknën e dimrit! Se ajo verës e ka ujin akull të ftohtë, kurse dimrit të ngrohtë, lëshon ca avuj të bardhë, të bardhë, si një mjegull e dendur. Tani ujin e saj e kanë futur në një lug druri dhe që nga lugu ai bie në një gur të rrumbullakët. Në dritën e hënës grimcat e ujit duken si miliarda xixëllonja që prushiten rreth e rrotull gurit.

— Këtu qenka bukur, — tha gruaja.

— E kuptove më në fund, — i thashë dhe qesha që të mos e fyeja.

Andi hyri me gjithë sandale llapaçupa nëpër ujin e shtonës. Ai po bërtiste nga gëzimi, kur dikush, që prapa krahëve tanë, thirri:

— Ej, kush është aty?

Zëri ishte i trashë, por i ngrohtë. Unë e njoha

menjëherë atë zë, megjithëse kisha kohë pa e dëgjuar. Ishte roja e natës, Sherifi.

— Jam unë me gruan e djalin, — thashë.

Edhe ai ma njohu zërin.

— Ti, Xhelo, je? Po ç'paske dalë këndeje natën?

— A nuk jam rritur këtu?

Sherifi nuk foli, veç tundi kokën e ra tatëpjetë për të zbritur te ne. Është një burrë i gjatë, shpatullgjerë, me flokët krejt të thinjur, që i duken si bashkë leshi.

— Këtu je rritur, o të pastë Sherifi, — tha ai po me atë zë të ngrohtë e të dashur. — Bën mirë që nuk i harron këto vende. Ja, ma njohe dhe ta njoha zënë. Kjo është gjë e madhe, djalë!

U përqafuam me mall.

— Bën mirë që bie edhe djalin këndeje, — tha pas pak Sherifi si i menduar. — Ah, sikur të jentonte Banushi i shkretë!

Banush e kanë quajtur babanë tim. Atë e vranë njerëzit e beut. Këtë, natyrisht, e di edhe grua-ja. Ia kam treguar unë, ia kanë treguar edhe të tjerët. Por unë kisha dëshirë që t'ia tregonte Sherifi, dëshmitari i vetëm i asaj ngjarjeje. Sherifi sikur e kuptoi dëshirën time.

— Ka qenë korrik atëherë, — tha ai. — Misrat po na digjeshin për ujë, por uji ishte i beut. Unë e Banushi e bëmë me fjalë që natën ta futnim ujin në arat tona. Morëm shatat e drejt e te shtëna. Po na diktoi ai qeni, Kurt Kerri, qehajai i beut. Banushi ishte te sfrati kryesor, unë më poshtë, për t'i hapur udhë ujit. Dëgjova një zhurmë të mbytur. Shkova pas asaj zhurme. Kurt Kerri e kishte goditur Banushin me qytën e pushkës mu në kokë. Po Banushi ishte i fortë dhe e mbajti. E pushë vetë kur ngriti shatin dhe e goditi Kurt Kerrin mu në ballë. Gjaku, vuuu, qafi-

rit. Lëshoi një britmë si derri kur i fut thikën pas veshit. Po nuk thonë kot që bisha, kur plagoset bëhet më e rrezikshme. Ngriti pushkën dhe e qëlloi Banushin. Si bëri krimin, iku... Banushi ra sa gjerë-gjatë në ujin e shtonës... ja, mu aty, tek ai guri i rrumbullakët. Ti linde pas gjashtë muajsh, — më tha ai mua. — Tani vendi është bërë pëllëmbë e flori e ti bën mirë që i shikon këto vise.

Gruaja psherëtiu. Tregimi i Sherifit e kishte prekur. Në gropat e syve i shndritnin lotët. Sherifi vajti aty ku Andi luante me stërkalat e valëve. E mori në krah, i lëmoi flokët.

— Hajde të të japë gjyshi bostan, — i tha. Dhe me Andin në krah kaloi nëpër shtegun e ngushtë midis shkorreteve me lajthi e dushk dhe doli në udhëzën e butë të fushës. Unë dhe gruaja i ramë pas. Gruaja tani, siç dukej, ishte e gatshme të ecte tërë natën nëpër gjurmët e fëmijërisë sime. Ndanë ngastrës me bostan ishte fidanishtja e plepave. Nga larg, e larë me dritën e hënës, ajo dukej si gruri që është pjekur e është bërë gati për t'u korrur. Pranë këmbëve tona u ngrit fluturimthi një tufë mëllenjash. Ato zunë vend në pyllin e vogël me lajthi, që e kishim në krahun e majtë.

— Ja, tani do të të japë gjyshi zemër shalqini, — i tha Sherifi Andit.

Hymë në një kasolle të vogël, ngritur me ca dërrasa e mbuluar me furda. Në të kishte një shtrat prej dërrase. Aty rrinte Sherifi. Ai shtroi një batanije në sheshin e bleruar dhe na tha të uleshim. Nxori thikën dhe preu një shalqi të madh. Një pjesë të zemrës së shalqinit ia dha Andit e pjesën tjetër gruas.

— Hani, — na u lut, — ju bëftë mirë! Nuk vjedh njeri, po roja duhet...

Gruaja, siç dukej, e kishte mendjen tek ato

që kishte treguar Sherifi, se rrinte si e nemitur.

— Qenka shumë i ëmbël, babi, — tha Andi.

— Po, bir, — i përkëdheli prapë kokën Sherifi, dhe na tha neve: — Këto të ëmblat të kujtojnë të hidhurat.

Pastaj ai u ngrit, i erdhi rrotull kolibes së vogël. Nuk po e kuptonim se ç'donte të bënte. U kthye me një pëllumb të vogël në duar.

— Merre, — i tha Andit. — Veç mos e mbytesh, se është i vogël. Edhe ky ka nënë e baba dhe e kërkojnë.

Sherifi i lidhi pëllumbit një gjalmë për këmbë dhe pas gjalmit një krande jo të trashë.

— Luaj tani, se nuk të ikën dot, — i tha djalit dhe u kthye nga ne. Na vështroi në sy pak si gjatë. Tha:

— Ky tani ka moshën për të luajtur me pëllumba, por, kur të rritet, duhet t'i mësojë këto histori.

— Do t'ia tregojmë, — sikur nxitoi ta siguronte gruaja ime.

— T'ia tregoni, po, — ngulmoi ai. Ka histori që njerëzit e mësojnë në shkollë. Po të gjitha nuk vihen aty.

Në rrugë u dëgjua një zhurmë këmbësh. Dikush ecte në rrugën midis gardhit të hideve e plepave të bardhë. Zhap-zhup, bënin këmbët e tij. Sherifi i qepi sytë në gjysmerrësirë.

— Qenka Merko Zepaj, — tha ai.

Ishte një bashkëfshatari ynë, në një moshë me Sherifin.

— Mbeti pa djalë Merkoja i shkretë, — tha Sherifi si me dhembje për të.

Ai vuri re tronditjen në sytë e mi e të gruas. Me një buzëqeshje të vrerosur tha:

— Jo, ore, jo! Nuk i ka vdekur djali. Atje, në Tiranë, është... Foli edhe në televizor një na-



të, e pashë... Goxha burrë kështu, në të parë... S'mora vesh se ç'tha, por djemtë më thanë se foli për një vend andej nga Afrika. Po, ore, mund të flasë ai për një vend andej nga Afrika, por këtu, në fshatin e lindjes, ka pesëmbëdhjetë vjet që nuk ka shkelur. S'i ka parë babanë e nënën, bashkëfshatarët, fshatin, lumin shtonën. Pse, të gjallë ma quan ti atë? Ore, po vdekja nuk është veç kur mbulohesh me dhé! Ka edhe vdekje për së gjalli, dhe kjo është më e keqja...

— Ke të drejtë, — i thashë, megjithëse më dukej sikur e tepronte pak.

— E ka fajin shkolla e madhe, — thumboi gruaja. Ajo kështu më thoshte mua shpesh dhe kësaj radhe me një gur deshi të vriste dy zogj.

— Shkollë për së prapthi? — u nxeh Sherifi.

Ai tundi krifën e bardhë të flokëve dhe ato çaste m'u duk si luan i egërsuar. U ngrit për të luajtur me Andin. Ne e kuptuam se nuk donte ta zgjaste më.

— Or xhani i gjyshit, — i foli butë e ëmbël Andit, — a e lëshojmë pëllumbin? Të thashë, e pret e ëma. Po ta mbash shumë, ajo do të bëhet merak e do të dalë për ta kërkuar. Po ruk e gjeti, do të fillojë të qajë.

— Qajnë pëllumbat, xhaxhi? — e pyeti Andi.

— Qajnë, si nuk qajnë?! Edhe guri e druri qajnë, more bir, e jo më gjëja me shpirt... Dhemb e shkreta zemër... E lëshojmë tani?

— E lëshojmë, — tha djali.

Andi ia zgjidhi vetë gjalmin dhe, si e mbajti disa çaste në duar, e lëshoi pëllumbin. Pas pak pëllumbi përplasi krahët e fluturoi drejt qiellit.

— Shkoi te **mami** i vet, — tha Andi me qejf të madh.

Mbetëm një copë herë duke e vështruar pëllumbin që përplaste krahët në ajër.

## Zbutësi i kanunit

Hajdar Murati rrinte në krye të vendit, mbështetur pas gurit të oxhakut. Cigaret i ndizte njëherën pas tjetrës. E reja, që hynte dhe dilte në dhomë, e kuptonte shqetësimin e të vjehrrit dhe i vinte keq.

— Të të bëj një kafe, baba? — e pyeti ajo.

— Më bjer takëmin ta bëj vetë, — tha ai.

Pranvera kishte ardhur, por ende bënte ftohtë. Hajdar Murati ngrihej nga shtroja, shkante te dritarja dhe shikonte thanën që kishte lulëzuar. Sesi i vinte... «Si është kjo jetë», mendoi. «Çfarë prisja unë dhe çfarë më doli.» Hajdar Murati i gëzohej kohës së mirë, pranverës që po vinte. Shpesh dilte në arë, gërmonte me bel dhe merrte një grusht dhe. E shtrëngonte në duar. Ftohtë, ende nuk është bërë për farë, mendonte. Po toka duhej pluguar dhe bërë gati. Ai nuk kishte qe, po do të shkante te Mustafë Sara e do t'i thoshte t'i bënin qetë pendë, se edhe Mustafa kishte vetëm një ka.

Hajdari atë ditë, së bashku me të birin, Fat-riun, nxorën plehun nga ahuri, mbushën koshat dhe i çuan në arë. Dyzet kosha pleh, numëroi pla-

ku. Do të bëhet misri. Atij i qante zemra për ujë. Ujë kishte pak, por do të bënte si të bënte. Me dy ujitje pas xhufkimit ara do të jepte aq misër, sa ta shtynin nja gjashtë muaj. Po gjashtë muaj bukë ishin gjë e madhe për Hajdar Muratin. I kishte kaluar të gjashtëdhjetat por punës nuk i ndahej. Një javë rresht preu thupra shelgu në cekë e bëri gjerdhjet. Po të gjitha këto tani kishin marrë fund. Kishin marrë fund një mëngjes, nga një krismë. Tani ai dhe i biri do të mbylleshin brenda do të rrinin pa parë diellin dhe hënën, pa kapur parmendën dhe pa shkelur dheun, pa prashitur e lëruar. Kishin rënë në gjak bash kur toka kërkonte njerëz, kur vlaga po shtohej dhe fara priste të hidhej. Kishte rënë në gjak pa bërë gjak. Veç nga një krismë, nga një krismë një mëngjes.

E reja i solli takëmin e kafes. Plaku nuk e hapi fare kutinë e sheqerit. Do ta bënte të hidhur kafen, të hidhur pelin, si jetën e tij. Dyzet vjet më parë Birash Mena vrau gjyshin e Hajdar Muratit dhe i ati i Hajdarit, pas dy vjetësh, i vrau Menës djalin. Gjaku, si të ishte erë që fryn nga të katër anët, kalonte nga njëra familje tek tjetra. Hajdar Murati ishte katërmbëdhjetë vjeç kur ra për herë të parë në gjak. U mbyll brenda. Kur u bë gjashtëmbëdhjetë vjeç, i vdiq i ati. Kërkoi nga hasmi një javë leje për mort dhe ai ia dha. Vrasja kishte ndodhur për një arë, për një dje-rinin që u takonte të dy fiseve, por Birash Mena futi qetë dhe e bëri të vetën. Ai qe gjak për tokën, për bukën, mendoi plaku. Për tokën e për bukën, për mikun e për nderin, edhe vritet njeriu, edhe shuhet fisi. Atij iu kujtua se 13 vjet pas vdekjes së t'et i kërkoi leje hasmit për t'u martuar. Hasmi përsëri i dha leje. Vetëm një javë. Pas një jave Hajdar Murati u mbyll prapë në shtë-

pi. Vetëm natën dilte për të bërë ndonjë punë. Përsëri natë që kur ra në cekë për të bërë dru, hasmi e qëlloi, por kësaj radhe nuk mundi ta vriste, vetëm e plagosi. Hajdar Murati atëherë thirri plakun e mençëm, Bush Veselin, i cili tha se dy të shitueme<sup>1)</sup> ishin baras me një gjak. Edhe Menajt e pranuan atë që tha Bush Veseli. Ndër kohë, i pari i krahinës e thirri në valle burrash Bush Veselin dhe i tha se po zbuste kanunin, që kishte mbajtur paqen dhe qetësinë në male. Po farohemi, i kishte thënë Bush Veseli, edhe nëse e zbut kanunin, mirë po bëj. Që nga ajo ditë Bush Veseli u bë me dy emra. Madje emri i tij sikur u harrua dhe njerëzit e thërrisnin: zbutësi i kanunit.

Po tani, pas kaq vjetësh, Hajdar Murati kishte rënë prapë në gjak. Ai priste prapë Bush Veselin. Po Bushi nuk po dukej e plakut i shkonin sytë shpesh te thana që kishte lulëzuar. Thanja i kujtonte tokën e plehun që priste në arë, gjerdhet që duheshin ndrequr, ugarin, farën, kurse ajo krismë atë mëngjes i kujtoi vdekjen. vdekjen për së gjalli, sepse duhej të mbvullej brenda.

Dy ditë më parë i biri, Patriu, kishte marrë pushkën dhe kishte rënë në cekë për të gjuajtur. Kishte kaluar përmes një lëndine të bukur me vërrinj dhe kishte dalë në një rrafsh plot me lajthi. Kishte hyrë mes degëve të lajthive dhe kishte përgjuar. Poshtë tij, në një gropë, buronte një ujë i ftohtë, ku mbushnin ujë gratë e fshatit. Tutje, në ca plepa që ishin buzë burimit, u ndalën një tufë thëllëzash. Kur Patriu kishte zbritur poshtë për të marrë thëllëzën e vrarë, kishte gjetur te kroi të renë e Mustafa Carës. Nusja ishte bërë dyllë e verdhë. Qenka shtatzënë. mendoi

---

1) plagosje

Fatriu me keqardhje. Ai mendoi se bucela ishte e rëndë për atë grua që pritej të lindte.

— E, Nadire, u lodhe? — e pyçti nusen.

— U tremba, — tha ajo krejt e zbehtë. — Sekush qëlloi dhe më erdhi krejt e papritur.

— Më fal, Nadire, nuk e dija se kishte njeri te kroi, — tha Fatriu si i zënë në faj.

Nusja nuk foli, por vuri bucelën në shpinë dhe u nis për në shtëpi. Atje e kapën menjëherë dhembjet e lindjes. Pas pak lindi një fëmijë të vdekur. Qe djalë. Qenka trembur, tha plaka Xhile kur e mori vesh si kishte ndodhur. Gruaja shtatzënë trembet si fëmija në djep, tha prapë ajo. U mor vesh shkaku dhe një mëngjes Mustafa i çoi njeri Hajdar Muratit t'i thoshte se i kishte borxh gjakun. Hajdar Murati nuk e pranoi. Më pas Mustafa shkoi vetë te Hajdar Murati.

— Më ke gjakun, — i tha ai.

— E bëjmë kanun, pa kanun nuk e pranoj.

— Kanuni të rrëzon. A ke një vorbë me kos?

Hajdar Muratit iu duk e çuditshme kërkesa e tjetrit.

— Kam, — i tha, — por nuk po marr vesh përse t'u dashka vorba me kos!

— Për kanun më duhet!

Hajdar Murati shkoi poshtë në qilar dhe mori një vorbë me kos. Kosi ishte i paprekur.

— Nisemi, — i tha Mustafa dhe u ngrit i pari më këmbë. — Shkojmë te burimi dhe atje e shikojmë nëse më ke gjak apo jo. Kjo nuk bën hile, — tha Mustafa dhe preku vorbën me kos.

Shkuan te burimi. Mustafa e vuri vorbën atje ku dy ditë më parë kishte qëndruar nusja e djalit të tij, kurse vetë, së bashku me Hajdar Muratin, ndenjën aty ku kishte qëlluar Fatriu. Hajdar Muratit i dukej e çuditshme lidhja midis vorbës me kos dhe gruas shtatzënë, megjithatë i vin-

te mirë që kjo punë do të mbyllej qoftë edhe me një ndodhi pa kuptim.

— Merr pushkën dhe qëllo mbi kurorën e plepave, — i tha atij Mustafa. — Po u ça mahëza<sup>1)</sup> e kosit në vorbë, më ke gjakun, po nuk u ça, nuk më ke asgjë.

Megjithëse i dukej pa kuptim kjo gjë, kur ngriti pushkën për të qëlluar, Hajdar Muratit iu drodh dora dhe pushka iu duk tepër e rëndë. Qëlloi. Një palë djersë të ftohta ia mbuluan ballin. U nisën të dy për te vorba me kos. Mahëza ishte ndarë më dysh sikur ta kishte prerë njeri me thikë.

— Më ke gjakun. — i tha Mustafa. — Nusja ka dështuar nga e shtëna e pushkës së djalit tënd, ashtu siç u ça mahëza e kosit nga e shtëna e pushkës sate. Më ke gjakun.

— Ta kam, — tha Hajdari krejt i pasigurt.

Bënë një copë rrugë bashkë, derisa u ngjitën në kodër. Qëndruan disa çaste përballë njëri-tjetrit. U shikuan sy më sy, u shikuan pak gjatë. Ata e kuptuan se nuk do të shikoheshin më kurrë sy ndër sy, nuk do të shikoheshin kurrë kaq afër. Ata pas atij çasti do ta vështronin njëri-tjetrin përmes shënjestrës së pushkës. Hajdar Murati nxori kutinë e duhanit dhe, me duart që i dridheshin, bëri një cigare. Ia dha edhe Mustafës.

— Si shkoi kjo punë, — tha Hajdari. — Nuk më shkonte kurrë në mendje se do të hyja në gjak me ty, o Mustafë. Këto ditë desha të vija për kaun, ta bënim pendën edhe këtë vit...

— As mua nuk më shkonte në mend kjo gjë, por ja që ndodhi.

Hajdar Muratit iu kujtuan të gjitha këto duke qëndruar pranë zjarrit. U ngrit nga oxhaku dhe

---

1) Cipëza e hollë që zë sipër kosi.

shkoi prapë te dritarja. Rruga ishte e shkretë, veç thana tundte degët nga era e lehtë e pranverës. Plakut i shkuan sytë te pjeshka. Pjeshka ishte matanë dritares. Paska çelur. Kur çel pjeshka, fara duhet të jetë në tokë, mendoi. Atij i shkuan sytë te koshat e plehut që nxinin në mes të arës dhe i dukej se gjithçka që kishte ngjarë nuk ishte gjë tjetër veçse një ëndërr e ligë. Edhe kur u martua, qe praverë. Nuk u martua kot në pranverë. Edhe atëherë kishte lulëzuar pjeshka dhe toka priste farën. Njerëzit gjatë asaj jave këndonin në shtëpinë e tij, kurse ai punonte në ahur, nxirrte plehun për ta çuar në arë.

Bush Veseli erdhi pasdreke. Hyri brenda dhe u ul në njërin anë të oxhakut. Hajdari i bëri kafe dhe i dha duhan. Bush Veseli ishte një plak i hijshëm, trupdrejtë e shpatullgjerë. I kishte kaluar të gjashtëdhjetat, por kishte një energji të pashuar. Jetën e kishte kaluar si bujk, por tokë kishte pak. Nuk bënte më shumë se tre muaj bukë. Njerëzit e ndihmonin, se ishte njeri i mirë dhe i ndershëm dhe, sa herë ndodhte ndonjë grindje, ai shkonte për t'i pajtuar.

— Na gjeti kjo e keqe, — i tha Hajdar Murati.

Bush Veseli të frymëzonte besim dhe, tani që erdhi ai. Hajdarit i dukej se gjithçka do të rregullohej për bukuri dhe vrasje të reja nuk do të kishite.

— I lajmërove Sarallarët? — pyeti Bushi.

— I lajmërova, por nuk besoj të vijnë. Mustafa e ka ndarë me të vetën.

— Do të vijnë, do të vijnë, — tha Bush Vese-

Vërtet pas një ore Sarallarët u dukën në udhën e ngushtë. Bashkë me ta erdhën edhe disa fshatarë të tjerë.

— E drejta qoftë me ty, Bush Veseli, — përshëndeti më plaku i Sarallarëve.

— E drejta qoftë me të gjithë, — ia ktheu Bush Veseli dhe i lëshoi plakut të Sarallarëve kutinë e duhanit.

Hajdar Murati bëri kafet. Duke pirë kafen, u bë një heshtje e thellë. Të gjithë sa ishin aty prisnin të fliste Bush Veseli, bashkëfshatari i tyre i mençur dhe i urtë.

— Ju thirra ta pleqërojmë mirë atë punën e gjakut, — u tha ai Sarallarëve.

Mustafë Sara u drodh dhe u zbeh në fytyrë, njëri krahu i mustaqeve iu var poshtë.

— Ne u ndamë njëherë, o Bush Veseli, — tha ai.

— I zoti i së keqes nuk është zakon të flasë i pari, — tha Bush Veseli.

— Po mua më dhemb zemra, o Bush Veseli.

— Zemra na dhemb të gjithëve sa kemi ardhur këtu, — tha plaku i Sarallarëve me qortim për Mustafën.

— Unë them të mos merremi me vorba e me veksha, — tha Bush Veseli. — Nuk ndahet puna e gjakut ashtu.


— Kështu e thotë kanuni, — tha njëri prej Sarallarëve.

— Kanuni është si ujët e turbullt, burra, — tha Bush Veseli. — Po qe se nuk i vë ndonjë pritë përpara, të merr e të mbyt në det.

— Kanuni është kanun, — tha Mustafa.

— Plepit i bien gjethet, por kanunit i bien fjalët, — tha Bush Veseli. — Nuk ka shkelur kurrë këndeje kanuni, pa i hyrë ferra në këmbë.

40275





Kanuni na ka përgjakur, por edhe ne e kemi përgjakur atë. Pse të mos i vriten këmbët kanunit në këto male? Besa, boll vend me gurë e me shkrepë është.

— Ti, Bush, po thua se kanuni është plakur, — foli Mustafë Sara. — Po edhe në qoftë plakur, le të plakët. Po nuk dua që ai të plakët bash për krye të djalit tim.

— Po, besa, plakur është, — tha Bushi. — E ka plakur gjaku. Boll është derdhur gjak, Mustafë.

Plaku i Sarallarëve, që gjer atëherë kishte qenë për pajtim, kërceu sikur ta kishin shpuar një mijë gjilpëra. Ai ishte i urtë, por nuk falte kurrë. Tha:

— Ti, Bush, po na thua ta falim gjakun, a?

— Gjakun nuk keni përse ta kërkon. Gjakun kërkohet kur bëhet gjak. Nuk mund t'i dalësh njeriut në rrugë e t'i thuash: më ke gjakun!

Në këtë çast dikush trokiti në derë. Ishte Bamkë Smaçi, i dërguari i të parit të krahinës. Ai nuk u ul, por foli më këmbë, duke iu drejtuar vetëm Bush Veselit, sikur aty të mos kishte tjetër njeri.

— Bush Veseli, — tha ai, — ke fjalë prej agait që ta lësh rehat katundin e të mos e bësh çorbë derrash. Mos u ngatërro me kanunin, se kanunin e të gjitha këtu i bën Hasim Sheldia.

Bush Veseli nuk foli. Ai shikoi plakun, e Sarallarëve. Plaku kroi zërin sikur donte të këndonte.

— Thuaj agait, — i tha ai Bamkë Smaçit, — që Bush Veselin e kemi thirrur ne. I ndajmë vetë punët toña dhe agai nuk ka përse të përzihet.

— Unë pata fjalë vetëm me Bush Veselin, — tha Bamkë Smaçi.

— Ato që pate për t'i thënë, i the. Tani ik, — i tha atij Bush Veseli.

Bamkë Smaçi iku dhe burrat shikuan njëri-tjetrin.

— Të biem në ujdi, — tha Bush Veseli, — se ja, edhe agai do që ne të vritemi me njëri-tjetrin.

— Ujdi nuk ka, — tha Mustafë Sara. — Djali im kalbet në dhé.

Bush Veseli u ngrit më këmbë e tha:

— Burra, pas meje!

— Ne erdhëm për t'u marrë vesh, — tha plaku i Sarallarëve.

Po Bush Veseli kishte kapërcyer pragun dhe, siç dukej, nuk kishte ndër mend të kthehej më. Ai i mbajti këmbët në oborr. Kur pa se të gjithë i kishte pas, tha se dikush duhej të kishte pushkë me vete. Pushkë kam unë, tha Mustafë Sara.

Kaluan midis dy gardheve me hìde. Hidet lëshonin erë të mirë, por burrat nuk e kishin mendjen tek ato. Bush Veseli u ndal para shtëpisë së vet. Nusja e djalit të tij, që ishte shtatzënë, doli në derë dhe u çudit kur pa të vjehrrin me gjithë ata burra.

— Po na vijnë miq, nuse, — i tha ai së resë. — Po ti shko shpejt në krua dhe na mbush një bucelë me ujë të ftohtë.

— Mirë, baba, — tha nusja dhe, si vuri bucelën në krah, u nis.

Midis burrave kishte rënë heshtje dhe një hutim i përgjithshëm.

— Pas meje, — u tha burrave Bush Veseli.

Kur nusja humbi midis dy poreneve të larta, Bush Veseli dhe burrat e tjerë ia mbajtën nga korija me lajthi.

— Ç'po kurdis, o Bush Veseli, — tha njëri prej burrave.

Po ata që e kishin kuptuar mendimin e Bush Veselit, nuk ia vunë veshin asaj pyetjeje. Bush

Veseli kërkoi pushkën dhe Mustafë Sara ia dha. Ata tani ishin pikërisht te vendi ku kishte qëlluar Fatriu.

— E reja ime nuk e di që ne jemi këtu, — u tha ai burrave. — Unë po qëlloj me pushkë, po e gjeti gjë atë, Mustafë Sara ka gjakun, po nuk e gjeti gjë, gjak nuk ka...

Krisma e pushkës u ndje e thatë dhe e rreptë. Burrat u nisën prapë andej nga kishin ardhur dhe mbërritën në oborrin e Bush Veselit. U ulën nën hijen e arrës dhe prisnin. Sytë u rrinin nga rruga, nga do të vinte e reja e tij. Pas pak ajo u kthye me bucelë në krah, me mollëzat e faqeve gjak të kuqe nga hapi i shpejtë.

— Erdha, baba, — iu drejtua ajo të vjehrrit. — Uji është akull i ftohtë.

Bush Veseli shikoi burrat në sy, pastaj e ndali shikimin te Mustafë Sara. I tha:

— E ka fajin ena, Mustafë Sara. Kur ena është e mirë, kosi nuk priset. Gjak nuk ka.

— Nuk ka, — tha edhe Mustafë Sara.

— Paç jetë të gjatë e faqe të bardhë, o Bush Veseli, — tha plaku i Sarallarëve.

Muzg. Poshtë, te pylli i lajthive, u dëgjuan dy krisma pushkësh. Pushkë gjaku, tha me vete Hajdar Murati dhe doli te pragu.

— Eeeej -heeej, — u dëgjua një zë pas pak. — Kanë vrarë Bush Veselin ,oreee...

Lajmi që ishte vrarë Bush Veseli u përhap me shpejtësi në tërë fshatin. Burrat ranë tatëpjetë. Bush Veselin e gjetën ende gjallë, por në grahmat e fundit. Dikush tha që kishte parë Bamkë Smaçin duke rendur me pushkë në dorë. Plaku i Sa-

rallarëve e ktheu Bush Veslin në shpinë, i rregulloi duart dhe i mbylli sytë. Kishte vdekur.

— Ky u vra që të mos vritemi ne, — tha plaku.

Burrrat mezi i mbanin lotët, por plaku i Sarajve i pa rreptë. Ai doli disi mënjanë dhe, për çudi, ia mori këngës:

*Bush Veseli, burrë mentar,  
Dy plagë gjoksit i ka marrë,  
Të mos derdhë gjak mileti,  
Ra si burrrat Bush Veseli.*

## Nuk mjaftojnë vetëm arkivat . . .

Ishim mbledhur pesë-gjashtë veta në njërën nga sallat e muzeut historik të rrethit. Muhedin Basha lëshoi një «tungjatjeta» dhe u ul në një karrige. Po diskutonim rreth një kumtese që bënë të fjalë për muhaxhirët dibranë në vitin 1913, kur Shqipëria sapo kishte dalë si shtet më vete, por, nga padrejtësitë e Fuqive të Mëdha, shumë toka shqiptare kishin mbetur në duart e shovinistëve fqinjë. Kumtesa jepte të dhëna interesante për dramën e muhaxhirëve, pjesa më e madhe e të cilëve kishte gjetur strehim dhe mikpritje në zonën e thellë malore të Luranës. Por, midis të tjerash, hartuesi i kumtesës sillte të dhëna se në Luranë ishin strehuar dhe mirëpritur edhe banorë nga rrethi K., i cili gjeografikisht është mjaft larg nga ky vend. Ne, pra, po haheshim, si thonë, me njëri-tjetrin, ndërsa Muhedin Basha, mbi të pesëdhjetat, lulishvar i qytetit, por që shpesh vinte për të shërbyer edhe në lulishten e muzeut, dëgjonte me vëmendje të madhe.

— A mund t'ju ndihmoj edhe unë pak? — pyeti ai si me druajtje.

— Po he, — tha dikush nga ne. — Mos ke gje-

tur ndonjë dokument që provon se edhe nga rrethi K. të kenë ardhur njerëz në Luranë?

— Dokument nuk kam, — tha Muhedini dhe buzëqeshi sikur donte të na kërkonte të falur, — po desha t'ju tregoj një ngjarje që mbase ju hyn në punë.

Njëri nga ne bëri një gjest mërzie sikur donte të thoshte: «nuk ua kemi ngenë historive tani...» Muhedin Basha e vuri re, por, kur pa interesin e të tjerëve, ia nisi shtruar e shtruar, ashtu siç bisedon ai...

Viti 1953. Atëherë isha njëzet vjeç djalë dhe kryeja shërbimin ushtarak në rrethin K. Muaji gusht. Ishim katër ushtarë, komandanti dhe komisari. Prej një jave rrinim në malet e Ostrovicës. Ju e dini se unë jam nga Lurana dhe malet e Ostrovicës më hiqnin mallin e vendlindjes. Hanim ato që kishim marrë me vete, ushqime të thata. Një pasdite ishim ulur nën hijen e një pisehe. Pranë kishim një burim me ujë të kulluar. Pimë ujë dhe lamë fytyrat. Përballë nesh, si nja dy kilometra larg, pamë në një pllajë një tufë me dele. Deri aty ku ishim ulur, vinin meloditë e këmborëve. Edhe tufa e deleve më shuante mallin, se unë, para se të shkoja ushtar, bari kisha qenë. Edhe Trifoni, një ushtar trupmadh, shikonte delet.

— Më nxorën mallin e fshatit, — i thashë Trifonit për delet. — Edhe ti bari ke qenë? — e pyeta.

Sesi m'u tek ta pyesja, se e dija që Trifoni nuk kishte qenë bari. Por ai as që e kishte mendjen te pyetja që i bëra. Kishte menduar tjetër gjë Trifoni. E shprehu:

— Më ka vajtur mendja për mish! Të kem një qengj, ta rrjep e ta pjek në prush. Të ha e të ngopem dhe të pi ujin e krejt burimit. Oh, ç've-

te mishi në këto male dhe me këtë ujë të ftohtë!  
Trifoni ishte hamës i madh dhe unë qesha me zë të lartë.

— Ç'keni, ore, përse qeshni? — pyëti komisari, që ishte ulur pak më tej.

Trifoni ma bëri me shenjë që të mos i tregoja komisarit, po ku kishim gjë ne që ta mbanim përbrenda! Ia tregova ç'tha Trifoni.

— Ik, o barkderr, — i tha me shaka njëri nga ushtarët Trifonit. — Veç te mishi të rri mendja ty! Ti nuk duhej ta kishe emrin Trifon, por ujk.

Po Trifoni, që i pëlqente shumë edhe shakatë, qeshi e tha:

— Kur isha në repartin N., kisha një shok që e quanin Ujk. Për nder, nuk ju gënjej, Ujk e quanin. Emër i çuditshëm, por kështu e quanin.

— Uk e jo Ujk, — e korrigjoi komisari.

— E, e, drejt e ke, shoku komisar. Vërtet Uk. — tha Trifoni dhe shtoi: — Po e bukura dhe e çuditshmja këtu nuk është vetëm te emri, por te diçka tjetër...

— Po hë, — u bë kureshtar komisari.

— Për çudi, ky Uku, shoku komisar, — ia nisi më nge Trifoni, — nuk e hante mishin. «Uk bre, se po të ha mishi», i thosha unë dhe fap pirunin dhe ia merrja racionin përherë. Sa kam ndenjur në atë repart, kam ngrënë dy racione mish: timin dhe të Ukut! A nuk është çudi kjo?

Qeshëm të gjithë. Ec e mos qesh me Trifonin dhe mënyrën se si tregonte ai. Kur fliste për të ngrënë, ai ishte tërë ndjenjë, e bënte tregimin prekës, pak dramatik dhe ne, megjithëse e dinim se e hiperbolizonte si shumë, e dëgjonim me vëmendje.

— Trifon, kaq shumë dëshirë ke të pjekësh një qengj? — e pyeti komisari.

— Lëre, shoku komisar... për nder, nuk di ç'të them... Edhe kockat ia ha...

— Për çudinë e të gjithëve, komisari nxori në çast nga xhepi 3000 lekë të vjetër.

— Janë të tërëve këto para, —na shpjegoi ai. — I kam marrë nga arka e repartit që t'i përdorim sipas nevojave... Meqë Trifoni do mish, mish do të blejmë.

Kjo për ne qe një çudi, por Trifonit i shkëlqyen sytë në mënyrë të veçantë.

— Rrofsh, o komisar, — tha Trifoni dhe u ngrit e bëri sikur donte t'ia merrte një valleje.

— Me kaq para mund të blesh një dash, apo jo, Muhedin? — më pyeti mua një ushtar.

— Një dash jo, por një dele e blen kur të duash, — u thashë.

— Lutju atij bariut se mos na shet ndonjë dele, më tha komisari duke treguar me dorë tu-fën e dhenve në pllajën matanë.

Duhej të ishim dy veta, prandaj me mua erdhi Trifoni. Ai donte të vinte patjetër, se, megjithëse nuk merrte vesh nga shitja dhe blerja e berrave, kishte frikë mos bariu ma hidhte në pazar. Morëm pushkët dhe ramë teposhtë në një përrua. Nja dhjetë minuta ecëm përgjatë rrjedhës së tij dhe, si gjetëm një vend ku uji futej në lug, u hodhëm në shpatin e malit përballë. Ecëm rrugë pa rrugë, përmes një pylli të dendur. Pas pak dolëm në një lëndinë të bleruar, ku bari ishte gjer në gju dhe kishte disa mbështekna shumë të bukura. Pata dëshirë të ulesha e të rrija një copë herë në atë lëndinë, nën hijen e një mështekne që ishte pranë një burimi, po ku të linte Trifoni...

— Ik, orë, — më tha i habitur, — se nuk kemi ardhur për të ndenjtur hijeve. Nuk e kemi lidhur bariun, as dhentë. Krisin e ikin dhe piju lëngun parave atëherë...



U nisëm. Pasi bëmë edhe njëzet minuta rru-  
gë, dolëm në një pllajë tjetër, ku ishte tufa e de-  
leve. Të parët na ndien qentë. Ishin dy qen të më-  
dhenj, të murrmë. Trifoni u tremb dhe hapi bajone-  
tën e pushkës. Por unë, që i njihja qentë e stane-  
ve, i thashë të mos bënte marrëzira. Qentë e stane-  
ve janë shumë të zgjuar dhe të hetojnë nëse je vje-  
dhës e keqbërës, mik apo ndonjë kalimtar i rastit.  
Edhe ato sillen sipas rastit. Unë doja t'u tregoja  
qenve se po shkonim si miq. Prandaj i ndolla. Ata  
u zbutën disi dhe ecnin pa atë vigjilencën e mëpar-  
shme. Pas pak pamë dhe bariun. Ishte një plak  
krejt i kuq në fytyrë, sytë i kishte të zbërdhulët,  
kurse vetullat dhe flokët krejt të bardhë.

— Mirëdita! — e përshëndetëm sa u afruam.

— Mirë se vini! — na tha ai. — Ç'e mirë ju so-  
lli këndeje, or djema?

Trifoni ishte gjithë oreks. Ai i mbante sytë  
te dhentë dhe më binte me bërryl sikur donte  
të thoshte: thuaja shpejt ç'kemi për t'i thënë.  
Po e dija vetë se si duhej të veproja. U ula pranë  
bariut. Na pyeti dhe e pyetëm për shëndetin.  
Nxora paketën «Partizani» dhe i dhashë një ciga-  
re. Plaku nuk e mori. Tha se nuk e pinte, prandaj  
edhe nuk kishte për të na dhënë. Trifonin po e  
brente padurimi. Si bëmë muhabet një copë herë,  
ia thashë. Ai vuri dorën në ballë sikur po mendo-  
hej.

— Dashki të therni një mish, ë? — pyeti pla-  
ku sikur nuk e kishte marrë vesh se ç'donim.

— Po, — tha Trifoni, që rrinte si në ferra nga  
padurimi. — Të tuat janë dhentë? — e pyeti ai  
plakun.

— E, të miat, — u përgjigj tjetri sikur donte  
t'i thoshte: ç'do të thuash ti me këtë pyetje?

Pastaj ra një heshtje e shkurtër dhe mua m'u

mbush mendja që plaku nuk kishte për të na shitur asgjë.

— Po nga të kemi, or djalë? — më pyeti befas ai mua.

— Nga Lurana, — i thashë, pa i treguar rrethin, se unë vendlindjen time gjithnjë e kam menduar si shumë të njohur në tërë Republikën.

— Nga Lurana?! — u habit plaku. — Jo, more! Nga Lurana në malet e Ostrovicës...

Ai u gjallërua dhe sytë iu bënë të qeshur. Siç ishte i mbështetur në bërryl, u ngrit në gjunjë e po më vështronte me çudi. Nuk di si ta shpjegoj gëzimin e tij kur mori vesh se isha nga Lurana. Edhe Trifoni u gëzua shumë, se i dukej që puna e mishit mori për mbarë.

— Mos keni qenë në Luranë? — e pyeta.

— Mos kam qenë! — foli ai si me vete. — Kam jetuar një vit e gjysmë aty, or bir. Sa bukë e kripë kam ngrënë unë në Luranë, aq të mira të gjetshin ty, or bir. Bah, jetë, o jetë. Për besë, kurrë nuk do ta besoja që të takoja një luranas këtu në malet e Ostrovicës. Po nuk thonë kot se veç mali me mal nuk takohet... Qofsh me të mira, or djalë, se ma nxore disi mallin. Kam ngrënë bukë e kripë aty.

Trifoni më shkeli syrin.

— I kujt je në Luranë ti, o bir? — më pyeti plaku.

— I Nuredin Bashës, — u përgjigja.

Plaku brofi në këmbë sikur të ishte djalë i ri.

— Po luaj vendit, ore! — tha i habitur dhe fytyra iu këndell nga kënaqësia. — Si, ore, djalë i Nuredin Bashës qenke ti?!

U ngrita edhe unë më këmbë, pa ditur ç'të bëja. Trifoni u shastis fare dhe për herë të parë mbase nuk e pati mendjen te dëlja që do të blinim.

— Të të përqafoj, o bir, — më tha plaku dhe më hodhi krahët në qafë. — Hej, jetë, o jetë! Të takosh në malet e Ostrovicës djalin e Nuredin Bashës!

Më mbajti disa sekonda të shtrënguar në kraharor. Më fërkonte supet sikur të isha djali i tij që kishte vite pa e parë. Pastaj u ul. Ishte i përbotur dhe si i shushatur nga gëzimi. Dukej i lodhur dhe rrinte i heshtur.

— Jam Viku Baku, o bir, — më tha pas pak. — Ku erdhe e më gjete, mor të gjettë e mira! Po tamam në shtëpinë tënde kam jetuar unë në Luranë. Plot një vit e gjysmë. Si njeriu i shtëpisë! Po a është Nuredin Basha, o bir?

— I fortë, — i thashë.

— E pastë jetën të gjatë ai soj burri, — uroi plaku. Po ti nuk po i ngjake fare në rudë. I ngjake Faziles ti, o bir, të njoh mirë tani. Po si është Fazilja, more bir?

— Nuk rron, — i thashë dhe më hipi mallëngjimi. — Vdiq vjet!

— Obobo! Ç'kalb kjo tokë, — thirri ai dhe kapi kokën me duar. — Po si, ore, paska vdekur Fazilja?! Po ç'pati?

— Vdiq papritur, nga zemra, — i thashë.

— E po, të rroni vetë, — tha plaku i përbotur.

— Miqtë shëndoshë, — i thashë dhe atij iu bë shumë qejfi që fola kështu.

— Kemi rrojtur, o bir, i kemi bërë ballë së keqes. Nuk na shuan dot hasmët, — tha ai pas pak.

— Nuk na shuajnë, — tha edhe Trifoni gjithë vendosmëri. Atë e kishte prekur ajo që dëgjoi dhe tani nuk dinte si ta ndreqte atë sjelljen e paduruar të fillimit.

— Ju ikët nga bajonetat e sërbit, o bir, ne

nga të grekut, — tha Viku Baku. — Ikën fëmijët, gratë e pleqtë, se burrat që mbanin pushkë në duar e çuan gjakun gjer në gju për vatanë. Unë me familjen time erdha në Luranë. Kanë kaluar shumë vjet që atëherë, por mua më duket se ka ardhur sot... E mira dhe e keqja nuk harrohen kurrë. Kisha me vete nënën e sëmurë, gruan po të sëmurë dhe katër fëmijë. Po ti nuk i di këto, se ke lindur njëzet vjet më vonë. Asokohe më vdiq nëna. Vdekja si vdekja, o bir, por i vdekuri do nderimet e veta, se nuk është si ai miku, që, po nuk e prite mirë sot, e pret ndonjëherë tjetër. Vdekja një herë vjen dhe të mbetet peng për gjithë jetën po nuk ia bërë të vdekurit nderimet... E kisha nënë dhe një nënë ka njeriu. «Vëlla, — më tha Nuredin Basha, — na vdiq nëna!» Pa pa, si m'u dukën ato fjalë! M'u duk se ma ngritën nënën më këmbë dhe ma bënë prapë të gjallë. M'u hoq e keqja fare! «Po, vëlla, na vdiq», — i thashë Nuredin Bashës dhe iu hodha në qafë si ty tani. Ndenjëm disa çaste në kraharor të njëri-tjetrit dhe dëgjuam rrahjet e zemrave tona. Imja rrihte për Nuredinin dhe e Nuredinit për mua! Ishit të varfër edhe ju, o bir, por Nuredini theri kaun e vetëm dhe thirri tërë fshatin në mortin e nënës së vet, se nënë e bëri dhe ai. E qau tërë Lurana nënën time dhe e varrosi me të gjitha nderimet. Eh, o bir, a harrohet kjo?!

Ai pushoi një çast dhe mori frymë thellë. Kur i thashë që donim të blinim një dele, pata nxjerrë paratë. Ato vazhdonin të qëndronin në bar, pranë plakut, dhe mua sesi më vinte.

— U pa puna, — tha Viku Baku duke u ngritur më këmbë. — Bëjuni zë edhe atyre shokëve e gjithë sa jeni të vini sonte tek unë.

— Faleminderit shumë, — i thashë tepër i

— Të të përqafoj, o bir, — më tha plaku dhe më hodhi krahët në qafë. — Hej, jetë, o jetë! Të takosh në malet e Ostrovicës djalin e Nuredin Bashës!

Më mbajti disa sekonda të shtrënguar në kraharor. Më fërkonte supet sikur të isha djali i tij që kishte vite pa e parë. Pastaj u ul. Ishte i përbotur dhe si i shushatur nga gëzimi. Dukej i lodhur dhe rrinte i heshtur.

— Jam Viku Baku, o bir, — më tha pas pak. — Ku erdhe e më gjete, mor të gjettë e mira! Po tamam në shtëpinë tënde kam jetuar unë në Luranë. Plot një vit e gjysmë. Si njeriu i shtëpisë! Po a është Nuredin Basha, o bir?

— I fortë, — i thashë.

— E pastë jetën të gjatë ai soj burri, — uroi plaku. Po ti nuk po i ngjake fare në rudë. I ngjake Faziles ti, o bir, të njoh mirë tani. Po si është Fazilja, more bir?

— Nuk rron, — i thashë dhe më hipi mallëngjimi. — Vdiq vjet!

— Obobo! Ç'kalb kjo tokë, — thirri ai dhe kapi kokën me duar. — Po si, ore, paska vdekur Fazilja?! Po ç'pati?

— Vdiq papritur, nga zemra, — i thashë.

— E po, të rroni vetë, — tha plaku i përbotur.

— Miqtë shëndoshë, — i thashë dhe atij iu bë shumë qejfi që fola kështu.

— Kemi rrojtur, o bir, i kemi bërë ballë së keqes. Nuk na shuan dot hasmët, — tha ai pas pak.

— Nuk na shuajnë, — tha edhe Trifoni gjithë vendosmëri. Atë e kishte prekur ajo që dëgjoji dhe tani nuk dinte si ta ndreqte atë sjelljen e paduruar të fillimit.

— Ju ikët nga bajonetat e sërbit, o bir, ne

nga të grekut, — tha Viku Baku. — Ikën fëmijët, gratë e pleqtë, se burrat që mbanin pushkë në duar e çuan gjakun gjer në gju për vatanë. Unë me familjen time erdha në Luranë. Kanë kaluar shumë vjet që atëherë, por mua më duket se ka ardhur sot... E mira dhe e keqja nuk harrohen kurrë. Kisha me vete nënën e sëmurë. Gruan po të sëmurë dhe katër fëmijë. Po ti nuk i di këto, se ke lindur njëzet vjet më vonë. Asokohe më vdiq nëna. Vdekja si vdekja, o bir, por i vdekuri do nderimet e veta, se nuk është si ai miku, që, po nuk e prite mirë sot, e pret ndonjëherë tjetër. Vdekja një herë vjen dhe të mbetet peng për gjithë jetën po nuk ia bërë të vdekurit nderimet... E kisha nënë dhe një nënë ka njeriu. «Vëlla, — më tha Nuredin Basha, — na vdiq nëna!» Pa pa, si m'u dukën ato fjalë! M'u duk se ma ngritën nënën më këmbë dhe ma bënë prapë të gjallë. M'u hoq e keqja fare! «Po, vëlla, na vdiq». — i thashë Nuredin Bashës dhe iu hodha në qafë si ty tani. Ndenjëm disa çaste në kraharor të njëri-tjetrit dhe dëgjuam rrahjet e zemrave tona. Imja rrihte për Nuredinin dhe e Nuredinit për mua! Ishit të varfër edhe ju, o bir, por Nuredini theri kaun e vetëm dhe thirri tërë fshatin në mortin e nënës së vet, se nënë e bëri dhe ai. E qau tërë Lurana nënën time dhe e varrosi me të gjitha nderimet. Eh, o bir, a harrohet kjo?!

Ai pushoi një çast dhe mori frymë thellë. Kur i thashë që donim të blinim një dele, pata nxjerrë paratë. Ato vazhdonin të qëndronin në bar, pranë plakut, dhe mua sesi më vinte.

— U pa puna, — tha Viku Baku duke u ngritur më këmbë. — Bëjuni zë edhe atyre shokë... e gjithë sa jeni të vini sonte tek unë.

— Faleminderit shumë, — i thashë tepër i

prekur, — por jemi me shërbim. Nuk mund të vijmë. Gëzohem që u njohëm.

— Delen, nëse ka mundësi, të na e shesësh, — tha me ngut Trifoni.

— Nuk mund të vini? — ngulmoi prapë Viku Baku.

— Nuk mundemi dot.

Viku Baku u ngrit dhe shkoi drejt tufës së dhenve. Ndolli dashin e tufës dhe e kapi. Dashi kishte këmborë. Edhe një dash tjetër ishte me këmborë, por ai që u ndoll ishte më i madh. Ia hoqi këmborën.

— Ç'po bën?! — e pyeta i habitur.

— Këtë do të merrni, — tha Viku Baku i vendosur.

— Jo këtë, — tha Trifoni, — ky bën shumë. Ne duam një dele, mbase një rrunxë, po këtë jo...

Viku Baku, pa e lëshuar dashin, i hodhi një vështrim Trifonit. E pyeti:

— Nga jallia je ti, o bir?

— Po, — tha Trifoni. Ai vërtet ishte nga fusha.

— Të njoha, — i tha Viku Baku duke e vështruar në sy. — Po ne malësorët kemi ca zakone pak ndryshe, o bir. Nuk ia shesim gjënë me lekë vëllait, prandaj paratë t'i futni në xhep, se ky është dashi i Nuredin Bashës, dashi i vëllait.

Unë e Trifoni kundërshtuam, por, kur pamë se më parë ndërronte rrjedha e atij përroit malor sesa mendja e Viku Bakut, iu lutëm që të mban-te ato para që kishim, megjithëse nuk arrinin as gjysmën e çmimit të dashit. Por ai u fye dhe ne u detyruam të merrnim dashin së bashku me paratë.

— Të fala shumë Nuredin Bashës, — më tha ai

kur u ndamë dhe më përqafoi prapë. — I thuaj që Viku Baku nuk e harron...

Muhedin Basha ndezi një cigare dhe na vësh-troi në sy sikur donte të dinte pështypjen që na la tregimi i tij.

— Kështu ka ndodhur, — tha ai. — Mbase ju hyn në punë.



## Njohje

Me Lidën u njoha në shtëpinë e pushimit. Vendi ishte i bukur: pisha dhe male, liqene me ujë të kulluar, lule shumëngjyrëshe dhe, mbi të gjitha, pylli me mështekna.

Ditën e parë pothuajse nuk u shoqërova me askënd. As Lida nuk më bëri kurrfarë përshtypjeje, sado që ishte mjaft tërheqëse. Kishte një qafë pak të gjatë, flokë të verdhë, me një refleks ngjyrash ylberi dhe sy të kaltër, shumë të kaltër. Përpiqesha t'ia kapja vështrimin, por ajo, sa herë m'i hidhte sytë, i puliste qepallat sikur ta vriste die-lli dhe, në vend që të më shikonte në sy, më shikonte ballin, flokët dhe vështrimin e çonte në sfondin e kaltër të qiellit. Kjo mënyrë shikimi më bënte njëfarë përshtypjeje, megjithatë nuk kishte diçka që të më tërhiqte. Është e ftohtë si një akullnajë, thashë një herë për të. M'u bë qejfi që e gjeta këtë figurë për Lidën dhe kisha dëshirë t'ia thosha dikujt. Por më vonë u binda se atë nuk e kisha thënë unë për herë të parë, diku e kisha lexuar.

Pas disa ditësh nisëm të përshëndeteshim me njëri-tjetrin. Por edhe përshëndetjet ishin të ftohta.

Në shtëpinë e pushimit punoja për një novelë. Do të bënte fjalë për druvarët. Kisha ardhur pothuaj në mjedisin që kërkoja. Pak më poshtë, si nja treçerekë ore larg shtëpisë së pushimit, ishte sektori i sharrave. Gati çdo ditë shkoja atje. Vëmendja ime ishte përqendruar më shumë te sektori sesa te njerëzit e kampit. Veç Lida ma trazonte disi përqendrimin me atë refleksin e ylbertë të flokëve dhe me një vështrim sa ironik aq edhe të trishtuar.

Një pasdreke shkova te pylli i mështeknave. Gjithmonë më kanë pëlqyer këta drurë deri në dobësi. Isha mbështetur pas një trungu dhe po soditja pyllin. Ndjeva prapa meje një lëvizje gjethesh, si fëshfërimë ere. Po nuk ishte era, ishte Lida. Më buzëqeshi dhe më shikoi drejt në sy. Ishte shikimi më shprehës i saj, një shikim që më mbeti në bebëza. Doja ta thithja atë shikim, ta ruaja që ta kisha në shpirt në kohë mërzie e boshllëku. Por ai, si të ishte një pëllumb që trembet papritur, më fluturoi sipër kokës dhe, si gjithmonë, shkoi në hapësirën e pastër të qiellit.

— Po frymëzohesh? — më pyeti ajo dhe unë ndjeva ironinë.

Qesha në mënyrë të panatyrshme. Pyetja e saj nuk më pëlqeu. Mendova se këtë pyetje e bëjnë zakonisht njerëz që pak e vlerësojnë krijimtarinë. Këtë proces ata sikur e mistifikojnë, sikur e nxjerrin jashtë shtytjes së fuqishme të jetës dhe krijuesin e veçojnë disi nga njerëzit e tjerë. Po Lida në pyetjen e saj nuk kishte këtë qëllim. Foli ashtu kot, veç sa për të hyrë në bisedë.

— Është i bukur pylli. — i thashë.

— I bukur, — pohoi edhe ajo. — Sidomos në mbrëmje, kur dita nuk ka ikur dhe nata ende nuk ka ardhur.

— Qenke romantike, — i fola dhe qesha.

E kuptova se thashë diçka bajate. Mendova se ajo do të më përshëndeste dhe do të ikte. Por ajo qeshi dhe nuk u largua. Dinte të ishte e natyrshme, zotëronte pikërisht atë që unë ato çaste e kisha humbur: drejtpeshimin dhe vetëpërmbytjen. E ndjeu se po kërkoja të thosha diçka dhe priti, por, kur u bind se unë nuk do të thosha asgjë, ngaqë nuk po gjeja dot fjalët e duhura, u largua.

Më erdhi inat që u largua ashtu si me mospërfillje. Ajo kishte diçka që të habiste: për një çast të vështronte me vëmendje, madje me kurreshtje, pastaj, papritur, sikur pendohet për atë shikim të vëmendshëm që të kishte hedhur dhe në fytyrën e saj zbriste mospërfillja e në sy zbrazëtia. Po pas pak këto të gjitha sikur i harrova. Kohën, pasionin, gjithçka, m'i kishte përpirë novela, njerëzit dhe pyjet që futeshin përditë e më shumë nëpër fletët e bardha.

Një ditë, kur sapo kishin ardhur librat e rinj, shkova në bibliotekën e shtëpisë së pushimit. Mora dy vëllime dhe bëra të dilja. Dikush më kapi lehtë për krahu.

— Më thuaj ç'libër të marr, se jam mërziur.

Ishte Lida. E vështrova për një çast në sytë e kaltër dhe vërtet vura re njëfarë pezmatimi dhe nënërie. Megjithatë një ironi e lehtë ishte ende e pranishme në fjalët e saj. Më erdhi papritur një dëshirë për ta ngacmuar. I thashë:

— Ke kohë për të lexuar ti?

Asnjë efekt nuk bënë fjalët e mia. Ajo iu shmang atyre siç mund t'i shmangemi një guri të hedhur nga një fëmijë që do të na qëllojë. Më shtrëngoi përsëri krahun dhe, sikur të kërkonte ndihmën time, më tha:

— Jam më të vërtetë e mërzitur. Të lutem, më këshillo ndonjë libër tërheqës.

Ngrita supet, për mua ishte një gjë krejt e pamundur.

— Po çfarë lloj mërzie të ka pushtuar? -- e pyeta. — Se vetëm kur dihet diagnoza përcaktohet edhe ilaçi.

— I sëmuri nuk e di diagnozën, atë e gjen mjeku, — tha ajo dhe qeshi hidhur.

— Merr këtë libër, — i thashë. — Në dorë kisha romanin e njërit prej autorëve më të njohur të letërsisë sonë.

— Nuk jam kaq profane. — tha ajo si e prekur. — Veprat e këtij autori nuk ka nevojë të m'i këshillosh. Librat e tij nuk ka mbetur njeri pa i lexuar.

Kuptohej se Lida ishte një vajzë shumë e zgjuar. Kisha mësuar se ishte kimiste në një nga qendrat e rëndësishme industriale. Për nga moshja duhej të ishim aty-aty. Ca rrudha të imta, fare të lehta, i formoheshin te këndet e syve. I dukeshin vetëm po t'i afroheshe afër, fare afër. Megjithatë ajo ishte e bukur, e freskët dhe pothuaj magjepsëse.

— Mirë pra, — i thashë, — meqë do një autor të parëndësishëm, po të jap vëllimin tim me tregime.

Atëherë unë kisha bërë emër fare pak në letërsi. Kisha botuar një vëllim me poezi dhe një me tregime. Për to kritika kishte heshtur. Vetëm me shokë dhe miq bisedoja për librat e mi. Puna është që vepra të pëlqehet nga populli, të vlerësohet nga populli, mendoja unë për t'ia hequr të keqtë vetes. Por ec e pyete tërë popullin, pezmatohesha pa u kënaqur me idenë e parë.

— E kam lexuar.

— Vërtet?!

— Nuk kam përse të të gënjej.

Kjo më bëri shumë përshtypje dhe pata dëshirë të shfrenuar për të ditur mendimin e saj për tregimet e mia. E pyeta.

— Tregimet e tua? — pyeti ajo e bëri një pauzë të shkurtër. — Atje dukesh shumë më i pjekur sesa në jetë, — tha pastaj duke më shikuar në sy.

— Faleminderit, — i thashë.

— Besoj nuk u preke?

— Nuk u preka, — i thashë dhe, si mora një libër në dorë, shtova: — Lexoje këtë libër, është i një shokut tim.

— Nuk do ta lexoj sepse është i shokut tënd. E vlen për ta lexuar, apo jo ?

— Shkruan mirë, — i thashë. — Ke për ta parë vetë.

Ajo mori librin dhe të dy dolëm jashtë...

Të nesërmen ra shi. Binte shi i imët, këmbëngulës. Dukej sikur nuk do të pushonte kurrë. Dhe nuk pushoi as të nesërmen, as të pasnesërmen. Ishte një gjë shumë e mërzitshme të rrije tërë ditën mbyllur në dhomë. Vend ku të dilje nuk kishte, ngaqë ishte lagështirë e madhe kudo. Në drekë u takova me Lidën. .

— Kjo ditë nuk kalohet vetëm, — i thashë.  
— Bisedojmë pak...

Ajo dukej më e mërzitur e më e trishtuar sesa një ditë më parë. Rrudhat e holla në këndet e syve sikur i ishin thelluar. As ai makiazhi shumë i lehtë vajzëror nuk kishte mundur t'ia mbulonte. Më kapi në befasi, e kuptoi se po i shikoja rrudhat në fytyrë.

— Ti do të bisedosh me mua ngaqë bie shi e nuk ke ç'të bësh tjetër? — më pyeti.

— Jo vetëm për këtë.

— Vërtet?

— E, vërtet. Pastaj më duket se edhe ti ke nevojë për një shoqëri më të afërt.

Ajo më vështroi gjatë. Buzëqeshi dhe me një kureshtje të përmbajtur më pyeti:

— Nga e kupton këtë?

— Ti e tregon vetë, — i thashë. — Që kur të pashë m'u krijua një përshtypje e tillë. Ajo sikur është e mërzitur, mendova. Dhe më lindi dëshira për t'u njohur me ty.

— Nuk je kaq vëzhgues në tregime, — vërejti ajo dhe heshti.

Para nesh kaloi përgjegjësi i kampit. Në fillim nuk e dija se ishte daja i Lidës. Vinte shtatmesatar dhe rrinte gjithnjë me një kostum kafe me kollare, sikur do të shkonte nga çasti në çast në një mbledhje solemne. Flokët i mbante ngjitur pas kokës. Kishte ca flokë të kuqërremtë, që nuk di se përse të kujtonin gjethet e verdha e të thara. Këtu, në këtë vend të mbuluar nga gjelbërimi, ai të kujtonte vjeshtën.

— Lida, po vjen pak, — i thirri ai vajzës duke më përshëndetur edhe mua me një të lëvizur të kokës, sikur donte të më kërkonte të falur.

— Më fal, shihemi pastaj, — më tha Lida dhe iku.

Pak më tej ishte një basketbollist, të cilin e kisha parë vazhdimisht të shoqëruar me përgjegjësën e kampit. Ai më shikoi si me krenari. Me Lidën nuk u takova as pastaj e as në mbrëmje, se nuk erdhi në mensë për të ngrënë darkë. Pyeta një shoqe të saj, e cila më tha se Lida ishte pak e sëmurë, prandaj kishte ndenjur në dhomë.

Edhe të nesërmen dita që me shi dhe kjo më mërziti shumë. Hyra në lokalin e vogël, në një barakë të ngritur shpejt e shpejt, ku mora një fërnet dhe një kafe. Dëshiroja të shkoja te sharrëxhinjtë, por më pengonte shiu.

— Djalë, — më tha banakieri, — nuk bën të mërzhitesh.

— E po, njerëz jemi, xha Banush, — i thashë.

Nuk e kuptoja se kush ma shkaktonte këtë mërzi, ai trishtimi i paemër i Lidës, apo shiu që nuk kishte të pushuar. Në drekë u takova me Lidën në mensë.

— Si je tani? — e pyeta. — Më thanë se ishe e sëmurë.

— Bisedojmë pastaj, — tha ajo, pa i ngritur sytë nga pjata.

Po jashtë binte shi dhe mua nuk më mbetej gjë tjetër veçse të shkoja në dhomë. Ajo ndodhej në një kapanon të veçuar, anës bregut të liqenit. U nisa nëpër shi. Lida ende nuk kishte dalë nga mensa. Nuk nxitoja. Nuk di se përse kisha dëshirë të lagesha dhe për të parën herë mendova se shiu nuk është kurdoherë i mërzhitshëm. Nuk kisha bërë as gjysmën e rrugës, kur dëgjoj që më thirrën. Ishte Lida. U ktheva. Ajo rrinte në oborr, para barakës së klubit. Nuk hymë as në kafe, as në bibliotekë.

— Rrimë këtu, — tha ajo.

Po rrinim nën një thanë të madhe, rrethuar me rrush të egër, që kishte formuar një mbulesë të çuditshme. Ishte për t'u habitur që thana, të mbinte dhe të rritej në një lartësi të tillë.

Lida më shikoi në sy. Kuptohej se kishte diçka për të më thënë. Pika të vogla uji, si rruaza, rrëshqitnin nga trupi i mështeknave laramane. Liqeni i Luleve ishte i turbulluar. Ai tërhijte më tepër kureshtjen e vizitorëve, kurse mua më pëlqente më shumë Liqeni i Zi. Dy ditë më parë njëri nga sharrëxhinjtë më tregoi për të një legjendë. Liqeni i Zi nuk i mban të vdekurit, më tha atë ditë sharrëxhiu. Njëherë, shumë kohë për-

para, aty ishin mbytur dy burra dhe një grua. Ata ishin të huaj. Gruaja ishte larë në liqen me burrat. Ishte e para grua që ishte larë në atë liqen. Liqeni ishte hakmarrë në mënyrën më të egër: i kishte mbytur të tre. Vrapuan vendasit t'i nxirrnin, por trupat e tyre nuk dukeshin fare. Pas tri ditësh, sekush tha që koka e gruas u duk në sipërfaqen e liqenit. Nata ishte me hënë dhe koka ishte dukur krejt e verdhë. Ishte një fytyrë hënore, pati thënë ai që e pa. Njerëzit u vunë të kërkonin me shpresë për t'i gjetur, por asgjë nuk doli. Atëherë erdhi një i huaj shumë i pasur dhe premtoi shumë para për ata që do t'i nxirrnin trupat e të vdekurve. «Ore i huaj, nuk nxjerr gjë nga Liqeni i Zi», i tha atij Kel Kola, një fshatar i asaj ane. «Përse?» e pyeti i huaji. «Se Liqeni i Zi nuk i mban të vdekurit, i nxjerr poshtë, në Setë.» Seta është një lumë i vogël malor, rreth njëzet kilometra larg Liqenit të Zi. I huaji e quajti plakun të lajthitur dhe prapë premtoi para. Dhjetë ditë kërkuan njerëzit nëpër liqen. Nuk kaloi shumë kohë dhe të huajin e njofuan se trupat e të mbyturve u gjetën në Setë. Ja, kjo ishte legjenda, përfundova unë.

— E çuditshme, — tha Lida. — Si ka mundësi?

— Nuk ka asgjë të çuditshme, — i thashë. — Liqeni i Zi ka një lidhje të nëndheshme me lumin e Setës.

— Ne jemi një popull me shumë legjenda, — tha Lida.

Ajo fliste e frymëzuar, me një hije krenarie për lashtësinë e kombit. Vetë Lida më dukej ato çaste si një vajzë ilire që e kisha gjetur rastësisht në një nga lozhat e amfiteatrit të Butrintit. Lashtësia më dukej se ishte edhe në sytë e saj.



Qëndruam pa folur për një farë kohe. Lida, si të ishte kujtuar për diçka, tha:

— Pak më parë desha të të flisja për dajën tim dhe atë basketbollistin. Desha të të thosha se jam e mërzitur prej kaq ditësh...

Heshti një çast, pastaj shtoi:

— Daja më propozoi të fejohej me atë djalin e ri që më rri para dhe mbrapa, me atë basketbollistin. Është me të vërtetë fyese të ndërhyhet edhe te një vajzë e rritur. Të duket vetja sikur hidhesh një shekull prapa.

Kurora e thanës, përzier me rrushin e egër, nuk e mbante shiun që binte pa pushim. Pikëza të vogla uji na binin shpeshherë në kokë, në trup. Vështroja se si ato pikëza rrëshqitnin nga flokët e Lidës duke marrë një shkëlqim të verdhë. Gjithmonë më kanë pëlqyer flokët e vajzave kur lagen nga një vesë shiu. Ato në të tilla raste sikur shpupurisen e ndizen.

Përgjegjësi kaloi para mensës dhe hyri në kafe. Na hodhi një vështrim të çuditshëm mua dhe Lidës. Një vështrim prej njeriu të vetëkënaqur. Përgjegjës, ç'na e solle vjeshtën në korrik, mendova. Ai doli nga klubi së bashku me basketbollistin. Bisedonin në shi dhe ecnin kokëvarur, sikur të ishin në një hall të madh.

— Shkojmë, — tha Lida. — Sikur nuk bën të rrimë më.

E ndieja se duhej t'i thosha diçka, por se çfarë as unë nuk e kisha të qartë.

— Basketbollistët pushojnë të gjithë si skuadër. Po ky ç'ka dashur këtu? — e pyeta Lidën.

— Çdo njeri shkon atje ku i pëlqen, — tha.

Përgjegjësi dhe basketbollisti hynë në dhomën e lojërave. Disa luanin domino, disa shah, kurse të tjerët bilardo. Përgjegjësi më vuri re dhe

më buzëqeshi. Më ftoi të bënim një lojë shah. Pranova pa ndonjë kënaqësi.

— Shehun nuk do ta lajmërojmë, — tha ai.

— Nuk do ta lajmërojmë, — thashë unë.

Basketbollisti mori një karrige dhe u afrua te tryeza jonë. Më vështronte pjerrtas, më tepër nga këmbët sesa nga koka. E merrja me mend arsyen, ndaj nuk më bënte kurrfarë përshtypjeje ajo mënyrë vështrimi. Loja shpejt u bë e mërzitshme dhe heshtja sundonte. Isha mësuar të luaja shah në klubin e Lidhjes, ku luajnë më shumë ata që shikojnë sesa ata që kanë vënë gurët. M'u kujtuan shakatë dhe humori i atjeshëm, m'u kujtua mjeku i vjetër që rrinte në klub derisa mbyllej. Kurse ajo ishte një lojë e heshur dhe e mërzitshme. Por pas pak loja hyri në ca faza tërheqëse dhe sikur m'u hoq shqetësimi që kisha. Përgjegjësi e kishte të humbur atë lojë. Pas një lëvizjeje ai humbiste mbretëreshën. Mendohet gjatë, sikur loja të ishte për kampionat, dhe kjo m'i ngrinte nervat e ma humbte durimin. E kuptoja se nuk po i binte më të se ç'kurth po i përgatitja. Basketbollisti ia shkeli këmbën nën tryezë. Tjetri ngriti sytë dhe e shikoi. Basketbollisti i tregoi me sy se cilin gur duhej të lëvizte. Përgjegjësi tashmë e kuptoi, por nuk nxitonte për ta bërë lëvizjen, që të krijonte përshtypjen se e gjeti vetë. Pas dhjetë minutash ai lëvizi gurin që iu tregua.

— Kot na vonove, — i thashë i nxehur, — Ky shoku ka kohë që ta tregoi atë lëvizje.

— Jo, nuk tregova asgjë, — tha basketbollisti.

— I tregove, — thashë. — Po ta kishe bërë hapur, nuk do të më ngelej merak fare...

— Nuk më tregoi, — tha përgjegjësi.

Sytë e tij ishin të ftohtë si qiell dimri.

— Vazhdojmë, — thashë.

Pas këtyre replikave loja u bë edhe më e heshtur.

Përgjegjësi e fitoi atë lojë dhe ne u ndamë në heshtje të plotë. Në mbrëmje Lidën, përgjegjësin dhe sportistin i pashë në oborr, duke biseduar me zë të ulët. Lida dukej e zemëruar. Ajo e ngrinte zërin dhe kjo gjë dy të tjerëve dukej se nuk u pëlqente fare.

— Futemi brenda, atje bisedojmë më qetë, — i tha daja. Ai e kishte fjalën për në zyrën e vet.

— Ju futuni dhe bisedoni sa të doni, unë nuk kam punë atje. Atë që kisha për t'jua thënë, jua thashë këtu, — tha Lida. Ajo u largua me hapa të shpejtë.

— Lida, Lida! — e thirri përgjegjësi.

Fytyra e tij ato çaste sikur u bë katrore, kurse një cullufe flokësh iu shkëput e revoituar nga ai çimentim brilantine, duke iu përdredhur në ajër. Lida ecte tutje, në fund të oborrit, pranë fjetoreve të grave. Hodhi flokët e bukur prapa me një lëvizje shumë të hijshme dhe u fut në dhomë.

Të nesërmen dita qe e bukur, me diell. Natyra kishte bërë banjë në shiun e pastër të verës dhe ajri ishte shumë i kthjellët. Gjithçka dukej sikur rrëzëllente dhe farfurinte. Shikoja lojën e dritëhijeve, reflekset dhe xixëllimin, gjelbërimin e pyllit me pisha, kundërmimin e luleve shumëngjyrëshe dhe ndieja të më hapej kraharori, sikur kisha një humbje të peshës dhe, nga çasti në çast, do të fluturoja. Isha i ngazëllyer dhe prisja me padurim që të dilte Lida. Dëshiroja të rrija gjatë me të dhe sa më larg kampit, atje, te pylli i mëshhtëknave, tek ajo lëndina e bukur plot lule të bardha. Lida doli, por, ndryshe nga ç'e mendoja unë, ishte e mërëzitur si asnjëherë tjetër. Dukej se kishte kaluar një natë pa gjumë.

E përshëndeta, por ajo mezi lëvizi buzët për të më thënë një «mirëmëngjesi». Gëzimi për atë ditë të bukur dhe dëshira për të ndenjtur me Lidën m'u tretën si vesa kur bie dielli. Ajo e kuptoi që u hidhërova dhe më tha:

— Mos ma vër re, jam shumë e mërztur dhe kam dëshirë të iki sa më parë që këtej.

— Unë e pranoj mërzinë tënde, — i thashë.

Kjo fjali m'u duk qesharake, por, nuk di përse, në ato çaste, vetëm ajo më ra ndër mend.

— Do të iki, — tha Lida, — nuk mund të rri më këtu! Nuk po më ndahen, s'më lanë një minutë të qetë.

— Mos ik, Lida, — i thashë dhe m'u ngritën nervat nga qëndrimi i tyre shumë i ulët. — Ti nuk duhet të ikësh, duhet të rrish...

E kuptova që do të thosha diçka të pamenduar mirë dhe shtova:

— Duhet të rrish për të ruajtur dinjitetin tënd, Lida!

— Më përcill deri te sektori i sharrave, atje do të gjej patjetër ndonjë makinë, — tha ajo.

— Unë të përcjell, por nuk dua të ikësh. Unë habitem se si mund të të kërkojë daja që ti të fejojesh me një njeri që e njohe për pesë-gjashtë ditë këtu, në kamp!

— E njeh daja mirë, — tha ajo me ironi. — Tani e kuptoj se përse m'u vu aq shumë që të pushoja këtu. Nuk e paska pasur hallin të pushimi im. Me Bekun ai ka dashur të më fejojë që në qytet, por unë u thashë që s'ndieja asgjë për të. Kaq do të mjaftonte, po daja ngulte këmbë se ai është djalë i mirë, ndërsa unë ngulja këmbë në timen dhe kështu mbeti kjo gjë. Pëpritur daja më tha që të vija për të pushuar këtu... E po, mirë, pranova dhe erdha. Por ai kishte marrë edhe këtë.

Lida qeshi hidhur. Kishim mbërritur te Liqeni i Zi.

— Fundja ata nuk mund të të detyrojnë, Lida. Ti nuk ke përse të ikësh.

— Nuk më detyrojnë, por po më mërzitin. Nuk duroj dot më.

— Rri, Lida, — thashë unë, — nuk dua të ikësh. Do të më vinte shumë keq, do të më vinte inat, po të tregoheshe kaq e dobët.

— Të kuptoj, — tha ajo duke më vështruar në sy.

Të nesërmen, aty afër mbrëmjes, përgjegjësi m'u afrua dhe më tha:

— A ka mundësi të vini pak në zyrë? Kam diçka me ju.

Kur m'i tha këto fjalë, ishim te Liqeni i Luleve.

— Po ja, flisni, — i thashë.

— Nuk di si të të them, — foli ai, tashmë në njëjës. — Janë fjalë që nuk shkojnë këtu... Në zyrë jemi më të qetë.

— Unë jam i qetë edhe këtu, megjithatë shkojmë.

Zyra e përgjegjësit ishte shumë e bukur. Tryeza kishte sipër një mbulesë borë të bardhë me ca lule të gjelbra nëpër të. Gjithçka shkëlqente nga pastërtia.

Një copë herë ai vërtiti një laps nëpër duar. Siç dukej, nuk dinte nga të fillonte.

— Po pres, — i thashë.

— E di që pret, por nuk di nga t'ia nis, — tha daja i Lidës me njëfarë sinqeriteti. — Nganjëherë njeriu zihet ngushtë, nuk di nëse duhet

të bëjë këtë apo atë veprim, apo jo... Pothuaj nuk kam asgjë të rëndësishme.

— Po nuk pate gjë, po dal, — i thashë dhe bëra të ngrihesha.

— Jo, prit, diçka kam, — tha ai. — Ti me Lidën sikur... diç keni... Mbase keni vetëm shoqëri. Unë nuk e kuptoj keq shoqërinë... por, në këtë kohë, do të ishte mirë sikur ta linit të qetë Lidën. Ajo pothuaj është e fejuar me Bekun. Beku është djalë i mirë, është djali i një shokut tim. Lida është njohur prej kohësh me të, por nuk e ka dhënë fjalën. Këtu sikur u krijuan kushtet... por, ja, u futët ju në mes. Ju mbase nuk keni asnjë qëllim të keq, por, thashë, momenti është delikat dhe po e ftohni me Bekun.

— Ç'kërkoni nga unë, bjeri shkurt, — nuk m'u durua mua.

— Ta lësh rehat Lidën, ja, këtë po kërkoni. Më qartë se kaq nuk mund të flitet, — tha ai duke më vështruar në sy.

— Edhe më turpshëm nuk mund të flitet, — i thashë.

— Ju lutem...

— Dëgjo, përgjegjës, — ia preva fjalën. — Këto që thua ti, janë shumë të ulëta. Unë nuk kam asgjë me Lidën. Ne sapo u njohëm. Unë nuk po i bie më qafë aspak Lidës dhe ajo nuk besoj të të jetë ankuar. Më qafë po i bie ti. Ajo nuk është femijë dhe e di vetë se kë duhet të zgjedhë për shok jete. Ti lëre të qetë. Hajde, mirupafshim!

Dola përjashta duke e lënë përgjegjësin si të shushatur, me duart që i dridheshin nga zemërimi. Lidën e pashë nga larg.

— Lida! Lida, — i thirra.

Ajo, sapo më dëgjoi zërin, erdhi gati me vrap.

## Melodia e malit

Më njoftuan se gjyshi ishte i sëmurë dhe unë nxitova për në fshat. Para dy muajsh, kur isha me leje, e lashë, shëndoshë e mirë; vërtet pak të dobësuar, por më këmbë. Dhe kjo nuk ishte pak për një njeri që mbante mend dy sulltanë të Turqisë dhe që në kohë të hyrietit, siç thoshte ai, kishte kryer ushtrinë. Në shtëpi mbërrita në të perënduar të diellit. Rrugën e bëra më shumë më këmbë sesa me makinë. Isha lodhur dhe pluhurosur. Nëna, sa më pa, lëshoi një britmë të lehtë habie dhe m'u mbështet në gjoks. Ka vite që, kur jam larguar nga fshati, ajo kështu takohet me mua: më vë kokën në gjoks dhe tulatet për disa sekonda pa lëvizur fare. Pastaj zë dhe më puth duart, siç bënte dikur, kur isha i vogël.

— Si është gjyshi? — e pyeta.

— Sëmurë, — tha ajo.

— Po unë sikur e lashë më mirë...

— Sëmurë është, por jo për... — nuk e mbaroi fjalën ajo. Bëra të ngjitja shkallët për të shkuar në dhomën e gjyshit, një dhomë e madhe,

me katër dritare, nga të cilat dy shikojnë nga lindja dhe dy nga jugu.

— Nuk është në dhomë, — më tha nëna.

— Po ku?!

— Te molla...

Në bahçe, midis pemëve të shumta, është edhe një mollë. Atë e ka mbjellë vetë gjyshi para pesëmbëdhjetë vjetësh. Atij i pëlqen shumë që të rrijë në hijen e saj. E gjeta shtrirë mbi një shilte, rrinte në shpinë, me kokën lart, të ngritur mbi jastëkë. Nuk lëvizte fare dhe dukej sikur nuk merrte frymë. Dora i ishte fishkur dhe damarët mavi, që dikur i kërcenin nën lëkurë si thupra thane, tani ngjanin me ata përrenjtë që shëtojnë në verë, kur u thahet shtrati. Rrudhat, veçanërisht ato në tëmtha, kishin fituar një përthyerje të re. Në ballë i ishin ngritur ca kokrriza të vogla, si kokrra dëllinje, me një ngjyrë të gjelbër të errët.

— Si je, gjysh? — e pyeta.

Ai u shkund nga ajo dremitje e lehtë si nga një ëndërr e më hodhi sytë.

— Erdhe? — më pyeti.

Zëri i tij m'u duk i largët, sikur vinte nga një humbëtirë. Përfytyrova rrugën e atij zëri dhe m'u duk se në trupin e tij gjithçka ishte tharë, i ishte krijuar një zbrazëti përbrenda brinjëve dhe gjoksit.

— Erdha, — i thashë.

— Ti vjen shumë rrallë, — më tha si me qortim. — Thirre nusen.

Kështu i thërresin nënës sime. Ajo erdhi me një gotë dhallë në dorë. Gjyshi e mori gotën në duart e veta dhe u përpoq të pinte. Sa e vinte në buzët, dhalli, sikur të gjente një pengesë, kthehej prapë në gotë. Ma la gotën në dorë dhe u shtri si pak çaste më parë. Më shikoi në sy, më shikoi gjatë...



— Ta kishe marrë edhe nusen e vogël me gjithë fëmijë, — më tha.

Nuse të vogël ai quam gruan time.

— Do të vijnë nesër me autobus, — i thashë.

Dielli sapo kishte perënduar dhe mbrëmja po vinte me hap të lehtë e të pakuptueshëm. Doli hëna. Fletët e pjergullës u spërkatën me dritë të verdhë, kurse xhufkat e misrave, të njoma dhe të buta, dukeshin si fije telash të artë.

Tërë familja jonë e madhe: babai, nëna, vëllai, nusja e vëllait, fëmijët, erdhën aty, pranë gjyshit. Ra një heshtje që atij nuk i pëlgeu.

— Na bëj një kafe, — më tha mua

Atij i pëlqente kafja që bëja unë. Pas dhjetë minutash, me ibrikun e kafes dhe tabakanë me filxhanë në dorë, u ktheva te molla. Kur shtiva kafet nëpër filxhanë, gjyshi shikoi fëmijët.

— Mbushua duart me dardhë, — tha ai.

Mu afër mollës ishte një dardhë verore, që piqej herët. Fëmijët i kishin qejf shumë dardhët, por nëna nuk i linte të preknin asnjë kokërr, se ia ruante gjyshit. Vëllai u ngjit në dardhë dhe u kthye me xhepat plot.

— Dardhët e gjyshit, — thoshin fëmijët dhe qeshnin.

— Në dasmë të fëmijëve, — më uroi gjyshi për kafën.

Shumë vonë ramë për të fjetur. Mua më shtruan në dhomën e gjyshit. Më tha që t'i hapja të gjitha dritaret dhe t'ia afroja shtratin pranë asaj që binte nga lindja. Frynte një erë e lehtë dhe degët e kumbullës përplaseshin në xham. Gjyshit i vura tre jastëkë nën kokë dhe kështu ishte më shumë ndenjur sesa shtrirë. Drita e hënës u ipte kokrrave një ngjyrë të verdhë dhe kumbullat gjatore, ndonëse ishin të papjekura, të grisnin t'i këputje atë çast.

— Dëgjo, — më tha me zë të shqimët gjyshi. — Këtë kumbull mos e prisni derisa të thahet vetë.

— Jo, gjysh, përse ta presim?

— Abazi ka dashur ta presë njëherë, por ti mos e lër.

— Nuk do ta lë, — premtova unë.

Abazi është im atë. Gjyshi e donte shumë, se djalë e kishte, por pesëmbëdhjetë vjet më parë ata u fjalosën keq dhe gjyshi nuk ia harroi kurrë. Babai, në vend që të kapte kërrabën dhe të bëhej çoban me dhentë e kooperativës, siç deshi gjyshi, kapi çekiçin e mistrinë dhe punoi në ekonominë ndihmëse si murator. Gjyshit i mbeti hatri atëherë dhe dy javë me radhë nuk i foli fare babait. U pajtuan, por ftohtësia mbeti midis tyre si ato pjesët e borës që mbeten shpateve të maleve edhe pasi vjen vera.

Gjyshi gjithë jetën kishte qenë çoban, po çoban në dyert e botës, se vetë nuk kishte dhën. Kur u formua kooperativa, sikur u përtëri. Û bë çoban. Tani kam tufë të vërtetë, thoshte ai.

— Dëgjo, — më foli prapë. — Kam qejf që, sa herë të vish këtu, të flesh në shtratin tim. Dhe hajde më shpesh, se këtu i ke rrënjët.

— Do të vij, gjysh, dhe do të fle këtu, si sonete, pranë teje.

— E, mirë, mirë, — qeshi lehtë ai. — E kam fjalën kur unë të mos jem më...

— Po ti do të jetosh gjatë, gjysh. Uhaaaa, je i fortë ti.

— Jetova mjaft, — tha ai, — po njeriu nuk u rigopka me jetë, sidomos me këto ditë të bardha që mbërrimë ne... Po puna është të mos e kalosh jetën kot...

Ia gozhdoi sytë dritares dhe dukej se nuk shikonte afër, por diku larg.

— Eh, ç'erë, — tha dhe mori frymë thellë.

Përtej kumbullës ishte një gardh i dendur hidesh. Era e tyre të hynte në gjoks dhe sikur ta zgjeronte kraharorin.

— Kanë erë të mirë, — thashë për hidet.

— Nuk fola për erën e hideve, ndjeva erën e dhenve, — më tha si me qortim gjyshi.

Vetëm atëherë e kuptova se ai kishte pasur tjetër dëshirë kur më kishte thënë t'i hapja të katra dritaret. Në një anë të fshatit, nga Veriu, ishin ngritur vathët e kooperativës.

— Vërtet erë e mirë, — i thashë për t'i bërë qejfin.

Gjyshi qeshi me një keqardhje të lehtë.

— Mos më gënje, ti nuk e ndien erën e dhenve. Duhet të kesh fjetur në vathë që ta ndiesh atë erë.

Ia lëmovia dorën e rreshkur si për t'i kërkuar të falur.

— Dëgjo, — më foli prapë gjyshi. — Kam qejf të shikoj tufën e dhenve kur i ngjitet shpatit të Xhernit. Po tani Ziku i kullot andej nga Murrizajt. Sikur t'i thoshe Zikut që nesër t'i binte për hatrin tim këndeje nga Xherni. Do ta bëjë Ziku për mua, do ta bëjë.

U çudita me këtë kërkesë të gjyshit.

— Gjysh, po ti nuk... — nuk e çova deri në fund mendimin.

— Jo, jo, e di vetë unë... Dua t'i shoh dhentë nesër... Dëgjomë mua ti.

— Mirë, gjysh, do të nisem nesër pa gdhirë.

Ai më pa me qortim.

— Sonte, ore, sonte. Që tani shko dhe thuaj Zikut.

Nuk e zgjata më, u veshja dhe dola. Dola në

heshtje, pa më ndier fare njerëzit e shtëpisë që flinin në dhomat e tjera.

Zikun e gjeta te vatha. Gati sa nuk më shqyen qentë derisa i yshti Ziku.

— Zik, gjyshi është i sëmurë dhe ! ka shkrepur që ta shohë tufën e dhenve duke iu ngjitur malit të Xhernit. Po munde, Zik, bëje këtë për gjyshin. Ktheje nesër tufën andej...

— Unë këtë do ta bëj, por ti mos thuaj i ka shkrepur. Këtë do ta kërkoja edhe unë dhe kushdo tjetër që ka qenë bari tërë jetën.

Me Zikun ishim duke biseduar mbi një shtrat druri, ku ishte shtruar një dyshek me kashtë. Ari-fi dhe Mensuri, që po flinin, u zgjuan. Erdhën pranë nesh.

— Gjyshi është keq, ë? — pyeti Ziku sikur po bëte muhabet me veten.

— Keq.

— Do të vij ta shoh, — tha. — Ai më ka bërë çoban.

Ziku ishte rreth dyzet e pesë vjeç, por, ngaqë nuk rruhej shpesh, mjekra i ishte rritur shumë dhe tregonte se ishte më i vjetër. Veç sytë e tregonin të ri, madje më të ri se ç'ishte në të vërtetë.

Gjyshin e gjetëm në gjumë, të paktën kështu m'u duk mua. Nuk fle, — tha Ziku me zë të ulët. E kuptoj që nuk fle, ëndërron. Veshët i janë rënduar dhe nuk na dëgjon.

— Erdhe? — më pyeti gjyshi pa lëvizur fare.

— Me gjithë Zikun, — i thashë.

Ai prapë nuk lëvizi, veçse zgjati dorën për të kapur atë të Zikut.

— Përse u mundove, Zik?

— Mos fol kështu, gjysh. Unë për ty shkoj në fund të botës, — tha Ziku.

Gjyshi qeshi, më dukej se ai u besonte shumë fjalëve të Zikut.

— Si është tufa, — Zik? — pyeti gjyshi.

— Mirë, gjysh, nga treqind pëlleja morëm treqind e dhjetë qengja.

— Po qentë, Zik, si janë qentë? Çobani nuk është gjë pa qen.

— Janë shumë mirë, gjysh.

— Po Meku si është? U plak, ë?

— Mekuuuu, — e zgjati zërin Ziku. — Si luan është. Një natë, kur po ktheheshim nga Shatorja, ia behu ujku. Meku u përta me të. I ndihmuan edhe qentë e tjerë por ai do ta bënte edhe vetë shatrapatra ujkun. Ai është provuar, gjysh, por thashë se mos ishte plakur. Po gabova, gjysh.

Gjyshi dëgjonte me kënaqësi ato që tregonte Ziku dhe fytyra sikur i ndrinte nga lumturia.

— Më kënaqe, Zik, — tha ai dhe pashë t'i vraponte gëzimi nëpër rrudhat e faqeve.

Papritur koka iu var në jastëk e unë e Ziku pamë njëri-tjetrin.

— Tani po fle, — tha Ziku dhe u ngrit.

E porcolla deri në oborr dhe u ktheva. Nëna ndezi dritën e korridorit dhe më pyeti e trembur:

— Si është gjyshi?

— Mirë është. Përcolla Zikun.

— Ç'deshi Ziku në mes të natës?!

— Erdhi të shikonte gjyshin, ditën nuk ka kohë.

Sa hyra në dhomë, gjyshi u zgjua dhe kërkoi Zikun. I thashë se sapo kishte ikur. Nuk foli, por hidhërimin ia lexova në fytyrë.

Hëna tani lëshonte dritën e saj të verdhë nga lindja. Gjethet e plepave dukeshin si të lyera me bakër. Gjyshi u duk sikur ra përsëri në gjumë. Po më shumë se gjumë, ajo ishte një kapitje

e madhe. Po dremit edhe unë pak, se gjyshi po fle, mendova. Po, sa mbështeta kokën në jastëk, atë e zuri kolla, një kollë e thatë, me një hungërimë të mbytur. Gjoksi i ngrihej dhe i ulej sikur të ishte mbi dallgë e jo mbi jastëk. Ëkhë, ëkhë, vazhdonte të kollitej dhe unë ndieja një dhembje therëse në gjoks. Ai nuk kishte pasur kurrë kollë dhe u tremba. U zgjuan të gjithë dhe i erdhën te koka.

— Nuk ka pasur kurrë kollë, — tha nëna me zë fare të ulët.

— Po edhe ka. Ky tani...

Kaloi gjysmë ore dhe gjyshi u qetësua. Por ishte aq i lodhur, sa nuk i regëtinte asgjë veç zemrës. Mugëtira e natës po zhdukej duke ia lënë vendin agimit. Andej, matanë kodrës së mullirit, u dëgjua blegërima e dhenve. Ziku po e nxirrte kopënë përfund korijeve dhe po e ngjite shpatit të Xhernit.

— Gjyshi do të shohë tufën, — u thashë të gjithëve.

— Lëre atë fjalë tani. Shyqyr që u qetësua pak, — tha babai.

Atë çast gjyshi hapi sytë si me drithërimë. Ishte diçka e pabesueshme, por ai u ngrit më këmbë. Ne e veshëm, e mbathëm dhe i thamë ta hipnim në mushkë e ta nxirrnim te meja, nga ku dukej tufa e dhenve që do t'i ngjitej Xhernit.

— Më jepni gunën, — tha ai dhe sytë i shkëlqyen nga drita.

— Do të vishet si çoban, — tha babai.

— Më bini edhe kavallin, — tha gjyshi.

Nuk desh të hipte në mushkë. Unë dhe babai e mbanim për krahësh. Kur mbërritëm në meja, tufa e dhenve po i ngjitej malit të Xhernit. Zilet dhe këmborët përziheshin me njëra-tjetrën

dhe me zhaurimën e lumit. U dëgjua fyelli i Zikut, që kishte marrë një melodi të ëmbël, të cilën e kishim dëgjuar edhe herë të tjera, por kurrë nuk na kishte pëlqyer si atë ditë. Gjyshi rrinte më këmbë si i shastisur. Ishte pushtuar i tëri nga blerimi i pllajës, tingujt e zileve dhe të këmborëve, zhaurima e lumit, melodia e fyellit të Zikut.

— Bukur, — tha ai.

I lëvizi pak krahët dhe ne e shtrënguam që të mos rrëzohej.

— Mos më mbani, — tha duke nxjerrë fyellin nga brezi. Po veç e vuri në buzë, tingujt nuk mundi të nxirrte.

## Drita e një mbrëmjeje

Në shtëpinë ku kam lindur, hyj brenda me mallin e fëmijërisë, të viteve që kam jetuar aty. Rruga për t'u futur në oborr, ka ndryshuar. Ndanë rrugës janë mbjellë plepa të bardhë dhe hide. Këto janë bërë si gardh i dendur dhe e ke të vështirë të shohësh që nga oborri se kush kalon në rrugë. Dikur në të dyja anët e rrugës kishte porene të larta, ku ne, fëmijët, mblidhnim manaferra. Atëherë në oborr hyhej nga lindja, tani hyhet nga jugu. Po hyrja tani është bërë shumë më e bukur nga ç'ka qenë. Në të dyja anët e rrugicës janë ca parmakë të lartë druri, që lart përfundojnë me tela. Sipër tyre janë lidhur hardhitë. Është krijuar diçka si një tunel i gjelbër, gjithë hije. Vetëm tek-tuk, përmes fletëve të dendura, futet dielli i mesditës. Mua më pëlqen ajo dritë-hije, prandaj, sa herë vete në shtëpi, marr një stol, ulem aty dhe rri një copë herë.

Kur hyj në odën e madhe, siç i themi ne, të katra dritaret i gjej të hapura. Në të dyja dritaret që vështrojnë nga lindja degët e ftonjve po-



thuaj kanë hyrë brenda. Nuk ka gjë më të bukur dhe erë më të mirë sesa ajo e ftonjve të pjekur, që natën, kur fle, të rrinë mu te koka si henëza të vogla, të verdha.

Tavanit të odës vende-vende i ka rënë suvaja. Vëllai ka ndërtuar shtëpi të re dhe kjo e vjetra sikur është lënë ca pas dore. Po odën e gjej të shtruar si gjithmonë: në të dyja anët e oxhakut janë vënë dy mutafë të mëdhenj e sipër tyre janë shtruar shilte dhe lëkurë delesh. Në një-rën anë të oxhakut ulem unë, në anën tjetër vëllai. Unë ulem në vendin e gjyshit, vëllai në vendin e babait. Ata tani nuk janë më dhe neve sesi na vjen... Në fund të odës është një krevat hekuri, krevati i gjyshit. Në të nuk fle njeri veç meje, kur vij në fshat. Kjo ishte dëshira e gjyshit dhe ne të gjithë e ruajmë.

Edhe atë ditë, kur shkova në shtëpinë e prindërve, nëna mori dy çarçafë borë të bardhë dhe ma bëri shtratin gati, megjithëse ende nuk kishte ardhur as dreka. Jashtë djali im pesëvjeçar luan-te me fëmijët e vëllait. Nëna atë e shikonte me mall nga dritarja dhe zemra i grafullonte nga gëzimi.

U rehatova në shilte, në krye të vendit. Vëllai më dha dorën sikur të mos më kishte takuar fare në oborr.

— Mirë se erdhe! — më tha.

— Mirë se ju gjeta!

— A na bën një kafe? — e pyeti ai nënën.

— Prit, sa të vijë edhe Zeneli, — tha nëna.

Zeneli është xhaxhai im, vëllai i babës. Menjëherë në fytyrën e vëllait ra një hije mërzie. E vura re dhe e pyeta:

— Ç'ka ndodhur?

Por ai sikur nuk e dëgjoi pyetjen time. Rrinte i heshtur dhe kokulur, sa unë u shqetësova

me të vërtetë dhe e përsërita pyetjen më me këmbëngulje:

— Ç'ka ndodhur?!

— Hiç, — tha vëllai si i lodhur. Pastaj, duke më vështruar në sy, shtoi: — Kemi hallin e Buqes. Jemi ngatërruar keq me xhaxhanë. Mirë që erdhe, se ty të dëgjon.

— Ç'i ka ndodhur Buqes?! — pyeta i habitur.

Buqja është vajza e vogël e xhaxhait, njëzetvjeçare, e gjatë, me vetulla të holla dhe të ngritura lart, me sy të mëdhenj e të kulluar, me ca qerpikë të dendur që i bëjnë hije në fytyrë. «Syfilxhania e nënës», i thoshte asaj gjyshja. Unë atëherë nuk i kuptoja fjalët e gjyshes, por tani jam i bindur se figurë më të bukur nuk mund të gjendej për ata sy ëndërrimtarë, që shprehnin gjithnjë butësi e mirësi dhe kishin kurdoherë një dritë të pruarë gëzimi e hareje.

— Buqja është ngatërruar me një traktorist, — tha vëllai qjefprishur. — Me njëfarë Nebiu... Xhaxhai e ka marrë vesh dhe është tërbuar nga zemërimi. Ai nuk do ta shikojë me sy atë traktoristin, lëre më t'i japë Buqen... Shkurt, i ka hipur gomarit nga bishti.

— Po ti ç'mendon? — e pyeta vëllanë.

— Ç'të mendoj? Ai është djalë i mirë, Buqja e do, ç'ka këtu për të menduar?!

— Buqja e do, ë? — pyeta unë sikur doja të sigurohesha për këtë.

— E do, por edhe ajo tërrci-fërrci është. Nuk ia pret xhaxhait: o Nebiun, o askënd. por hesht... Pse, merr vesh xhaxhai ashtu?!

Më hipi njëfarë mërzie dhe vështrova nga dritarja. Nëna hyri në derë si një hije dhe e kuptoi se po bisedonim për punën e Buqes. Doli pa u ndier që të na linte vetëm. Por unë nuk pata dë-

shirë të bisedoja më. Do të vij pas pak, i thashë vëllait dhe dola.

— Dëgjo, — më porositi ai, — Xhaxhait mos ia zër në gojë këtë gjë!

— Përse?! — pyeta i habitur, se vëllai pak çaste më parë kishte shprehur kënaqësinë se unë mund të ndikoja te xhaxhai.

— Po ja, do të thotë, i paskan thënë Xhevos më të ardhur... Eh, si është ai... Merr në thua për higjë...

Poshtë shtëpisë sonë është ajo e xhaxhait. Mora udhën pa ditur as vetë nëse duhej të shkoja apo jo, të paktën për atë kohë... Bahçja e tij është ndanë udhës. Buqja ishte aty, mbështetur pas manit të madh. Rrinte menduar, me vështrimin si të mjegulluar dhe në sy kishte një brengë të lehtë. Sa më pa, bëri buzën në gaz dhe erdhi drejt meje. Më hodhi duart në qafë, më përqafoi sikur të mos më kishte parë për një kohë shumë të gjatë. Sytë e bukur e të mëdhenj sikur i ishin bërë me hije, me një hije të zyrtë, që i trishtonte shikimin dhe tërë fytyrës i jepte një pikëllim të ëmbël... Po kthjellime kishte në ata sy, kishte kur qeshte...

— Sa mirë që erdhe, Xhevo, — foli ajo me zërin e saj joshës, po të dridhur. — Ti vjen shumë rrallë, duhet të vish më shpesh...

— Po, Buqe, duhet, — i thashë. — Po ç'kemi kënde? Babai si është, po të tjerët?

— Mirë, — tha ajo me gjysmë zëri.

Doja t'i përmendja punën e fejesës, por nuk dija se nga të filloja. Nuk ma kishte marrë kurrë mendja që të bëhej fjalë kaq shpejt për fejesën e saj, por ja...

— Buqe, ti sikur... me një traktorist... — u ngatërrova keq unë.

Po edhe kaq mjaftonte.

— Po, — tha ajo pa iu dridhur zëri, — e dua Nebiun!

— E njoh, — i thashë, — është djalë i mirë.

Buqes iu bë qejfi shumë që unë thashë ashtu për Nebiun. Vërtet e njihja, se e kisha pasur nxënëse, ishte i zgjuar e i shkathët, por me mësimë nuk shkante dhe aq mirë se nuk mësonte rregullisht.

Atë çast xhaxhai doli nga shtëpia me një shat në krah. Bëri sikur nuk më pa dhe u kollit. Ajo kollitje sikur më thoshte: edhe ti, Xhevo, po komploton kundër meje, ë? Buqja u turbullua dhe u skuq sikur xhaxhai ta kishte parë me Nebiun dhe jo me mua...

— Po xhaxhai ç'thotë? — e pyeta kot Buqen.

— Babai nuk do as të dëgjojë për Nebiun. E ka marrë inat, — tha ajo.

— Mirë, Buqe, do të bisedoj edhe unë me xhaxhanë...

— Tani mos bisedo, — m'u lut ajo si vëllait. — Babait i ka hipur inati dhe nuk do t'ia dijë as për ty... E pe, u kollit dhe iku tutje, sikur nuk të njohu kush ishe.

— S'ka gjë, Buqe, s'ka gjë. Ia fal xhaxhait unë.

— Po ai nuk e ka me ty...

— Ai e di se jam me ju...

Buqja qeshi. U ndava me të dhe u ktheva në shtëpi. Djali i mesëm i vëllait, Simi, që sapo kishte mbaruar klasën e katërt, më tha se dreka ishte gati.

— U takove me Buqen, ë? — më pyeti ai.

Pyetja e tij m'u duk e çuditshme.

— Po, — i thashë duke e vështruar në sy. — E pastaj? Të mos takohem unë me Buqen?

— Kjo do atë traktoristin, — tha sikur të

ishte burrë i madh, por edhe sikur të ishte lënduar në sedër.

— Cilin? — pyeta sikur nuk dija gjë.

— Ja, atë që punon atë ngastrën atje, — tha Simi duke treguar me dorë hamulloren.

— Po mirë, more Simi, ç'të keqe ka pse e do Buqja atë traktoristin? — e pyeta.

— Nuk do xhaxhai, — tha ai.

— Po atë ka për ta marrë Buqja e jo xhaxhai, — u përpoqa të bëja humor unë.

Po Simi nuk e vuri buzën në gaz.

— Xhaxhai është zemëruar, se ai, Nebiu, është i pabesë.

— Po pse qenka i pabesë?! — pyeta i habitur unë.

— Një natë është takuar me Buqen te bahçja.

— Po ti nga e di?

— I kam parë me këta sy, — tha Simi dhe preku të dy sytë me duar.

— I the xhaxhait? — e pyeta.

— Nuk i thashë, por nuk më erdhi mirë kur i pashë... Po ta dijë xhaxhai, i vret...

— Jo, more, si u vritkan njerëzit sikur të jenë miza!

— Po ti ia ke harruar kokën xhaxhait?

— Nuk e bën xhaxhai këtë që thua ti. Nuk ka përse ta bëjë, — i thashë dhe qesha për atë hije zemërimi që i rrihte Simit në sy dhe për atë merak të madh që e kishte kapur për Buqen.

— Demek, ti qenke rojë. — i thashë.

— Ç'rojë! — tha ai i habitur dhe i fyer.

— Po ja, a nuk i ruan ti kur takohen?

— Më ka porositur xhaxhai, — tha ai sikur donte të shfajësohej. — Më ka thënë që, po të shikoja gjë ta lajmëroja menjëherë.

Xhaxhai nuk erdhi për drekë që të më takon-

te, megjithëse vëllai e thirri. Nuk erdhi as për darkë. Vonë, kur kishim mbaruar së ngrëni, erdhi dhe u ul në njërën anë të oxhakut dhe, si më pyeti për gruan dhe fëmijët, heshti. Nëna dhe vëllai rrinin si të ngrirë dhe prisnin kur të hapej biseda për Buqen dhe Nebiun. Po nuk ia zura në gojë fare atë natë dhe xhaxhai më vështronte me mirënjohje. Kur po ikte, dolëm për ta përcjellë. Të tjerët i dhanë dorën në oborr, sepse e kuptuan që duhej të na linin vetëm. Morëm rrugën e ngushtë midis purtekave që mbanin shermendët e rrushit. Nata ishte me hënë dhe me yje. Misrat kishin nxjerrë xhufkë, era e tyre karakteristike përzihej me erën e jonxhës së kositur dhe erën e hideve. Qetësia, të futej në shpirt dhe unë e xhaxhai patëm një mirëkuptim të heshtur dhe një afri ndjenjash.

— E kisha një fjalë, xhaxha, — i fola.

— Fol, Xhevo!

— Të mirën dhe të keqen e kemi bashkë, xhaxha. Nderi yt është dhe nderi im.

— Është, — tha xhaxhai.

Më dukej krejt e natyrshme të flitej për nderin dhe për dashurinë aty, midis pjergullës dhe misrave, në tokën e njomur nga vesa dhe të praruar nga drita e hënës. Për gjërat e ndershme e të dashura nganjëherë flitet më mirë në natyrë. Ajo bisedë sikur na lehtësohej nga misrat, pjergullat, hidet, lumi që dukej si një fashë drite.

— Xhaxha, unë them t'ia japim Buqen atij traktoristit. Nebiu është djalë shumë i mirë. E njoh se e kam pasur nxënës.

Xhaxhai nuk foli. Shikoja profilin e tij të prerë. Fytyra e tij, nën dritën e hënës, dukej si prej bronxi. Kishte fytyrë të hequr, me mollëza pak të dala, me ballë të lartë dhe sy të mëdhenj.

— Xhevo, — më tha ai pasi u mendua një

copë herë, — të çmoj dhe ta mbaj hatrin shumë, por kjo që më thua është punë që nuk bëhet. Edhe po të ma kishte kërkuar Buçen një djalë që unë ta bëj dhëndërr, nuk do t'ia jepja kështu, menjëherë, jo më për atë Nebiun, që nuk dua ta shikoj as me sy... Nëse nuk do të prishemi bashkë, mos ma zër më në gojë...

— Unë nuk kam ardhur për të prishur punë, por për të ndrequr, — i thashë.

— Punët e mia i ndreq vetë, Xhevo!

Këto fjalë për mua qenë të rënda dhe të papritura. Kurrë nuk më kishte shkuar ndër mend se xhaxhai mund të fliste ashtu.

— Mirë, — i thashë duke e përmbajtur veten, — po të paktën të di se përse ngul këmbë kështu! Kur nuk po ta mbush mendjen unë, mbush ma ti... Besoj që u nxitove kur the punët e mia i ndreq vetë! Deri më tani nuk i kemi ndarë punët!

Xhaxhai e kuptoi se më kishte prekur shumë me ato fjalë dhe sikur u zbut ca. Më shikoi në sy dhe ai shikim ishte disi më i butë dhe më shpresëndjellës.

— Pak më parë më fole për nderin, — më tha ai.

— Po, — thashë unë pa ditur se ku do të dilte.

— Ai, Nebiu, po të jetë djalë i mirë, siç thua ti, nuk vjen të takohet natën me vajzën time bahçeve, por vjen drejt e në shtëpi e më thotë kështu e kështu është puna... Ai është zagat dhe ti më thua është djalë i mirë... Po fajin ma ka vajza mua, e di, se, po nuk desh buça, nuk i shkojnë prapa qentë...

— Mos fol kështu, xhaxha, — i thashë. — Nuk ka asgjë të keqe nëse ata janë takuar dhe kanë

biseduar me njëri-tjetrin. Po unë as që e mendoj këtë për Buqen dhe Nebiun.

— Në atë krah fli ti.

— Po edhe sikur të takohen, ç'të keqe ka? Ata duan ta njohin njëri-tjetrin, pastaj të vijnë e të të thonë ty jo kështu, jo ashtu...

— Jo, more, — u nxeh papritur xhaxhai. — Demek ne, që i rritim ta marrim vesh në fund se ç'bëhet, ta marr vesh kur të më bjerë dobiçin në derë.

— Xhaxha, nuk është fjala për takime të tilla. Nebiu është djalë i ndershëm dhe mua më vjen keq që po e përgojojme kështu.

— Drejt e ke, e lëmë këtë muhabet. Mos ma zër më në gojë dhe pikë!

Ai deshi të ikte pa më dhënë as dorën.

— Prit, prit, të lutem, — i thashë duke e kapur lehtë pas mëngës së xhaketës. — Këto punë nuk zgjidhen kështu, me të nxehur.

Xhaxhai qëndroi dhe më shikoi në sy. Shikimi i tij ishte i ftohtë dhe i zyrtë, ai nuk premtonte asgjë të mirë. «Ç'më je qepur kështu...», sikur thoshte vështrimi i xhaxhait. Dhe për kë se, për një palo Nebi që nuk e meritoi as t'i zësh emrin në gojë... Ik, Xhevo, hiqmu sysh, se do të prishe-mi bashkë...»

— Në jetë nganjëherë nuk bëhet ashtu siç duam ne, — i foli xhaxhait. — As ti as ne nuk e kishim menduar se do të vinte një ditë që Buqja me atë... Nebiun... Por ja... Në jetë...

— Me vajzën time bëj si dua vetë, — ma preu fjalën xhaxhai.

— As me vajzën nuk bën dot siç do, — i thashë me një ton pak të ngritur. — Ka ikur ajo kohë kur ndjenjat e vajzave merreshin nëpër këmbë. Pse, mos do të na kthesh një shekull prapa?



— Xhevo, mos më mbaj konferencë mua, more vesh? — m'u gërmush xhaxhai. — Uha, këto i kam dëgjuar unë... Kur do ta ndash drejt një gjë, duhet të kesh një thikë me dy maja, njëren majë e vë në barkun tënd, tjetren në timin... — Xhaxhai vuri dorën në bark sikur po rregullonte vërtet thikën. — Jepi, atëherë, se, sa më dhemb mua, të dhemb edhe ty... Po kështu? Aha, kështu e ke kollaj ti! Jepja, thua, jepja vajzën atij maskarait. Vetë do të hiqesh përparimtar, Xhevo, kurse mua do të më vësh vulën e turpit.

Në fillim më erdhi inat që foli ashtu, po dalëngadalë vendin e tij e zuri një keqardhje, që vinte duke m'u rritur. «Xhaxhai im i dashur, thashë me vete. Po si mund të flasësh kështu?! Po a dua unë të turpërohesh ti?! Hë, si ta merr mendja? Po a nuk është turpi yt dhe imi? Ja, atë thikën që ma përmende pak më parë, tani po ma ngul vetëm mua... Po për ç'turp më flet, xhaxha... Ku ka turp këtu?» Ato çaste duhej të isha i pikëlluar, se xhaxhai, megjithëse ishte i nxehur shumë, më vuri dorën në sup e më tha:

— Bisedojmë prapë, Xhevo, këtu jemi. Natën e mirë!

— Natën e mirë!

U ndamë duke i dhënë dorën njëri-tjetrit. Vëllanë e gjeta në oborr duke pirë duhan nën hijen e pjergullës. Siç dukej, më kishte pritur për të marrë vesh përfundimin e bisedës.

— Hë? — më pyeti.

— Nuk bisedohet me të, — thashë.

— Lisi nuk pritet me një të rënë, — më tha vëllai.

— Kështu është, por mua më duket se është e kotë... E ka vendosur!

— Them t'i lëshojmë në qafë edhe xhaxhamadhin.

Po xhaxhamadhi ishte rënduar nga veshët dhe kishte kohë që nuk përzihej në punët e fisit. Fjala e tij kishte rëndësi, por ai ishte si ata drynat, që, po nuk ua dite sekretin, nuk i hap, sado që të përpiqesh. — Hyn në këtë punë, xhaxhamadhi? — pyeta.

— Ai e do Nebiun, — tha vëllai. — Me gjyshin e Nebiut kanë qenë ushtarë në Canakala, siç thotë.

— Aleatë duam, — thashë. — Pa të shohim...

— E bisedova një ditë me të dhe ai më tha: do të vij një ditë t'ia tund shkopin në fytyrë atij Zenelit!

Të nesërmen shkuam te xhaxhai unë dhe xhaxhamadhi, i cili u ul në krye të vendit. Xhaxhai na pyeti për shëndetin dhe na bëri kafe.

— Ore Zenel, — foli xhaxhamadhi duke tundur shkopin, që nuk e hiqte nga dora kurrë, — burri duhet të jetë man që të shkundet vetë dhe jo arrë që të kapësh taruken!<sup>1)</sup>

— Man jam, — tha xhaxhai, që e kuptoi se ku donte të dilte xhaxhamadhi.

— Po të jesh man, nuk han taruka kot shpinës... Kaq di unë...

Xhaxhai nuk tha as mirë, as keq. Por as edhe xhaxhamadhi nuk i kërkoi që të thoshte më shumë. Ai nuk e kishte zakon ta turrte muhabetin. Me të cse merreshe vesh që në fjalët e para, ose nuk merreshe vesh kurrë.

Si piu kafën, xhaxhamadhi u ngrit e iku. Te pragu, kur po e përcillnim, trokiti tri herë shkopin në kallërim sikur donte të thoshte: kështu si thashë urë bëni! Dëgjuat! Kështu vepronte ai përherë. Unë ndenja edhe një copë herë, ndërsa

---

1) Shkop i gjatë që përdoret për të shkundur arrat.

gruaja e xhaxhait e hapi prapë bisedën për Buqen.

— Dhëndër më të mirë se Nebiun nuk dua, — tha ajo. — Unë e dua, djali e do (ata kishin një djalë ushtar, i cili u kishte shkruar se ishte dakord që Buqja të fejohej me Nebiun), vajza po e do, atëherë kush mbetet? Pse, — iu drejtua ajo të shoqit, — ti kundër të gjithëve do të dalësh? Po Buqja nuk është vetëm jotja. Mos kujto ti se të gjithë ne të tjerët jemi pa mend në kokë?

Prisja që xhaxhai ta kërcënonte ose ta shante, por ai veç e vështroi në sy. Tha:

— More, po pse po ngushtohemi kështu? Buqes nuk i ka kaluar koha! — dhe bëri një lëvizje me dorë që shprehte mërzi dhe sikur thoshte: më lini rehat tani... Dhe unë e lashë, nuk i foia më. U ngrita e dola. Xhaxhai doli pas meje. Tashë se doli për të më përcjellë, por ai më tha:

— Biem njëherë nga lumi...

Unë e dija dëshirën e tij: donte të shikonte ato bregoret që shtriheshin ndanë lumit, në krahun e djathtë të tij. Ato kodrina janë mbjellë me mollë dhe xhaxhai njihet në tërë krahinën si kultivuesi më i mirë i mollëve. Ai u shërbente, ndaj kishte qejf t'i shikonim bashkë. Pranova me dëshirë të madhe. Duke parë mollët e duke biseduar, nuk e morëm vesh si kaloi koha. Veç kur erdhi mbrëmja! U kthyem të lidhur më shumë se kurrë shpirtërisht. Kur ishim duke u ndarë para shtëpisë së vëllait, më tha:

— Xhevo, kam vetëm një hall që jam kundër atij Nebiut...

— Ç'hall ke, xhaxha?

— Sikur të mos kishte vepruar ashtu, si hajdut, mbase nuk do të ngulja këmbë.

— Po kush të ka gënjyer? Ai nuk është takuar fare me Buqen!

— Nuk më ka thënë njëri, por ma ndien zemra.

— Nuk janë takuar, xhaxha, — i thashë.  
Unë pyeta edhe Simin. Ai më tha se nuk e kish-  
te parë kurrë Nebiun të vinte këndeje as natën,  
as ditën, — gënjeva unë.

— Ç'është ai Simi, — tha xhaxhai dhe qeshi;  
— edhe po ta ketë parë, nuk tregon ai!... Nuk  
do të ngatërrojë njerëz ai...

Biseda me xhaxhanë papritur kishte hyrë  
në një shteg me dritë. Tani ecnim midis një ra-  
dhe plepash të bardhë dhe një gardhi hideshow. Ish-  
te një rrugë e gjatë dhe e bukur që përfundonte  
te stallat. I ramë dy herë ec e jak asaj rruge du-  
ke biseduar.

— Them të mos e zgjatim këtë punën e Bu-  
qes, xhaxha! — i fola.

— Të shohim, Xhevo, — tha ai krejt i zbutur.  
— Këtu jemi dhe kemi për të biseduar prapë.

U ndamë vonë, duke i shtrënguar duart njëri-  
-tjetrit. Kur hyra në dhomë, djalin tim e kishte  
zënë gjumi, kurse Simi, që flinte në një dhomë me  
ne, ishte zgjuar. Nuk e ndeza dritën, u zhve-  
sha dhe hyra në shtrat.

— Biseduat për Buqen? Ç'të tha xhaxhai? —  
më pyeti Simi.

— Biseduam, por xhaxhai nuk thotë as po, as  
jo. Nuk e ndan llafin.

— Po xhaxhai nuk e ka zakon kështu: as po,  
as jo.

— Po disa gjëra, si kjo fejesa e Buqes, nuk  
bëhen fët e fët. Po fli tani se besoj që do të rre-  
gullohet.

Simin pas pak e zuri gjumi. Por unë nuk ki-  
sha gjumë fare atë natë. Jashtë nuk dëgjohej tje-  
tër veç zhurma e një vije uji që zbriste teposhtë  
e binte në ara. Që nga dritarja e hapur shikoja  
ngastrat me misra, fidanishten e plepave dhe  
gardhin e dendur të hideve. Kumbullat, në dritën  
e hënës, dukeshin krejt të verdha.

Papritur, sipër shtëpisë, dëgjova një zhurmë, diçka si kërcitje, sikur të ishte thyer një krande e thatë. Ishte e qartë: dikush po kalonte nëpër shtegun e gardhit. Dëgjova ca hapa të rëndë. Kush do të jetë? Zgjata kokën në dritare. Ishte Nebiu. I pashë shpatullat e gjëra dhe vetëm nga ato e njoha. U ndal nën hijen e një molle, në të cilën ishte kacavarur një pjergull me rrush të bardhë. Molla, me ato degët e rrushit që e kishin mbuluar dukej si një çadër e madhe, e blertë. Nebiu u fut nën degët e saj dhe nuk lëvizi. Nuk kaluan më shumë se dhjetë minuta, kur, nën dritën e hënës, dallova një siluetë njeriu. Ishte Buqja. U takuan dhe filluan të çuquritnin.

Të them të drejtën, për disa çaste më kapi një valë zemërimi, por shpejt e kuptova se kështu po bëhesha tamam si xhaxhai. Nuk kishte asgjë të pandershme që dy njerëz që dashuroheshin të takoheshin natën, të bisedonin nën hijen e një molle të qarkuar me rrush dhe, pse jo, edhe të putheshin. Hapa derën dhe, pa u ndier fare, dola në kopsht. Nga Buqja dhe Nebiu më ndante vec një shpor i hollë misri. Zërat e tyre vinin të qartë deri tek unë dhe të mbushur me shqetësim.

— Xhaxhamadhi e Xhevoja kanë biseduar me babanë, — tha Buqja.

— Po ç'tha Zeneli? E dha fjalën?

— Fjalën nuk e ka dhënë, — tha Buqja duke psherëtirë.

— Si kështu?! — pyeti Nebiu i habitur. — Nuk është zbutur fare?

— Zbutur është, por fjalën nuk e ka dhënë... Po këto punë nuk bëhen menjëherë, duhet të kemi durim.

Pastaj ajo se ç'tha diçka që unë nuk e dëgjova dhe të dy qeshën...

## Një krah jonxhë

Ali Kamberi po kthehej nga pylli. Kishte vënë para kalin me dru dhe ecte në një rrugë të tërthortë, që e priste përmes pyllin plot me lajthi. Poshtë ishte ceka, plot shelgje dhe verrinj dhe më tej, nëpër zhurin plot me gurë të bardhë e të rrumbullakët, rridhte lumi. Dielli që prej gjysmë ore kishte perënduar. Nata binte ngadalë dhe si pa kuptuar, duke përzënë zagushinë e asaj dite qershori, me erën e freskët që vinte nga gryka e lumit. Ngjyra e gjelbër e dushkut dhe e lajthive, e verdha e grurit, grija masive e breglumit shkëmbor, po shkriheshin e treteshin në një: në një ngjyrë të mbyllur, të zezë. Veç lumi bëhej gjithnjë e më i dukshëm. Ai tani dukej si një fjongo e madhe e bardhë që përdridhej pas shelgjeve dhe verrinjve, përplasej në bregun shkëmbor dhe humbiste tutje, pas kodrës.

I biri i Aliut, Fatriu katërmbëdhjetëvjeçar, që ishte i shqetësuar se i ati po vonohej më shumë se zakonisht, kishte dalë që ta priste në rrugë. Ishte ulur te Lisi i Madh dhe vështronte i mërziur andej nga duhej të vinte ai. Në fillim ndjeu trokun e kalit, pastaj pa të atin që ecte ngadalë pas kafshës. Fatriu zbriti teposhtë kodrës me zemër të qetësuar dhe u ul në lëndinën e vogël me

mollë, mu sipër rrugës. E donte shumë të atin, jo vetëm si prind, por edhe se tek ai shikonte njeriun e punës. Por ajo ndjenja e makutërisë, që e kishte vënë re shpesh tek ai, nuk i pëlqente dhe e lëndonte në shpirt. I ati, për të pasur sa më shumë mall dhe gjë, bënte edhe gjëra që Patriu as që mund t'i mendonte...

Fatriut iu kujtua kur kishin pasur një lopë. Në mbrëmje babai merrte draprin dhe hërte kashtë misri, gjoja nga ajo që nuk kishte lidhur kalli. Fillonte në arat e veta, por në të vërtetë kalonte mejë më mejë, si hajdut, dhe hynte në arat e të tjerëve. Kthehej vonë, me krahun e mbushur me misra që ishin gati për t'u korrur. Vetëm tek-tuk dukej ndonjë kashtë pa kalli. «Ç'bën kështu? — e kishte pyetur e shoqja një natë. — Ti po na e lë arën djerr duke prerë misër për lopë! Mirë lopa, po ne ç'do të hamë?!» «Hë, ti, hë, se e di unë ç'bëj», ishte përgjigjur Aliu, që e kishte ndier veten shumë të kënaqur. Ja, këto ia kishin zbehur shumë babanë Patriut. Po ata hynë në kooperativë dhe, natyrisht, djalit nuk i shkonte ndër mend që i ati mund të vepronte si dikur...

Aliu goditi kalin që të ecte më shpejt, megjithëse ai ishte një kalë që nuk kishte pse të vije thupër në të. Nga vithet dhe gjoksi i tij rridhnin rrëketë e djersës, duke formuar ca degëzime të çuditshme që ngjanin me kapilarët e gjakut. Fatriut i vinte keq për kalin. I ati e ngarkonte rëndë dhe e rrihte me një thupër të trashë thanc.

— Nga i kullote dhentë sot? — e pyeti ai të birin.

— Në cekë, baba!

Ali Kamberi u bë prush në fytyrë, sikur t'i kishte dhënë dikush një shuplakë të fortë.

— Doemos që në cekë do t'i kullotësh ti. Të

njoh se kush je. Edhe në shtëpi i mbyll së bashku me pulat, — i tha me zemërim.

— Unë nuk bëj ndryshe, nga të tjerët, baba, — tha Patriu, i habitur nga pakënaqësia e t'et. — I kullot si të gjithë dhe i mbyll kur i mbyllin të gjithë.

Aliu ia nguli sytë të birit dhe e vështroi gjatë e rreptë.

— Budalla që je, — iu gërmush. — Mos shiko të tjerët! Këtu është puna kush mund të ta kallë! T'i kishe afruar një çikë andej nga livadhet. Dhentë atëherë ngopeshin tamam. Se delja, në do ta dish ti, ta vjedh kullotën. Nga një çikë e nga një çikë dhe e mbush barkun. Po kjo nuk mund të bëhet ditën në drekë. Me të perënduar dielli dhe vrap e në shtëpi ti... Në vend që të veje poshtë, në livadhe, e t'i rripje ngadalë, nga një çikë e nga një çikë... Po je zemërpulë ti, o Patri!

E vështroi të birin me përbuzje. Tha:

— Me kë flas dhe unë! Ti nuk ke si ta bësh atë që thashë, se ke frikë nga syri i vetëm i Bamkë qorrit. Por ai nuk shikon ditën, more budalla, jo më të shikojë natën. Derdimen!

Aliu u ra me tërbim vitheve të kalit dhe kafsha gati po merrte vrapin. Patriut iu kujtua prapë diçka, se bash kur babai bënte kështu, si sonte, atij i kujtoheshin veç gjëra të hidhura...

Kishin pasur një shpore te Livadhet e Mëdha. Ali Kamberi, me të perënduar dielli, merrte kalin, lopën, dhentë dhe i shpinte aty. I mbante gati deri në mesnatë, por jo në livadhin e vet, po në ato që kishte në të djathtë e në të majtë.

— Të thashë, — i bërtiti krejt pa shkak prapë të birit, ti ke frikë nga syri i vetëm i Bamkë qorrit. Je zemërpulë dhe nuk bën për kurr gjë. Syri i Bamkë qorrit të duket si diell!



Bamkë Novruzi ishte roja i kooperativës. Ai vuante nga njëri sy dhe të shumtën e kohës e mbante të lidhur, prandaj Aliu e quante Bamkë qorri. Po jo vetëm për këtë... Bamka dikur e kishte kapur Aliun duke kullotur kalin në jonxhën e kooperativës dhe e kishte gjobitur. Kjo kishte ndodhur dy vjet më parë, por Aliu nuk e kishte harruar.

Ecnin në heshtje. Prapa malit doli hëna. Tërë fusha u la me një dritë të verdhë. Kalit i pihej ujë dhe Fatriu e afroi te lumi. Kali piu i kënaqur dhe Fatriut iu duk se ai piu edhe diskun e hënës që pasqyrojhej në lumë. I ati dukej që ishte zbutur se ndezi një cigare dhe filloi ta pinte tërë qejf. Fatriu po mendonte për mësimet e nesërme. Nuk e vuri re të atin që ndërroi drejtim dhe u fut në ngastrën me jonxhë, duke e shtyrë kalin nëpër një udhë të ngushtë, që ishte sajuar nga të shkelurat e njerëzve.

— Përse ia mbajte këndeje, baba? Këndeje nuk ka rrugë për kafshë, bile edhe njerëzit nuk duhet të kalojnë... — i tha Fatriu.

— Këtë e di unë, — tha prerë Ali Kamberi dhe u prish në fytyrë.

Fytyra e Aliut ishte si një mot i paqëndrueshëm, që aty hapet e kthjellohet, aty priset. Fatriut i mbeti në mendje ajo: «e di unë». Babai po flet si Mato Gruda, mendoj dhe i erdhi të qeshte, por e përmbajti veten. Edhe kjo më duhet tani, që të zbardh dhëmbët, tha me vete dhe u bë serioz. Ndërkaq i ati i tha:

— Vëre kalin përpara dhe drejt e në shtëpi!

Fatriu i ra kalit, por mendjen e kishte tek i ati. U çudit kur vuri re që ai hyri në jonxhën e sapokositur dhe filloi ta mblidhte e ta bënte grumbull në një vend. Hoqi brezin dhe, pasi e ngjeshi jonxhën mirë e mirë, e bëri deng, e hodhi në sup. «Prapë po vjedh», mendoj Fatriu dhe u zverdh

nga zemërimi. «Edhe tani po vjedh, si dikur... po vjedh kooperativën...» Ndjeu një si zagushi në tërë trupin. Por i ati, sikur të mos kishte bërë asgjë të keqe, nxitoi dhe iu afrua.

— Ndale kalin që t'ia hedh në shalë, — tha.

Po Patriu bëri sikur nuk dëgjoi. I ra kalit me thupër dhe ai shpejtoi hapin. I ati nxitoi dhe e arriti.

— Ku e çon këtë jonxhë, baba? — e pyeti Patriu.

— Që ta hash ti për darkë, — tha ai me zemërim.

Po kali kishte ecur mjaft përpara dhe Aliu i tha Patriut:

— Ec pas kalit, se po e mbaj vetë!

Potkonjtë e kalit trokëllinë në rrugë. ,

— Kjo është vjedhje, baba, — i tha Patriu.

— Ore, do më lësh rehat ti, apo si e ke hallin? — i tha Aliu duke dihatur nën peshën e jonxhës. — Bjeri kalit dhe mbyll gojën! Nuk je bërë të më mësosh mua! Një dorë jonxhë po marr, nuk bëhet kiameti për kaq. Pastaj po e marr në atë ngastër që e ruan Bamkë qorri. Le t'i pëlcasë edhe syri tjetër! Veç për inat të tij po e marr!

— Po ky nuk është malli i Bamkës, — vërejti Patriu.

— E, e, ai e ruan. Atij do t'ia vënë në ngarkim.

— Më vjen turp, baba, — tha Patriu duke u përpjekur ta shikonte në sy.

I ati lëshoi menjëherë dengun e jonxhës në tokë dhe Patriut për një çast i qeshi nuri se kujtoi që Aliu do ta linte jonxhën. Po Aliu sa çel e mbyll sytë ia dha një shuplakë të fortë. Djalit iu errën sytë më shumë nga zemërimi sesa nga dhembja. Iu duk se nuk i digjte vetëm faqja, por tërë trupi. Pati përshtypjen se i morën flakë rrobat që kishte veshur. Në fyt iu mblodh një lëmsh,

bëri përpjekje që të mos qante, por nuk ia arriti. Lotët i rrodhën vetiu dhe i ranë faqeve. Ishin lot të hidhur.

— Kështu e do ti, — i tha i ati. — Dërrt-dërrt! Më çave veshët, firaun i firaunëve. Ktheje kalin këndeje, pas meje! Pse do ta nxjerrësh në rrugë të madhe?

Fatriu fshiu lotët dhe u nis me përtim, pa asnjë dëshirë, andej nga e urdhëroi i ati. Po ecnin në atë fshikun e barit të shkelur që dredhonte përmes jonxhishtës. Rruga, nën dritën e hënës, dukej si një plagë në sipërfaqen e tokës. Fatriu mezi i hidhte çapet. Ecte dhe mendonte: «Disa e shkelin jonxhën dhe e bëjnë udhë, disa e vjedhin, si babai im...» Një javë më parë në klasë kishin zhvilluar një mbledhje me temë: «Ta ruajmë si sytë e ballit pronën e përbashkët». Fatriu ishte nga nxënësit më të mirë të klasës. Ai kishte diskutuar dhe mësuesi e shokët e kishin vlerësuar si shumë të mirë diskutimin e tij. Tani Fatriut i dukej sikur shokët e shoqet e klasës, mësuesi, të gjithë, ia kishin ngulur sytë dhe po i thoshin: «Eh, Fatri, kështu eruan pronën e përbashkët ti?! Në mbledhje fole shumë mirë, po tani...» Po ç't'i bëj unë babait, tha Fatriu me vete, sikur po përgjigjej para klasës dhe mësuesit. Unë e bëra timen! Papritur ai mendoi se nuk kishte bërë gjithçka që duhej të bënte. Njëherë mendoi t'i dilte para babait dhe t'i thoshte që ta lëshonte dengun e jonxhës, ndryshe ai do të detyrohej t'ia rëmbente nga duart. Se sa do t'ia arrinte kësai, nuk e dinte, por do të përpiqej. Ai e dinte se i ati do ta rrihte keq, por më mirë ta rrihte sesa ta linte të vidhte...

— Bjeri kalit, — ia ndërpreu mendimet i ati. — Apo do edhe ndonjë tjetër? Ta dish, nuk përtoj unë.

Fatriu ishte gati t'i thërriste: më rrih, baba, nuk trembem unë, por ama jonxhën nuk do ta marrësh. Po bash atë çast në krye të jonxhës dalloi një njeri. Djalit i fërgëlloi zemra nga gëzimi.

— Yyy, para, — e nxiti ai kalin duke bërtitur me zë të lartë që të tërhiqte vëmendjen e atij që ishte në krye të jonxhishtës. Të atit, megjithëse nuk e kishte parë njeriun në krye të jonxhës nuk i pëlqeu ajo britmë e të birit. Për më tepër iu duk e gëzuar dhe nuk shkante me gjendjen e tij shpirtërore.

— Përse bërtet ashtu, — i foli ai të birit. — Mos do të mbledhësh tërë fshatin këtu? Ta tregoj unë sa të vemi në shtëpi. Të ftoris mirë unë, mos ki keq.

Fatriu nuk i bërtiti më kalit, por as nuk qe nevoja. Njeriu në krye të jonxhës ishte Bamkë Novruzi. Pas pak e pa edhe Aliu. Bëri dy hapa nga e majta dhe e hodhi dengun e jonxhës në një vijë pa ujë. Ai nuk pati kohë ta hiqte brezin, se Bamka ishte afruar shumë.

— Ti, Ali, je? — e pyeti ai.

— Po, — tha Aliu. — Bëra një kalë dru dhe i rashë për shkurt! Rrugë nuk ka këndeje, por e kanë shkelur të tjerët para meje.

Bamkë Novruzi iu soll rrotull kalit sikur të mos e besonte që ishte i ngarkuar me dru.

— Kishe gjë në sup ti, Ali, apo më bënë sytë mua, — tha Bamkë Novruzi.

— Veç kokën kam mbi supe, — u përgjigj Aliu.

— Ashtu?! — tha tjetri, që filloi të vinte rrotull sikur kërkonte diçka të humbur. Vajti te vija ku ishte hedhur dengu i jonxhës. — Po kjo jonxhë ç'do këtu? — e pyeti Aliun.

Aliu nuk foli. Ai do të mohonte gjithcka sikur atë jonxhë të mos e kishte lidhur me brez.

— Qorr do të më bësh ti? — e pyeti Bamka

duke e vështruar në sy. — E di se ti më quan Bamkë qorri, por qorr unë nuk jam. Njëri sy vërtet më dhemb, por tjetri më shikon qimen e bardhë në fund të tenxheres së kosit. Ja, ke vjedhur! Mos do të thuash se nuk e ke vjedhur ti këtë jonxhë? E paske lidhur edhe me brez, ë? Mirë, po nuk i dole për zot ti, e gjej nga brezi unë. Mbase po të bie më qafë kot.

Ali Kamberit i vinte të hante veten me dhembë nga zemërimi. «Ç't'i bëj brezit, tha me vete, pa dija unë se si të përgjigjesha, o Bamkë qorri!»

— Bjere brezin, unë desha ta merrja atë jonxhë, — tha Aliu.

Bamka ia dha brezin.

— Më mirë që i re drejt, — i tha Aliut, po sytë i mbante nga Fatriu. — Po ti, Fatri, sehir bëre? — e pyeti djalin, duke e vështruar nga afër.

Fatriu nuk foli, ai ishte gati t'ia kryste prapë të qarit. Për herë të parë gjatë asaj mbrëmjeje Ali Kamberit po i vinte keq për të birin. Pamja e tij ato çaste sikur i thoshte: «Unë jam si jam, por ky nuk është si unë. Djalin e kam birinxhi... Te djali nuk dua të më prekësh, o Bamkë qorri, se ndahemi keq...»

— Ky nuk është si unë, — i tha Aliu Bamkës. — Po të ishte edhe ky si unë, ti nuk kishe për të më kapur kurrë... Ky më kapi mua e jo ti!

Bamka iu afrua Fatriut dhe i vuri dorën në sup.

— Të lumtë, Fatri, — i tha me një ton atëror. Megjithëse i kishte fshirë lotët, purrinjtë e tyre dukeshin ende në fytyrën e djalit. Bamka ngri-ti kokën dhe vëstroj Aliun në sy. I tha:

— Paske vënë dorë edhe mbi djalin, t'u thaf-të...

Ali Kamberi atë natë nuk hyri drejt e brenda, siç bënte përherë kur kthehej nga mali. Ndenji për një kohë nën hijen e mollës duke u menduar.

## Roti

Jepja gjuhë dhe lexim në një klasë të tetë, ku isha dhe mësues kujdestar. Puna më çte mirë. Në klasë ishte krijuar një kolektiv luftarak dhe i papajtueshëm me të metat. Mbështetësha te të gjithë nxënësit, por sidomos te Dila Rena, një vajzë e shkathët dhe shumë e zgjuar.

Dila kishte shumë autoritet te shokët e shoqët e saj. Secilit i kërkonte llogari, por me takt, pa mendjemadhësi. Vetë ishte e shkëlqyer në mësim, por edhe të tjerët i ndihmonte me gjithë zëmër, pa ndier kurrë lodhje. Ajo gëzohej shumë kur ndonjë shok ose shoqe e klasës dilte nga prapambetja dhe merrte nota të mira.

Njëherë në mësimin e gjuhës ngrita Arifin, nxënës të dobët. I pata thënë që të mësonte me Dilën dhe ai kishte ditë që shkonte te shtëpia e saj. U përgjigj mirë dhe i vura tetë. Ja ç'bën ndihma e shokut, u thashë nxënësve dhe Dilës iu skuqën mollëzat e faqeve nga gëzimi.

Te Dila gjithçka ishte e përsosur. Kishte sy të kaltër, të bukur, trup të hedhur dhe flokët gështenjë, një gojë të vogël dhe buzë pak të fryra. Vishej thjesht dhe shumë pastër. Asnjëherë nuk

vinte në shkollë pa pantallona të hekurosura dhe pa këpucë të lustruara. Kur hyja në klasë, vetvetiu sytë më shkonin te Dila. Një ditë nuk e pashë në bankën e tretë të rreshtit të mesëm, në vendin e saj të zakonshëm, që nuk e ndërroi kurrë. U ngrit shoqja e klasës, Elvira, dhe tha:

— Mësues, Dila mbrëmë është shtruar urgjent në spital.

Nuk fola, shënova temën e mësimit në regjistër dhe nuk dija si të veproja: t'i vija mungesë Dilës apo jo. Ishte mungesa e parë që bënte. Më në fund i vura mungesë të arsyeshme dhe fillova mësimin.

Pasdite shkova në spital për ta parë. Ishte operuar nga apendiciti. Narkoza sapo i kishte dalë dhe vështrimin e kishte ende të mjegulluar. Iu afrova dhe i qëndrova te koka, ku i rrinin edhe nëna, babai dhe motra e vogël.

— Si je, Dilë? — e pyeta duke i kapur dorën, të cilën ia mbajta një copë herë në dorën time.

— Mirë, mësues, mirë, — më tha me një zë të lodhur.

— Shërohu shpejt se të presim, — i thashë duke vënë buzën në gaz.

Pas tri javësh ajo erdhi në shkollë. U çudita kur më tregoi fletoren e detyrave të gjuhës. Kishte zhvilluar të gjitha detyrat që u pata dhënë nxënësve gjatë asaj kohe që ajo kishte qenë në spital.

— Dilë, — i thashë, — ti je e çuditshme!

Desha t'i thosha ti je e mrekullueshme, por u përmbajta. Ia mora fletoren dhe ia korrigjova në shtëpi. Çdo detyrë ishte shkruar shumë bukur dhe zgjidhur me saktësi të madhe. Dila mund të shkruante pesë-gjashtë faqe hartim dhe të mos bënte asnjë gabim drejtshkrimor.

— Shumë mirë, Dilë, — i thashë duke i dhënë fletoren.

— Detyrat m'i ka sjellë Elvira, — tha ajo duke dashur që një pjesë të atij lavdërimi t'ia kalonte shoqes së bankës. Kështu bënte shpesh.

Edhe mësuesit e tjerë më thanë se ajo kishte shkuar në klasë me të gjitha detyrat e bëra. Në fillim të semestrit të dytë, një mëngjes, më thirri drejtoresha në zyrë. Më tha se kishte ardhur një nxënës nga një fshat i largët dhe se do ta regjistronin në të tetën «C». Ishte i veshur me pantallona kadife dhe me një peliçe. Emrin e kishte të çuditshëm: e quanin Roti. Vinte i ngjeshur në trup dhe pak i kërrusur. Rrinte si i përgjumur dhe nuk përzihej me të tjerët. Një ditë, kur hyra në klasë orën e parë, nxënësit i gjeta rrëmujë.

— Ç'bëhet këtu? — i pyeta.

Ata heshtnin. Vështrova Dilën, ajo ishte skuqur dhe mezi i mbante lotët. Në sytë e saj kishte zemërim dhe dhembje. U ngrit më këmbë Arbeni, një nxënës që mua nuk më pëlqente, se ishte shumë i llastuar dhe përpiqej gjithnjë të dilte si shpëtimtar i situatës. Këtë rol po e luan-te edhe kësaj here.

— Mësues, Rrota bën zhurmë, — tha ai.

Tërë klasa shungulloi nga të qeshurat. Roti u skuq në fytyrë dhe uli kokën i turpëruar. Kur panë vështrimin tim të zemëruar, nxënësit i prenë të qeshurat. Papritur Roti u ngrit më këmbë e tha:

— Unë quhem Roti!

— E, mo, se njëlloj është, aty afër, — tha Arbeni.

Kësaj here askush nuk qeshi me fjalët e tij, kurse unë zieja nga zemërimi.

— Ty, Arben, kushedi se si të duket vetja,



— i thashë. — Nuk është mirë të tallesh me shokët aq sa t'u shtrembërosh edhe emrat.

Dila më shikoi në sy me mirënjohje. Ajo sikur donte të më thoshte diçka.

— Fol, Dilë, — e nxita unë.

— Arbeni dhe Sherifi e ngacmojnë Rotin, — tha ajo e merakosur.

— Ai më shau, — tha Sherifi pa i dhënë leje që të fliste.

Sherifi ishte një djalë i shkathët, gjithë prenka në fytyrë, tepër i hedhur dhe reagonte shpejt e për gjithçka. I mbetej hatri po t'i thoshe një fjalë. Zemërohej për asgjë dhe pajtohej shpejt. Kur e qortoje, dëgjonte kokulur dhe pendohej sinqerisht, por ai harronte shpejt pse ishte qortuar dhe bënte të njëjtat gabime. Po kohët e fundit sikur ishte vënë në vijë dhe nuk kishte dalë në skenë, siç themi nganjëherë ne mësuesif. Po për një çast më shkoi mendja se mos me të vërtetë Roti i kishte ngacmuar.

— Jo, mësues, Sherifi e shau, Roti nuk ngacmon kurrë njeri, — tha Dila.

Tani Sherifi kishte ulur kokën. Është penduar, thashë me vete.

— Më tha «malok», — tregoi Roti me kokë nga Sherifi.

— Mos të të mbetet hatri, se malok je, — i tha Arbeni Rotit në syrin tim.

Sherifin edhe e duroja dhe nuk ia merrja për të keq ato që bënte, kurse me Arbenin kisha filluar ta humbisja durimin. Nuk di se si u përmbajta dhe nuk e fyeva.

— Unë jam malësor, jo malok, — tha Roti.

Ai tha ashtu dhe më shikoi në sy, sikur donte të më pyeste: hë, mësues, malok jam apo malësor?

— Roti është malësor, — thashë unë. Pothuaj

të gjithë jemi malësorë dhe për këtë duhet të jemi krenarë. Tani fillojmë mësimin. Pas orëve të mësimit e shikojmë se kush e ka fajin për këto që ndodhën.

Në fund të mësimit bëmë mbledhjen e klasës. Nxënësit u ngritën njëri pas tjetrit dhe kritikuan Arbenin e Sherifin që kishin ngacmuar Rotin. Kur mbledhja pothuaj kishte mbaruar, u ngrit Dila dhe tha:

— Unë mendoj që Roti të mos rrijë vetëm në bankë. Ne e kemi shok, pse ta lëmë vetëm?

— Po dikush duhet të rrijë vetëm, se klasa ka tridhjetë e tre nxënës, — tha Myneveri.

— Më mirë rri unë sesa Roti, — tha Dila. Roti u ngrit dhe foli:

— Edhe vetëm mirë jam. Nuk qahem për këtë.

Po mua pikërisht këto fjalë nuk më qetësuan. Dëshira e tij për të ndenjur larg shokëve më shqetësonte.

— Jo, Roti, nuk do të rri vetëm, — i thashë. — Ndërroje vendin me Dilën. Le të rrijë ajo vetëm në bankë.

Por Elvira, që në klasë të pestë kishte ndenjor në një bankë me Dilën, kundërshtoi të rrinte me Rotin. Nuk tha gjë me gojë, por të gjithë e kuptuan. E kuptoi edhe Roti.

— Do të rri atje ku isha, — tha Roti prapë. — Po deshi, Dila, le të vijë aty...

— Mirë, kështu të bëhet, — thashë.

Të nesërmen Rotin dhe Dilën i pashë në oborrin e shkollës duke shëtitur poshtë e lart. Deri atëherë nuk e kisha parë Rotin të shoqërohej me dikë. Megjithëse po bënte një muaj që kur kishte ardhur, në mësim nuk ishte pyetur fare. Nuk di pse ngurroja ta pyesja. Më shkante mendja që ishte nxënës i dobët e më vinte keq ta kapja të

papërgatitur. Dcrën nuk e ngrinte fare në mësim, kështu që nuk e merrje vesh nëse dinte gjë apo jo. Të vështronte në sy, po shfaqur asnjë ndjenjë. Edhe një gjë më bënte përshtypje tek ai: dritarja ku e kishte bankën vështronte nga rruga, ku kishte shumë lëvizje, por ai asnjëherë nuk e kishte hedhur shikimin në rrugë.

Një ditë në këshillin pedagogjik ra fjala për Rotin.

— Atë që ka ardhur nga fshati e ke krap fare, as jep, as merr, — më tha mësuesi i matematikës.

— Edhe tek unë nuk ia shkrep fare, — tha mësuesja e biologjisë.

— E keni pyetur? — i pyeta kolegët.

— Ç'ta pyes? — më tha mësuesi i matematikës. — Shko në drejtori dhe interesohu për notat e tij. Mund të ketë genë mbetës.

Të nesërmen orën e parë kisha gjuhë. Kisha shpjeguar fjalitë e përbëra me më shumë se dy pjesë. Zakonisht nxënësit stepen para analizave të vështira. Në fishe pata shkruar tri fjali me ndërtim shumë të vështirë. Njëra ishte nga një prozë e Nolit. Të parën ngrita Dilën. Ajo e shkroi fjalinë dhe filloi nga analiza. Erdhi dhe çasti kur ngeci.

— Kush e ndihmon? — pyeta klasën.

Askush nuk e ngriti dorën. Kur nuk e dinte Dila, do të thoshte se nuk e dinte askush.

— Kjo analizë është e vështirë, — i thashë Dilës. — Meqë nuk ka ndonjë tjetër për të thënë gjë, po e ndihmoj unë Dilën...

— Me leje, mësues, — foli dikush nga klasa.

Ktheva kokën dhe, i habitur, pashë që Roti ishte ngritur më këmbë. Ai po kërkonte të dilte në mësim.

— Kur nuk e bën dot Dila, ta bësh ti?! — i tha Elvira Rotit.

Po ai nuk i vuri vesh dhe, me hapa të ngadaltë, me atë të ecurën e tij karakteristike, qetë-qetë, doli në dërrasë, kapi shkumësin dhe filloi të shkruante. E ndau fjalinë, kaloi pra pengesën ku kishte ngecur Dila. Nxënësit, që gjer atë çast rrinin në pritje, si në ankth, psherëtinë të lehtësuar. Të gjithëve u qeshi fytyra. Edhe Dilës. Roti e ndau me saktësi të madhe fjalinë në pjesë, emërtoi pjesët, tregoi shkallën e secilës, ç'punë bënë etj.

— Shumë mirë, Roti, — i thashë duke i rënë lehtë shpatullave.

Nuk tregoi asnjë shenjë vetëkënaqësie. U ul në vendin e tij i heshtur dhe i qetë. Për disa çaste nuk dija ç'të thosha. Isha befasuar.

— Përse nuk e ke ngritur dorën kurrë? — e pyeta.

Ai nuk foli, veç u skuq. Mbase vërtet nuk e dinte se përse nuk e kishte ngritur dorën.

Atë që më ndodhi atë orë, ua tregova mësuesve në pushimin e madh. Mësuesi i matematikës nuk donte ta besonte. Po e dite mësimin, nuk mund të rrish pa e ngritur dorën, thoshte ai. Orën e katërt kishte mësim ai në të tetën «C». Kur doli nga klasa, ishte shumë i kënaqur dhe mezi mbahej.

— Ky është rast tepër i rrallë. Të tria problemat që i dhashë, i zgjidhi sa çel e mbyll sytë, — foli tepër i entuziazmuar për Rotin.

Nuk kaloi as një muaj dhe Roti po na habiste të gjithëve. E mbanim në gojë. Atij iu rrit shumë autoriteti dhe te shokët e shoqet e klasës. Tani ata e çmonin dhe e donin shumë. Në mëngjes herët mblidheshin nga tre e nga katër te dërrasa e zezë dhe Roti zgjidhte problemat e vështira.

Një ditë i ngrita Dilën dhe Rotin në orën e gjuhës. U dhashë të dyve nga një analizë të vësh-

tirë. Dila u mendua ca dhe me vështirësi mundi t'i ndante pjesët e t'i emërtonte ato, kurse Roti e bëri këtë punë me një shpejtësi dhe lehtësi të habitshme. Elvira shfaqti mendimin, se, nëse duhej të matej përgatitja e të dyve, analiza duhej të ishte e njëllajtë. Ajo ngulte këmbë se analiza e Dilës ishte më e vështirë. Të gjithë flisnin dhe në klasë u bë një rrëmujë e gëzuar, nga e cila ne, mësuesit, nuk mërzitemi kurrë.

— Nuk ka faj analiza, mësues, — tha Dila me sinqeritet. — Unë nuk matem dot me Rotin.

Roti e shikoi Dilën në sy. Ai rrinte si me turp në dërrasë. Meqë ishte orë ushtrimesh, i ula të dy në bankë dhe u dhashë nga një fjali të njëllajtë. Me nxënësit e tjerë fillova punën me një ushtrim në libër. Nuk mbaruam dot as fjalinë e parë, kur Roti tha se e përfundoi analizën. Ky m'u duk thjesht një nxitim nga ana e tij, pasi ajo nuk qe fjali që të analizohej aq lehtë.

— Bjere fletën, — i thashë.

Dila po punonte ende.

— Po e pati mirë Roti, Dila të mos vazhdojë fare, — tha Feriti, që kishte simpati të madhe për Rotin.

— Të presim edhe një minutë, — thashë.

Dila pas një minute e dorëzoi fletën. Ajo kishte një gabim të lehtë në emërtimin e një pjese të nënrenditur, kurse Roti ishte treguar shumë i saktë.

— Fiton Roti, — thashë me njëfarë keqardhjeje për Dilën.

Nxënësit duartrokitën.

Javën e ardhshme do të zhvillohej konkursi i fizikës ndërmjet dy shkollave tetëvjeçare të qytetit. Natyrisht, në krye të skuadrës sonë do të ishte Roti. Të gjithë, mësues dhe nxënës, ishim të bindur se konkursin do ta fitonim. Po më shu-

më se të gjithë ishte i bindur mësuesi i fizikës, Refiku.

— Kaq i sigurt je? — e pyeta një ditë.

— Sikur veç Roti të jetë, ne e fitojmë. Është shumë i shpejtë e i përpiktë edhe në veprimet praktike.

-- Konkursi nuk bëhet vetëm me një nxënës, — i thashë.

— Po si mendon ti, të mos e fut në skuadër?

— Në skuadër po, por s'duhet t'i varësh shpresat vetëm te Roti...

Dy ditë para se të fillonte konkursi Roti u sëmur. I shkova në shtëpi dhe e pashë. Kishte temperaturë të lartë. Me mua erdhi edhe Refiku. Na priti e ëma e Rotit, një grua truphollë dhe me fytyrë të zbehtë.

— Konkursin na e mori lumi, — i tha Refiku Rotit.

Unë e pashë me qortim, se më dukej që Refiku vetëm për atë gjë kishte ardhur. Po Roti i tha:

— Ka të tjerë, mësues. Është Dila, Elvira, Feriti, Shabani, ohu...

— Ç'është ky konkurs? — na pyeti e ëma e Rotit dhe, duke treguar me kokë të birin, shtoi:

— Veç aty i rri mendja.

Ne ia shpjeguam dhe ajo tundi kokën në mënyrë të papërcaktuar.

— Shërohu, — i thashë Rotit, — pa për konkursin mos u bëj merak fare. E the mirë ti: ka të tjerë.

— Kështu, kështu, — tha edhe Refiku si nëpër dhëmbë.

Erdhi dita e konkurimit me shkollën tjetër. Pjesëtarët e të dyja skuadrave zunë vendet, kur në sallë u shfaq edhe Roti. Ishte ende i zbehtë në fytyrë, veç mollëzat e faqeve i skuqin paksa.

— Roti, — i thirra sa e pashë. — Përse dole, ti je i sëmurë!

— Jam mirë, mësues, — tha shpejt e shpejt dhe kërkoi të zinte sa më parë vendin e vet në skuadër. Unë isha i shqetësuar, por Refiku, përkundrazi, i gëzuar. E ngriti Feritin nga vendi dhe në vend të tij uli Rotin.

— Tani konkursin do ta fitojmë patjetër, — tha.

E shikova me qortim, por ai nuk ma vari fare. Konkursi sapo kishte filluar, kur në derë u duk nëna e Rotit. Erdhi e shqetësuar dhe u ul pranë meje.

— Më iku nga shtëpia, — tha për Rotin.

— Mos u shqetëso, — i thashë. — Tani u bë kjo punë.

Asaj dalëngadalë filloi t'i largohej shqetësimi dhe u gëzohej përgjigjeve shumë të matura të të birit. Ai të habiste edhe me veprimet praktike. Vepronte shpejt dhe saktë.

Shkolla jonë e fitoi konkursin dhe një meritë të madhe për këtë pati edhe Roti, sado që edhe Dila e pjesëtarët e tjerë të skuadrës treguan përgatitje të lartë. Po më njoftuan se atë natë në mbrëmje Roti ishte shtruar në spital. Pas dy ditësh u mblodh këshilli pedagogjik dhe mua e Refikut na dhanë vërejtje.

— Mirë na e bënë, — i thashë Refikut kur dolëm nga mbledhja.

— Për mua e hëngre edhe ti, — tha ai sikur ishte fajtor para meje.

— Jo, jo, kisha pjesën time edhe unë, — thashë me sinqeritet. — Nxënësit e mirë t'i duam e t'i ndihmojmë, por të mos ngremë kulte nxënësish dhe të arrijmë deri këtu ku arritëm.

Pak a shumë këto i kisha thënë edhe në mbledhje, kur bëra autokritikë, por kisha një dëshirë

t'i përsëritja edhe vetëm për vetëm me Refikun.

— Ke të drejtë, ke të drejtë, — mërmëriste Refiku. — U bë tani.

Pas dy javësh, kur po rrija i vetëm në dhomë, duke dëgjuar polkat e Jozef Shtrausit në radio, më zuri veshi një të trokitur të lehtë.

— Hyr, — thashë pa e kthyer kokën. Ishte Roti. Dukej i gëzuar dhe veten e kishte marrë. Mollëzat e faqeve i skuqnin, ndonëse ky i tarishmi ishte një i kuq tjetër. E përqafova dhe e ula në krevatin tim.

— Na mori malli, Roti, — i thashë.

— Na mori malli, përsëriti edhe ai.

E doja shumë Rotin. E kisha dashur shumë përherë, por tani do të dija ta doja më mirë...

Ai vështroi me vëmendje librat në bibliotekën time. Mora një syresh dhe shkrova në të: «Kujtim Rotit».



## Nafija

Nafijen e kisha shoqe fëmijërie. Me të isha rritur, me të kisha luajtur, me të kisha kullotur bagëtinë në cekë. Por, si u bë pesëmbëdhjetë vjeçe, ajo iku nga fshati dhe shkoi në qytet, të një teze e saj, që të mësonte për rrobaqepëse. Në fshat vinte rrallë dhe nuk rrinte kurrë më shumë se dy-tri ditë. Kur takohesha në rrugë, ose në oborrin e shtëpisë, më hidhte ca shikime që nuk i kuptoja.

Ishte gusht kur u takova herën e fundit me të. Mora këmesën dhe rashë teposhtë për të prerë thupra në cekë.

— E, Xhemil, ku shkon? — më pyeti ajo.

— Për thupra, — i thashë.

Më shikoi në sy, më buzëqeshi dhe ajo buzëqeshje më turbulloi paksa. Kur takohesha me të, zemra më rrihte fort, sikur donte të më çante kraharorin. Nafija ishte rritur dhe kishte ndryshuar shumë. Flokët nuk i mbante më bish-taleca, si dikur, por i lëshonte supeve. Kjo gjë atëherë nuk ishte në modë dhe mua më bënte përshtypje. Flokët i kishte të zinj, të drejtë si fije te li. I mbërrinin gjer në bel.

Fryu një puhizë e lehtë dhe ajo me hijeshi i dha kokës prapa. Flokët iu derdhën mbi supe. Edhe ajo lëvizje e kokës më bëri përshtypje, se vajzat e fshatit nuk bënin ashtu. E ka marrë nga qyteti, mendova. Po Nafija nuk kishte marrë nga qyteti veç ca hire në lëvizje e në veshje. Kur lante rrobat (dhe ajo lante shpesh), nuk përdorte veç finjë dhe sapunsi nënat tona, por edhe një lloj pluhuri të futur në ca qeska të bardha. Kur i ndente rrobat për t'i tharë, i tendoste fort dhe ato dukeshin si të hekurosurat. Nga qyteti kishte sjellë një hekur që nxehet me zjarr. E vinte në një tryezë të madhe në bahçe dhe hekuroste orë me radhë.

Shkurt, Nafija bënte ca punë që unë nuk i shikoja te gratë dhe vajzat e tjera të fshatit dhe kjo gjë, si pa dashje, e rriste personalitetin e saj tek unë.

Këto po mendoja kur e zura veten duke i hedhur ca vështrime në gjoks. Gjoksi i kishte gufuar dhe bluza pak e ngushtë ia vinte në dukje më shumë. Rrinte pa çorape. Atëherë ishte e vetmja vajzë në fshat që rrinte pa çorape dhe mua nganjëherë, kur frynte era, më shkonin sytë te këmbët e saj të bardha e të bukura.

— Ti vjen shumë rrallë, — i thashë atë ditë.

— Pse, mos të mori malli ty? — më pyeti disi me djallëzi.

U ndodha disi i papërgatitur për këtë pyetje dhe nuk dita si t'i përgjigjesha. Ajo qeshi që arriti të më vinte në atë pozitë të vështirë, por unë, si të doja të hakmerresha, i thashë:

— Më mori, Nafije, bile shumë...

— Po të të kishte marrë malli, siç thua, do të vije ndonjë ditë nga shtëpia. Kam kaq ditë që po rri këtu dhe ti nuk je dukur fare.

Në zërin e saj kishte qortim.

— Sesi më vjen, Nafije, jo se nuk kam dashur.  
— Nuk ke dashur, ndryshe do të kishe ardhur.

— Takohemi nesër, do të vij që në mëngjes!

— Nesër unë iki, — tha si me keqardhje.

— Takohemi sonte atëherë.

— Natën?! Mos je çmendur? Sesi je ti, Xhemil. Një javë nuk u duke fare, kurse tani vjen e më thua që të takohemi natën.

— Nafije, të dua, — i thashë.

U çudita edhe unë se si i shqiptova ato fjalë. Ajo u zbeh në fytyrë dhe m'u duk sikur ndjeu të ftohtë.

— Ç'thua, Xhemil?! Ne jemi shokë, fëmijërie,

U turpërova shumë dhe nuk dija ç't'i thosha. Më erdhi njëherë t'i kërkoja të falur, por si nuk gjeta ç't'i thosha, ula kokën dhe u nisa për në cekë. Ajo mbeti aty, te kryqëzimi i rrugëve. Nuk e ktheva kokën për ta parë, por më dukej se shikimi i saj më ndiqte pas.

Fillova të prisja thupra, por nuk më punohej fare. Mendja më rrinte te Nafija dhe tek ato fjalë që më kishin dalë nga goja ashtu, si pa menduar. Më vinte të haja veten me dhëmbë që i thashë ashtu: të dua!

Dielli sapo perëndoi dhe në qiell doli hëna. Ishte një hënë e plotë, që e shikoja përmes degëve të rrapit të madh buzë lumit. Degët e rrapit ku kisha hipur, të vjetra dhe gjithë nyja, thureshin me njëra-tjetrën dhe shtriheshin paralel me lumin, me ujërat e tij. U ula në to dhe u shtriva si në ndonjë trinë që rrinte mbi ujë. Më kishte hipur një mërzi e madhe dhe nuk më bëhej të veja në shtëpi. Po bukuria e asaj nate sikur ma lehtësonte pak dhembjen.

— Ku-ku! Ku-ku! — dëgjova një zë pas pak.

Nuk këndonte qyqja, por ishte një njeri. Ishte

zëri i Nafijes. Ajo po më kërkonte, po më kërkonte si dikur. Atëherë luanim në shelgje. Fshiheshim nëpër to dhe kërkonim njëri-tjetrin. E kërkonim me atë «ku-ku»-në. Më në fund takoheshim, i hidheshim njëri-tjetrit në krahë, por nuk i afronim trupat, veç fytyrat. Shtrëngonim duart me një ngazëllim të madh, sikur të kishim qenë të humbur prej kohësh dhe atë çast vërtet të kishim gjetur njëri-tjetrin.

— Ku-ku! — Ku-ku! — dëgjova zërin e saj pas aq vjetësh.

— Ku-ku! Ku-ku! — u përgjigja edhe unë si dikur.

Ajo kaloi përmes livadhit dhe erdhi tek unë, e lehtë dhe e bardhë si një vegim.

— Ku je? — pyeti.

— Prit, po zbres, — i thashë.

— Mos zbrit, Xhemil, — foli me një zë të dridhur. — Po vij unë atje, më mirë jemi sipër valëve.

U kaçavar pas degëve të rrapit dhe erdhi tek unë. U ul në trinën e degëve, pranë meje. Ishim midis kaltërsive: të lumit dhe të qiellit.

— Sa bukur, sa bukur, — tha Nafija dhe, duke u përpjekur të zinte vend sa më mirë, e humbi drejtpeshimin e u mbështet tek unë që të mos binte. Ndjeva në qafë dorën e saj të njomë që më dukej sikur digjej. Më ra lehtë në gjoks dhe akoma edhe sot nuk e di nëse në këtë veprim pati diçka me dashje apo jo. Por, sidoqoftë, unë qëndrova si i ngrirë.

— Nga vjen kjo erë kaq e mirë, — pyeti Nafija pas pak.

— Është era e hideve, — i thashë.

— Nuk është era e hideve, por e mollëve të pjekura.

— Po, — thashë edhe unë.

— Harruam erën e barit të kositur.

Prapa nesh, mu buzë lumit, ishte një mullar me bar të kositur.

— Sa e mrekullueshme është kjo era e barit të kositur, — tha Nafija.

Kur po shkonim nëpër rrugën që të shpinte në fshat, ajo u ndal paksa dhe, nën dritën e hënës, më shikoi në kokë.

— E ke bërë këtë kokë si dardhë, — më tha dhe qeshi.

— Ç'të hipi tani me kokën time? — i thashë.

— Je qethur keq, Xhemil, — më tha si me keqardhje. — Qethu më mirë, se flokët i ke shumë të bukur. Ja, për këtë të thashë.

— Shyqyr që je ti e bukur, — i thashë si me dy kuptime.

— Eh, Xhemil, Xhemil, — më tha duke më rënë lehtë supeve. — Mua nuk më duket vetja e bukur dhe, po që puna për bukuri, ti ma merr njëqind herë.

Nuk kisha si ta besoja këtë që po më thoshte Nafija. U ndamë para shtëpisë së saj, pak qejfprishur e pak të përmalluar, me ca shtrëngime duarsh dhe me ca premtime për t'u takuar prapë.

Nafija erdhi në fshat pas tre muajsh. Me mua u tregua e përmbajtur, më e përmbajtur se kurrë, por jo e ftohtë. U takuam në kopshtin e saj. E ëma e Nafijes atë ditë vilte ftonjtë dhe ne, tre-katër djem të mëhallës, i ndihmonim në këtë punë. Me ta isha edhe unë. Nafija vetëm më dha dorën, më pyeti për shëndetin. Nuk di përse, por unë prisja që ajo të sillej më ngrohtë me mua. Se si duhej të sillej, as unë nuk e dija. Po kishte diçka që nuk shkonte. Shkurt, prisja që ajo të ishte shumë më e afërt. Po nganjëherë më hidhte ca shikime si vjedhurazi dhe sikur donte të më

thoshte: Xhemil, ty nuk të kam si të gjithë të tjerët!

Na takoi që unë dhe Nafija ta kapnim të dy bashkë koshin e madh me ftonj për ta futur në mashën. Ajo, kur po ngrinim koshin, si pa dashje kapi dorën time. Ndjeva sikur dikush më hodhi ujë të nxehtë në dorë. Eshikova në sy, por sytë i mbante përdhe, nuk donte ta takonte shikimin tim. Desha të rrija edhe një çast vetëm me të dhe iu luta të shkonim te çezma për të pirë ujë. Çezma ishte nja dyzet metra larg dhe ne do të kishim mundësi të rrinim pak të veçuar nga të tjerët.

— Të jap unë ujë ty, — dhe, si mbushi grushtin, ma hodhi syve.

Unë nuk kisha ç'të bëja, rrija si guak. Kur mbusha grushtin me ujë që t'ia hidhja, ajo kishte ikur.

— M'u kujtua ajo ditë shtatori, kur vajta në qytet me babanë. Ishte ditë pazari, vapë dhe zaguhi e madhe. Babai më kishte dhënë lekë për të blerë një akullore, por kishte aq shumë njerëz, sa më duhej të prisja shumë kohë për ta marrë. Por etja po më shtrëngonte dhe unë vendosa të blija ujë me akull. Ai që shiste ujë me akull, ishte një burrë qafëtrashë, me një përparëse të bardhë aq të ndotur, sa nuk të vinte ta shikoje me sy. Privati i dreqit, thashë me vete, megjithatë ndenja në radhë.

— Xhemil! Ç'bën këtu?

Po më thërriste Nafija. Më buzëqeshi me ëmbëlsi dhe m'u duk shumë e afërt.

— M'u tha fyti për pak ujë, — i thashë.

Dil nga radha, se të jep Fija akullore ty, — tha ajo duke më rënë lehtë supeve.

— Ka shumë njerëz atje, — i thashë.

— Akulloret i shet burri i tezes. Do të na japë menjëherë, — tha ajo.

Më kapi nga dora dhe ne nxituam përmes njerëzve për të mbërritur atje ku shite-shin akulloret. Nafija më qerasi. Sa i tha shitësit, ai i dha dy akulloret dhe ne shkruam e u ulëm te rrapi i madh që ishte në mes të pazarit.

...Tani ajo më dukej më e pjekur dhe më serioze. Kisha dëshirë të rrinim pak vetëm dhe t'ja kujtoja ato dy orë të lumtura që kisha kaluar atëherë në qytet me të. Budallallëqe, sikur thosh-te pamja e Nafijes. Po, kur futëm koshin në mashën, disa minuta më vonë ajo më shikoi drejt në sy dhe më tha:

— Ty të kam më shok se të gjithë, Xhemil!

Desha t'i kapja dorën. atë dorë që më preku si rastësisht pak kohë më parë, por ajo, me një zë pothuaj të egër, më tha:

— Mos më prek!

Ishte e çuditshme ajo Nafija! Nuk kishte njeri ta ndryshonte gjendjen shpirtërore më shpejt se ajo. Tani ishte e qeshur dhe bënte shaka, pas një minute, ose edhe pas disa sekondash, mund të bëhej e zyrtë. dhe s'pranonte t'i flisje asnjë fjalë. Kështu edhe tani.

Një cast më vonë ajo qeshi ëmbël dhe më tha:

— Takohemi nesër. Do të shkoj në pyll për t'i ndihmuar babait. Do të vish?

— Patjetër, — i thashë.

Të nesërmen u ngrita herët, por veç kur ra dielli u nisëm. Rruga shkonte sipër fshatit, në një rrafshinë. Dy ditë më parë kishte rënë shi dhe në rrugë tani nuk kishte as pluhur, as baltë. Është kënaqësi të ecësh në vjeshtë në një rrugë të tillë, sidomos në një rrugë, në të dyja anët e së cilës ka plepa të bardhë, që duken si të veshur me një basmë laramane, sepse disa gjethe

janë zverdhur e bëhen gati të bien, kurse disa janë ende të gjelbra. Disa nga gjethet e verdha binin me qetësi e dhembje, dhe mua më dukej sikur nga ato pikonte mërzia. Poshtë rridhte lumi dhe matanë tij ishte një kodër me dushk. Dushku ishte zverdhur. Në të dyja anët e lumit kishte vërrinj të lartë dhe ca plepa degëgjere me trungjet tërë gunga. Nën ndikimin e rrezeve të diellit gjelbërimi i vërrinjve i jepte lumit ca reflekse të çuditshme.

Unë e Nafija ishim ulur në një stom, sipër lumit, duke vështruar peizazhin që kishim përpara. Peizazhet e vjeshtës janë të shpejtndryshueshme prandaj të bëjnë t'i vështrosh me ëndje të madhe, ngaqë e di se pas disa ditësh në vend të asaj së purpurës së ndezur të gjetheve të dushkut do të gjesh të murrmen e ftohtë e të hirtë, plepat anës rrugës do të jenë të mjerë në lakuriqësinë e tyre, kurse lumi nuk do të ketë aq reflekse ngjyrash veç asaj së bardhës si në të kaltër, që vjen duke u irnosur ngadalë.

— Sa bukur — tha Nafija.

— Të pëlqen vjeshta? — e pyeta.

— Po, — tha ajo. Po vjeshta të ikën shpejt nga duart. ..

Në mendjen time vjeshta sikur u sendëzua dhe ajo m'u kthye në diçka të vyer e të dashur, që mund të mbahej në dorë, por për pak kohë.

— Ja si janë irnosur plepat, — tha Nafija si me dhembje.

Ajo po tregonte me dorë ca plepa rrëzë pyllit të dushkut. Atyre u kishin rënë gjethet e vërtet dukeshin si të mjerë. Mjerimi i plepave sikur zuri vend edhe në fytyrën e Nafijes. Po kjo vetëm për një çast.

Që aty ku ishim, dukeshin parcelat e koopeativës.



— Do të bëhen edhe parcela të tjera. — tha Nafija.

— Ku e di ti?

— Derisa u bënë këto, do të bëhen edhe të tjera. Traktori nuk do ngastra të vogla, por hapësirë, fushë, — tha ajo.

Doja të tregohesha se edhe unë dija. Kisha dëgjuar për një «zonë industriale» të kooperativës, por, ngaqë nuk dija se ç'ishte ajo, ngurroja të bëja fjalë për të. Tutje, nja dyqind hapa larg qendrës së kooperativës, bëheshin ca objekte të reja, por as për ato nuk kisha pyetur se ç'do të ishin.

— Ja, atje do të punoj unë kur të mbaroj kursin, — tha Nafija duke treguar me dorë ndërtesat e reja poshtë zyrave të kryesisë. — Atje do të ngrihen ndërtesat e artizanatit: rrobaqepësia, rrojtoria, këpucaria e të tjera.

— Do të bëhet edhe zona industriale, — ia futa unë kot, veç që të mos mbeteshia prapa.

— Ajo ka kohë, — tha Nafija. — Ne jemi kooperativë e re, po për t'u ngritur do të ngrihet...

Po bisedonim kështu, kur Nafija tha:

— Babai!

Ajo foli në atë mënyrë sikur babai i saj të ishte aty, në rrugë. Po ne nuk e shikonim fare atë, veç dëgjonim goditjen e sëpatës së tij thellë në pyll. Pas pak hymë në pyll. Pylli ishte krejt prej frashëri. Ishin ca lisa të vegjël, të drejtë me ca degë të holla si thupra shelgu. Lëvorja e tyre, ndryshe nga ajo e dushkut, ishte laramane si vezët e laraskave. Ecnim duke u kapur pas drurëve, dhe ata, ngaqë ishin të vegjël, heposheshin duke tundur kurorat e ndritshme. Përtej pyllit të frashrit kishte pyje të tjera, të cilat nuk i njihnim se ç'ishin. Veç brezi i lartë i plepave, që du-

kej tepër larg, binte menjëherë në sy me atë gjelbërimin e ndezur.

Goditja e sëpatës së babait të Nafijes tani ndihej më afër. Tutje, mu në rrëzë të pishave, ishte një burim me ujë të kulluar. Megjithëse larg, ne vendosëm të shkonim. Ujërat e burimit, si me mërmërimë, rridhnin përmes gjetheve. Ajo u ul në një trung të rrëzuar pishe mu pranë burimit.

— Xhemil, sesi je ti, Xhemil. — tha Nafija befas.

— Si jam? — e pyeta.

— Je i mirë, Xhemil. Unë të çmoj.

— Edhe ti je e mirë, Nafije, veç na ike në qytet. Mua më merr malli për ty.

Ajo puliti qerpikët e bukur.

— Vërtet të merr malli? — më pyeti.

— Më merr, nuk e beson?!

— E besoj, Xhemil. Mua më merr malli për fshatin, pemët, rrugët pyllin, shtëpinë por edhe për ty.

Desha t'i afrohesha, por ajo më ndaloi me një lëvizje kërcënuese të vetullave. Rri aty, se do të prishemi bashkë, sikur më thoshte ajo lëvizje e zemëruar. Dhe unë ndjenja i urtë dhe i bindur, i durueshëm, me dashuri e mall përzier bashkë.

— Kur të vijë pranvera, do të kem mbaruar kursin e do të vij përgjithmonë në fshat, — tha Nafija pas pak dhe sytë i qeshën. — Atëherë do të shikohemi cdo ditë dhe nuk do të na marrë kaq shumë malli.

## Zënkë burrash

Dan Kërriqi u tha njerëzve të shtëpisë se po shkonte të merrte kalin, që e kishte penguar në cekë. Binte një shi i hollë, ndërsa mbrëmja kishte rënë me kohë. Nata ishte aq e errët sa edhe gishtin po të të futnin në sy, nuk e shikoje. Rruga ishte mbushur me pellgje dhe Dani nuk shikonte fare se ku shkelte. Tjetër gjë kishte në mendje ai dhe, kur nuk e ke mendjen, syri nuk shikon ditën, pale më natën.

Tri ditë më parë në revistën «Hosteni» ishte botuar një fejtון me titull «Matrapazi i Sheshazit». Fejtoni ishte për Dan Kërriqin. Ai ishte vënë në një vend të dukshëm të revistës dhe fillonte me emrin e Danit. Në të thuhej se Dan Kërriqi e kishte të thellë ndjenjën e pronës private dhe të fitimit në kurriz të shoqërisë. Oborrin personal e kishte mbjellë krejt qepë. Bëri njëzet kuintalë dhe, pasi i dha rryshfet një shoferi të pandërgjegjshëm, i shiti në qytetin K. Fejtoni ishte firmosur me pseudonimin «Saçma». «Jo saçma, por plumba paska ky fejtון» tha dikush.

Dani ishte lart, në kryesi, kur të tjerët e lexonin fejtونin përjashta. Posta sapo kishte ardhur nga qyteti dhe njerëzit i mbanin revistat

«Hosteni» në duar. Dani e kuptoi se po luhej me emrin e tij dhe një fytyrë i vinte një i shkonte. Shikonte që nga dritarja Dane Lucën që jepte e merrte me gomarin e vet, të tjerët që gajaseshin dhe i vinte të pëlciste nga zemërimi. Jam apo nuk jam brigadier, tha me vete, dhe vendosi të dilte burrërisht në shesh, te njerëzit. Zbriti me nxitim shkallët dhe doli. Dane Luca prapë jepte dhe merrte me gomarin. Diç i thoshte, si të ishte njeri kafsha e gjorë. Dani e kuptoi se edhe kjo puna e gomarit kishte lidhje me fejtounin që ishte shkruar për të. Vrapoi në PT. Aty ishte Pjeshka, gruaja e bukur e Dane Lucës. Togu i revistave dhe i gazetave ishte hapur në zyrën e shpërndarjes së shtypit. Atij i shkuan sytë te revista «Hosteni». Iu lut Pjeshkës t'ia jepte për pak minuta, sa t'i hidhte një sy. Ajo ia dha. Dani i përpiu faqet e saj me një vështrim të shpejtë dhe të mprehtë. E gjeti atë që kërkonte. Dan Kërriqi që në titull e mori goditjen e parë. Sytë iu errën dhe gjunjët iu prenë. U tërhoq disi mënjane, në korridor, dhe filloi ta lexonte.

Mezi po qëndronte më këmbë dhe, që të mos binte, u mbështet pas murit. Sytë sikur po i vraponin nëpër ferra, se kështu i dukeshin shkronjat e fejtounit. Pati ndijimin se të gjitha ato shkronja po i shndërroheshin në kokrriza të imta rëre dhe një erë e fortë, që nuk dihej nga fryntë, ia fuste pa mëshirë në sy. Në sy po ndiente dhembjen e vërtetë që të shkaktojnë trupat e huaj. Kur arriti në fund, fuqitë i kishin shteruar fare. «Saçma! T'ëmën e s'ëmës», shau me vete. Iu duk sikur në trup iu ngul një saçmë që ia përzhiti mishin fare. Të kam hasm për jetë të jetëve, o Luk Quku, tha me vete me mllëf të madh. Kjo është pushka jote, plumbi yt, që po më bie brinjë më brinjë. Dan Kërriqi e dinte se pas

atij pseudonimi fshihej emri i Luk Qukut, emri i atij djalit të ri që vazhdonte shkollën e mesme bujqësore dhe punonte karrocier. Ç'bëra unë, o Luk Quku, monologoi Dan Kërriqi. Mallin tim shita, nuk vodha! Pse qenkam matrapaz unë? Apo pse nuk je i zoti ti dhe zabërhanët e tjerë si ti që nuk dini të fitoni?! Po pëlçit, ore, një sahat e më parë pëlçit!

Danit i shkoi mendja te katër mijë lekët që kishte fituar nga shitja e qepëve. Ky qe njëfarë ngushëllimi, por i vogël dhe i mjerë. Lekët ishin aty, në valixhe, të tëra qindëshe dhe krejt të reja, por emri i tij ishte në revistë dhe në gojë të njerëzve. Sytë iu mbushën me lot dhe bëri shumë përpjekje që të mos qante. Edhe kjo më duhet, mendoi dhe i ra vetes me grusht që të mbante lotët. Baaam! kërciti gjoksi i tij i tharë dhe i rreshkur. Vuri re që edhe Pjeshka po e lexonte fejtounin. Shihe kur t'i kthejë sytë nga unë, mendoi Dani. Por ajo nuk i hodhi asnjë shikim dhe Dani ndjeu njëfarë mirënjohjeje për të. Dan Kërriqi la revistën dhe doli jashtë. Dane Luca prapë nuk po i ndahej gomarit. Ia tundte kafshës një revistë «Hosteni» mu përpara turirit, sikur ajo të ishte një tufë jonxhë e butë.

— Ore, do ta lësh atë gomar rehat, apo si'e ke hallin? — i tha me inat Dani.

— Po si ta lë rehat, more Dan, — tha Dane Luca si pa të keq, — më kanë gjobitur shtatë herë për dëmet dhe marrëzitë e tij. Për të gjitha këto, unë e kam shqepur në dru, por tani e shikoj se e paskam pasur gabim, se paska bataçinj më të mëdhenj se ky... Për njërin prej tyre shkruaka dhe «Hosteni» dhe unë i them gomarit që ta lexojë.

— Më pëshurrsh në kësulë, po ta harrova, — i tha Dan Kërriqi.

Dan Kërriqi nuk kishte kësulë, por kasketë. E hoqi kasketën dhe e mbajti në dorë si gavatë. Por inatin më të madh ai e kishte me Luk Qukun. Ai e kishte ndezur zjarrin dhe të tjerët po i frynin.

Tani ai ecte si i ndërkyer, me një mendim të keq në kokë. Doli në fushë të hapur. Fusha ishte e lagur dhe nxinte. Ai nuk ruhej nga pellgjet e ujit, u binte përmes. Si kaloi fushën, u fut në një rrugë të ngushtë ndanë arrave. Këtu toka nuk ishte dhe aq e qullur dhe ai u mbështet pas trungut të një arre. Rrinte në përgjim si ndonjë hajdut, dhe kishte frikë se mos e shikonte njeri. Në rrugë u dëgjuan zëra dhe ai u bë njësh me trungun që të mos e shikonin. Po njerëzit kaluan dhe nuk e panë. Prapë dëgjoi zhurmë, po tani e dinte se ishte Luk Quku me karro. Futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe preku thikën. Do të më njohësh, o Luk Quku, tha me vete, do të më njohësh... Ore, nuk ta përton njeriu sot! Hiç fare! Të bie me shuplakë në fytyrë dhe të thotë: shëndet! Po njeriu dy duar për një kokë i ka. Pastaj mendoi për një çast se mund të mos kishte të drejtë. Ai në të vërtetë nuk ishte i sigurt se pas atij pseudonimi fshihej Luk Quku. Dani veç dyshonte dhe dyshimi herë-herë i rritej dhe i kthehej në siguri... Nuk është burrë, tha ai për Luk Qukun. Po të ishte burrë, vinte emrin e tij poshtë... Po njësoj është... Ai prapë preku thikën. Befas u kujtua se ai nuk kishte dalë për gjë tjetër, veç për ta trembur Lukun. Një njeri si Dan Kërriqi nuk mund të bënte më shumë, por, atë që mendonte, nuk mund të rrinte pa e bërë.

Kërkëllima e karros u dëgjua fare afër. Dani dalloi sytë e mëdhenj dhe gjithë dritë të kuajve, që në terrin e natës dukeshin si katër llambushka të vogla.

— Ej, Luk, ndale karron, — tha ai.

Luku ngadalësoi shpejtësinë duke u përpjekur të shikonte se cili ishte ai që i thërriste.

— Kush je? — pyeti Luku.

— Jam Dan Kërriqi, ndale karron!

Luku u tërhoqi frerët kuajve dhe ata ndaluan. Ai hapi derën e kabinës dhe nxori kokën.

— Ç'do, or Dan? — pyeti.

— Kam një fjalë me ty, — tha Dani.

— Hip, se bisedojmë rrugës, — tha Luku.

— E kam një fjalë këtu, në shi, — tha Dani me inat.

— Ç'është kjo fjalë në shi?! — pyeti i habitur Luku.

— Ja, se dua unë, — tha Dani me zemërim të madh. Ai e kapi Lukun nga jaka e xhakëtës dhe e tërhoqi poshtë, në tokë. Luku ose nuk deshë të mbahej, ose nuk mundi. Ishin kaq pranë njëritjetrit, dhe me pamje dhe gjendje shpirtërore krejt të ndryshme. Luku i habitur, kurse Dani kërcënues dhe zemërak. Dani njërin dorë, të djathtë, e mbante në xhepin e pantallonave, kurse me të majtën kishte mbërthyer fort pas jakës së xhakëtës Lukun dhe nuk e lëshonte. Koka i vinte deri te supi i Lukut, kurse shpatullat e tij të dobëta dukeshin si shpatulla fëmije në krahasim me ato të Lukut.

— Do të llafosemi për atë «Matrapazin e She-shazit», — tha Dani.

Luku e ndjeu erën e sherrit, por vazhdonte të rrinte i habitur, pa ditur ç'të bënte. Atij nganjëherë i vinte të mendonte se Dan Kërriqi nuk ishte aq budalla sa të donte sherr me të, se me Lukun ishin të paktë ata burra që mund të mateshin për forcë. Atij i dukej çudi që ai, Dan Kërriqi, pesë para burrë, me një trup të rrëgjuar, me krahe të hollë si krahe fëmije, t'i dilte në rrugë dhe ta kërcënonte.

— Më parë hiqe dorën, pastaj llafosemi sa të duash, — i tha Luku.

— Do të llafosemi kështu, — i tha Dani duke ia shtrënguar më shumë jakën e xhaketës.

Luku vazhdonte të tregojë i qetë dhe i durueshëm. Ai po e trajtonte Danin siç trajtojmë një fëmijë sherret, që na bie më qafë, por nuk duam ta rrahim. Dani e kuptoi këtë dhe u tërbua nga inati... Ai kishte dalë për shamatë, kurse tjetri e merrte për fëmijë...

— Ti e ke shkruar fejtounin? — pyeti Dani dhe nxori thikën nga xhepi i pantallonave. E nxori ngadalë, që të bënte përshtypje. Teju i thikës shkëlqeu në errësirë. Ishte një shkëlqim metalik, në ngjyrën e ujit të kënetës aty pranë.

— Unë, — u përgjigj Luku i qetë.

— Ti, ë? — pyeti prapë Dani.

— Të thashë njëherë, — foli Luku krejt i qetë.

Dani e ngriti lart thikën me një gjest kërcënim. Ndonëse pa sigurinë për të goditur. Luku e ndjeu këtë pasiguri, megjithëse tani puna iu duk serioze dhe u mobilizua.

— Lëshoje thikën, — i tha ai Danit. — Mjaft të durova!

Po, për çudi, edhe kësaj radhe zëri i tij qe i qetë, i butë, por veprimet jo edhe aq të këndshme për Danin. Luku ia kapi parakrahun dhe ia shtrëngoi fort, me shumë forcë, sa Dani ndjeu një dhembje të madhe. Gishtërinjtë e duarve filluan t'i liroheshin dhe ai e kuptoi se nga çasti në çast thika do t'i binte në tokë, ose në duart e kundërshtarit.

— Lëshoje thikën, — i tha prapë.

Dani e kuptoi se çdo përpjekje për të qëndruar ishte krejt e kotë, megjithatë tha:

— Nuk e lëshoj, do të të pres gurmazin ty, pastaj...



Luku qeshi pak dhe vendosi të vepronte më me energji se më parë.

— Po hë, të shohim si do të ma presësh gurmazin...

Ja shtrëngoi edhe më fort parakrahun dhe Danit i ra thika në tokë. Luku e lëshoi Danin, por nuk u ul të merrte thikën. Atë që nuk e bëri Luku, deshi ta bënte Dani, por, kur ky u përkul të merrte thikën, Luku i vuri asaj këmbën. Dani, ngaqë nuk mund ta lëvizte këmbën e tij, sikur përkëdhelej pas saj.

— Ore, luaj këmbën, — i tha ai Lukut.

— Luaje vetë, po deshe...

— Ore, po thika është imja...

— Kam frikë se mos më pret gurmazin, — tha Luku dhe qeshi.

Ai ia lëshoi dorën Danit diku mes shpatullave, e rroku mirë pas peliçes dhe e ngriti peshë si të ishte një bashkë leshi. Dani e pa veten si në krahun e një vinçi... Luku, me Danin të ngritur peshë, eci pesë hapa buzë kënetës...

— Ku më çon, Luk? — e pyeti me frikë Dani.

— Ta tregoj unë tani, — tha Luku duke e mbartur si një thes me lecka, vetëm me një dorë.

Aty, ku ishte ndalur, buzë kënetës, ishte një stom pak i lartë, mbuluar me myshk të rritur. Danit iu mbush mendja se që nga ai stom Luku do ta hidhte në kënetë. Aty uji ishte më i thellë dhe nëpër të kishte kallamishte.

— Aman, Luk, — u lut me ngashërim ai, — mos më hidh se do të mbytem!

— Nuk mbytesh, jo, se kapesh pas kallamave dhe del prapë në breg.

— Po më hodhe aty, vate Dani, o Luk... Marr një të ftohur e zë shtratin dhe nuk ngrihem më... Mendo për fëmijët e mi, Luk...

— Mos u ligështo, se je trim ti, — i tha Luku dhe, si e ngriti peshë deri në lartësinë e supeve të veta, e kapi me të dyja duart dhe thirri: hopa-hopa, dy-tri herë. Ai e lëkundte Danin si në shilarës, që të mund ta hidhte sa më larg. Dani lëvizte këmbë e duar dhe përpiquej të shpëtonte, por, kur e kuptoi se kjo gjë ishte e pamundur, tha:

— Aman, Luk... Vate puna ime, po më hodhe...

Luku e uli ngadalë në stomin e lartë dhe Dani mori frymë i lehtësuar.

— Mirë, nuk po të hedh, meqë nuk dashke, — u tall ai.

Kur pa se qeshi, Danit iu ngroh zemra dhe iu mbush mendja se kishte shpëtuar.

— Si ndihesh tani? — e pyeti Luku.

— Mirë, gjynah të qahem...

Luku i hodhi një vështrim mëshirues Danit. I erdhi keq me të vërtetë. Dani ishte lagur dhe ashtu, pa e hedhur në kënetë, ai do të ftohej... Ndenjën për disa çaste në heshtje përballë njëri-tjetrit.

— Shkojmë, — i tha Luku. — Kështu si je bërë, do të ftohesh.

— Shkojmë, — tha edhe Dani.

Dani u çapit dy-tre hapa si pulë e lagur dhe doli në udhë. Luku tashmë kishte hipur në karrrocë.

— Hajde, Dan, hip, — i tha atij. Rrugën e kemi bashkë. Këtu në kabinë është ngrohtë. Merrre dhe thikën...

Dani shkoi dhe e gjeti thikën aty ku kishte rënë. E vështroi një çast dhe e hodhi në ujërat e kënetës. Shkoi te Luku me atë pamjen e një nxënësi që pret qortime nga mësuesi.

— Përse e hodhe? — e pyeti Luku.

— Bëra turp, Luk, më fal, — tha ai me një

pamje fajtori. — Po ngrehaluc njeri jam unë, — vazhdoi pak çaste më vonë. — Nuk bëhem ndryshe... Po më beso, nuk kisha ndër mend të të vrisja, desha veç të të trembja. Po a trembet ariu nga kunadhja...

— Hip në kabinë, Dan.

Ata zunë vend në kabinë pranë njëri-tjetrit, të thoshe se midis tyre nuk kishte ndodhur asgjë. Dani ndiente nën vete ndenjësën e butë prej sfungjeri. Nën dritën e një llambushke të vogël, që ishte në një qoshe të kabinës, vështroi pamjet e ndryshme që kishte vënë Luku nëpër kabinë, perdet e bukura në të dy xhamat dhe e ndjeu veten shumë mirë aty. Luku lëvizti butonin e transistorit dhe në kabinë u dëgjua kënga për Çelo Mezanin.

— Na kënaqe, Luk, — tha Dani tërë mirënjohje. — A ke cigare?

Luku e vështroi në sy. Në kabinë ishte ngroh-të dhe Dani nuk dridhej më as nga frika, as nga të ftohët, Sidoqoftë, ai ishte ca i lagur. Luku kërkoi diçka në një shportë në njërin nga sirtarët e kabinës dhe i zgjati Danit një shishe. Ishte me raki.

— Mirë se erdhe, Dan, — i tha sikur ta kishte mik shtëpie. — Pije, se të bën mirë. Të ngroh stomakun...

— Bre,bre, — tha Dani disi i mallëngjyer, — si më doli kjo punë.

E tundi shishen me një gjest profesionisti dhe në të u formuan rruaza të bardha. E ngriti dhe piu pesë-gjashë gllënjka pa e hequr nga buzët.

— Qenka raki për kokë të rakisë, Luk! — tha ai tërë qejf. — Gëzuar, Luk! — tha duke e ngritur prapë.

— Gëzime paç, Dan! Të bëftë mirë ! Dhe herë tjetër mos u dël njerëzve me thikë natën.

— Turp, turp, — tha Dani sikur fliste me vete. — Ç'ma kujton?

Luku nxori nga xhepi paketën DS dhe i dha një cigare. Si mori edhe një për vete, nxori shkrepësen dhe, pasi ia ndezi Danit, ndezi edhe të tijën.

— Yyyy, — u bërtiti ai kuajve dhe ata vrapuan nëpër udhën që shkonte ndanë arave... U ndje ajo troshitja e lehtë dhe e ëmbël e karros kur ecën në një tokë të butë, por jo me baltë... Veç kur shkuan te stallat, ai ktheu kokën nga Dani. E kishte zënë gjumi... cigarja i kishte rrëshqitur nga buzët dhe i kishte rënë në dyshe-menë e kabinës, te këmbët e Lukut. Kur flinte, kishte një pamje paqësore që s'ta kujtonte fare atë të Danit me thikë në dorë.

— Zgjohu, se mbërritëm, — i thirri Luku.

## Biri i dashur i fshatit

Po vinte vjeshta. Vera ikte si me brengë, që dukej në trishtimin e rrugës me plepa, mbushur me gjethe të verdha. Tek-tuk nëpër plepa kishte mbetur ndonjë gjethe, por edhe ato e kishin humbur gjallërinë dhe ishin gati në të rënë. Era tunde degët e zhveshura të plepave dhe mbase ishte pikërisht kjo që ta kujtonte më shumë këtë brengë.

Agim Limani po ecte përmes fushës, pikërisht në rrugën me plepa. «Sa kohë u bë që nuk eci kësaj rruge? Që kur u bëra zëvendësministër», mendoi ai. Kishte lindur në Buzëdrinas, në fshatin e vogël buzë lumit. Tani po ecte në rrugët e tij, me mallin e fëmijërisë në zemër. Aty ishte rritur, aty kishte mësuar në shkollën fillore e pastaj në tetëvjeçare. Katër vjet të tjerë mësoi në shkollën mjekësore në Tiranë dhe, më në fund, mbaroi Fakultetin e Mjekësisë. Dhjetë vjet më parë, me diplomën e mjekut, ishte kthyer në Buzëdrinas. Megjithëse kishte qenë student i shkëlqyer, atij as që i kishte shkuar ndonjëherë në mendje që mund ta mbanin në Tiranë. Po nuk e emëruan as në qendrën e rrethit. Filloi punën

në Buzëdrinas, midis bashkëfshatarëve të tij. Punonte shumë dhe ndihej i lumtur. E thërritnin në çdo kohë dhe ai tregohej kurdoherë i papërtuar. Katër vjet më pas u specializua për kirurgji dhe e mbajtën në Tiranë. Buzëdrinasve u erdhi edhe mirë edhe keq. Ishin mësuar me të dhe çdo familje e quante si pjesëtar të vetin. «Nuk ta lënë të mirin», tha me vete atë ditë kur e mori vesh plaku Brahe Muça. Dikush i tha Brahes se edhe në Tiranë kishte nevojë për mjekë dhe aty duheshin më të zotët, më të mirët. Bashkëbiseduesi shtoi se buzëdrinasit duhej të ishin krenarë që një bir i fshatit të tyre ishte emëruar kirurg në Tiranë. Po këto i dinte edhe Brahe Muça. Edhe ai krenohej, madje më shumë se gjithkush, ndonëse zemra ia donte që Agimin ta kishte në fshat.

Një vit më vonë, një mëngjes, u përhap lajmi se Agim Limanin e kishin emëruar zëvendësministër. Dikush e besoi, dikush jo... Brahe Muça që ndër të parët që e besoi. Plakut gjithnjë i dhembnin kyçet dhe me veshkat nuk ishte mirë. Ishte vizituar te mjeku i fshatit, kishte vajtur edhe te mjekët e tjerë në qytet. Edhe u kishte besuar, edhe nuk u kishte besuar fjalëve të tyre. Atij i rrinte mendja vazhdimisht tek Agim Limani. Veç tek ai kishte besim të plotë, por ç'e do, tani ai ishte bërë zëvendësministër dhe në fshat do të vinte fort rrallë.

Por Agim Limani erdhi në fshat katër muaj pasi ishte bërë zëvendësministër. Ishte mbrëmje dhe ai krejt i vetëm kishte dalë në meja për të parë fushën e gjelbëruar, të mbjellë gjysmën me lakër dhe gjysmën me jonxhë. Nuk ngopej së vështruar gjithçka, fushën, lumin. Lumi i fëmijërisë, duke e parë të rrëshqiste si shirit i madh i verdhë, përtej kodrave, i bëhej se kishte ma-

rrë së bashku me ujërat e tij dhe vitet e fëmijërisë dhe të rinisë.

U ul te Shkëmbi i Dhive dhe që andej vështronte pejzazhin që kishte përpara. Si ndenji një copë herë aty, u ngrit dhe bëri nga e majta, në një rrugë të ngushtë këmbësore, për të shkuar te «sofati i pleqve», siç i thoshin një lëndine të vogël e të gjelbëruar, ku, në mbrëmje, aty në të përnduar të diellit, uleshin pleqtë e fshatit dhe kuvendonin. Kuvendonin derisa Kashta e Kumtrit dilte në qiell dhe hëna spërkaste gjethet e vërriut me një përshkënditje fantastike. Po pleqtë nuk ishin aty dhe atij iu duk sofati disi i shkretë. Pasaaj u kujtua se tanimë nuk ishte aq ngrohtë për pleqtë dhe se sofati do të rrinte i braktisur deri në verë. Ecte me këmishë zbërthyer dhe me xhaketën hedhur krahëve. Frynte era e vakët e breglumit dhe ai pati një dëshirë që atë ta fuste të tërën në mushkëri.

Bari ishte rritur një pëllëmbë dhe Agimi për pak sa s'i hoqi këpucët që të ecte zbathur, të prekte barin me tërë shputat e këmbëve, siç bënte dikur në fëmijëri. «Kjo nuk është thjesht nostalgji», tha ai me vete. Ra poshtë, në Mashtërneke, ku ishin më shumë se dhjetë hektarë lë mbjellë me bostan. Bostanet ishin pjekur dhe, nën dritën e hënës, që nga larg, dukeshin si kokrra të stërmëdha hurmash të bëra. Tutje, nga e djathta, ishte një livadh i madh, plot me bar kali, midis të cilit ngriheshin trumba shavari, që ishte rritur gati një bojë njeriu.

Vetëm të nesërmen u hap lajmi se në fshat kishte ardhur Agim Limani. Brahe Muça, me ta marrë vesh, bëri një banjë, veshi ndërresat e reja dhe rrobat më të mira që kishte. E shoqja u habit dhe deshi ta pyeste se për ku po gatitej ash-

tu. Po Brahe Muça e thoshte vetë gëzimin që kishte...

Atë mëngjes nëpër rrugët e Buzëdrinasit pati shumë lëvizje dhe gjallëri. Pleqtë po niseshin për në spitalin e fshatit që t'i vizitonte Agim Limani. Kishte ardhur mjeku i tyre i dikurshëm dhe ata nuk mund ta linin një rast të tillë. Zunë vend në stolat para ambulancës dhe ,duke kuvenduar me gaz me njëri-tjetrin, prisnin. Brahe Muça ishte në qendër të kuvendit dhe nuk mbahej nga gazi që ndiente.

— Ore, Braçe, — ia priti një plak, moshatar i tij, — po nuk kemi për të jetuar gjithnjë në këtë jallan dynja, bre... Rrobë e vjetër jemi ne tani: ktheje, arnoje, bëji ç'të duash, por të re nuk e bën dot... Më në fund të shkërmoqet dhe të ngelet në duar, nuk duron as perin, as gjilpërën. Ja, kështu jemi edhe ne, o derëbardhë...

Plaku që foli nuk kishte fare dhëmbë dhe fjalët i nxirrte nga goja me cërka pështyme...

— Nuk them se do të bëhemi të rinj, — tha Brahe Muça duke marrë pozën e atij që do t'u japë mend të tjerëve. Po njeriu, sa të jetë, do të jetë me këmbë e me duar, me sy e me veshë, të ecë dhe të dëgjojë. Ja, këtë dua unë dhe nuk dua të jetoj gjithnjë mbi dhé!

Në orën shtatë erdhi mjeku i spitalit dhe pleqtë e ndërprejnë bisedën që kishin nisur.

— Keni ardhur herët, — u tha pleqve mjeku i ri. Vizitat fillojnë në orën dhjetë, kurse tani as tetë nuk ka shkuar, Së pari do të fillojnë vizitat në spital, me të shtruarit.

— Fillo, ore, me kë të duash, — i foli atij plaku që nuk kishte asnjë dhëmb në gojë. — Ne këtu jemi, ore, presim, se nuk kemi ndonjë hall...

Pastaj qeshi hihhi, duke zbuluar mishraç e dhëmbëve.



Mjekun e spitalit e quanin Simon. Ishte një djalë punëtor dhe i kujdesshëm, prandaj Brahe Muça nuk donte t'ia prishte duke i thënë se nuk kishin ardhur për të, por për Agim Limanin. Kurse plaku pa një dhëmb në gojë donte të tallej me mjekun e ri... Ah, ç'je një rrufjan ti, i thoshte me mendje Brahe Muça plakut, ç'je ti një...

Po mjekut të ri iu duk se pleqtë nuk e kuptuan, prandaj e pa të udhës që t'ua shpjegonte edhe një herë si ishte puna. Ai iu drejtua plakut pa dhëmbë në gojë, se ai iu duk si më i lashti.

— Në ora dhjetë, xhaxha... Duhet edhe dy orë për të vajtur ora dhjetë. Përse të prisni kaq gjatë? Shkoni andej nga klubi edhe bëni muhabet, pini ndonjë kafe... Koha kalon më shpejt atje...

Mamia, një vajzë e re dhe e shëndetshme, shikonte pleqtë me një buzagaz të lehtë. «Eh, ç'vete me këta», sikur thoshte vështrimi i saj.

— Shkoni, se sot vjen edhe zëvendësministri, — sikur deshi t'u lutej mjeku. — Nuk bën t'ju gjejë të gjithë këtu që në pikë të sabahut!

Pleqtë shikuan njëri-tjetrin dhe vështrimet i kryqëzuan te fytyra e Brahe Muçës.

— Po ne për zëvendësministrin kemi ardhur, more bir, — i tha Brahe Muça. — Do të na bëjë një vizitë Agimi. Nuk të shajmë ty, or djalë, të paçim e qofsh me jetë, por ai na i ka mësuar sëmundjet që kemi...

Mjeku në fillim u hutua, por e mblodhi shpejt veten.

— S'e kam aty, xhaxha, — i foli ai Brahe Muçës. — Ku unë dhe ku Agim Limani për atë punë. Jo pse është zëvendësministër, por është nga mjekët më të zotë që ka Republika.

— Më rrofsh, or djalë, edhe ti do të bëhesh mjek i mirë, — i tha Brahe Muça.

Nuk kaluan as dhjetë minuta dhe te plepat

e fshatit, në të dalë të Buzëdrinasit, u duk vetura e zëvendësministrit. Pleqtë lëvizën të shqetësuar. «Po sikur të mos kthejë fare kënde», mendoi Brahe Muça, megjithëse nuk ia merrte kurrë mendja një gjë të tillë. Pleqtë nuk e bënë veten, megjithëse të gjithë ndiqnin me shqetësim veturën. Po shpejt u pa se vetura mori rrugën për në spital. Pleqtë u ngrehosën dhe Brahe Muça tha:

— Eh, e dija unë që do të vinte.

Makina u ndal para sheshit të bleruar në qendër të kooperativës. Zbritën Agim Limani dhe kryetari i këshillit të bashkuar. Kryetari i futi krahun zëvendësministrit dhe e ftoi të pinin një kafe. Ky e kundërshtoi me mirësjellje dhe tha se e prisnin.

— Kush ju pret? — e pyeti kryetari.

— Ja, — bëri me dorë nga pleqtë Agim Limani. — Ata duan që t'i vizitoj unë. Kafën e pimë pastaj.

Agimi shkoi te pleqtë dhe u përçafua me të gjithë, i pyeti për shëndetin. Ata gëzoheshin kur ai ua përmendte sëmundjet që kishin, gëzoheshin se nuk i kishte harruar, madje mbante mend edhe nga se vuante secili.

Plaku pa dhëmbë iu ankua për ujin e hollë që s'e mbante dot dhe të gjithë u gajasën së qeshuri.

— Pleqëri hesapi, — thoshte plaku sikur gëzonte që ishte aq i plakur. — Pleqëria i ka këto, dihet...

— Jo, jo, — e kundërshtoi duke qeshur Agim Limani. — Një operacion i vogël dhe sëmundja kalon për mrekulli.

— Në dorën tënde, ama, atje, në Tiranë, — pllaquriti buzët plaku.

— Në dorën time dhe të shokëve të mi, —  
tha Agimi.

Brahe Muça po mërzhitej për ankesat e kërkesat e pafundme të pleqve. Ai e kapi për krahu Agim Limanin dhe e pyeti:

— Si je, djalë? Ke punë shumë tani?

— Mirë jam, — tha Agimi buzagaz, — po ti si je, si po shkon me veshkat? Hë, hë, se si djalë dukesh, nuk kanë ç'të të bëjnë. Do të të shoh edhe sot, por në të parë më dukesh mirë...

— Më rrofsh, më rrofsh, — i thoshte Brahe Muça duke i fërkuar shpatullat.

Doli edhe personeli shëndetësor i spitalit dhe u takuan me zëvendësministrin.

— Si thua, Simon? — e pyeti ai mjekun e ri.  
— E ndryshojmë orarin për sot? T'i vizitojmë të parët, ë?

— Si të doni ju...

— Fillojmë, — tha zëvendësministri dhe u fut në dhomën e mjekut.

Pleqtë i shkuan pas.

## Zogu i vogël

Në pesëdhjetëvjetorin e shkollës sonë kishim ftuar edhe piktorin Abdyl Buzani. Ndërsa të tjerët u shpërndanë nëpër kabinetet e shkollës, ai shfaqti dëshirën të shikonte ekspozitën personale të mësuesit të vizatimit, që ishte hapur me këtë rast. Ne e dinim se këtu e pesëdhjetë vjet më parë piktori Abdyl Buzani kishte mësuar në një klasë, të cilën ne tani e përdornim si magazinë. Menduam që ta hapnim ekspozitën pikërisht aty, në atë dhomë dhe ashtu u bë.

Piktori më futi krahun dhe së bashku me mësuesin e vizatimit e drejtorin u nisëm për në sallën e ekspozitës. Piktori vështronte me interes punimet. U ndal pak si gjatë para një peizazhi, ku dukej një degë lajthie dhe një zog i vogël që diç çukiste. Peizazhi titullohej «Pranvrë», por piktori tha si me vete «Zogu i vogël.» Këto fjalë i shpëtuan pa dashje dhe, sikur të ishte zgjuar nga një dremetje e lehtë, i tha drejtorit:

— Kujtimet, shoku Basho, kujtimet.

Ai dukej i mallëngjyer, gjë që i shfaqej në dridhjen e duarve.

— Ishte viti 1928, — tha piktori. — Atëherë unë isha në klasën e pestë. Rrija në një bankë këtu, pranë dritares.

Me të thënë këto fjalë, shkoi te dritarja dhe vuri dorën në parvazin e saj. Dora e tij sikur e përkëdhelte drurin e vjetër. Matanë dritares dukej peizazhi i vjeshtës, aq i dashur dhe i pranishëm në veprat e piktorit.

— Atëherë ishte pranverë, — nisi të fliste si me vete ai. — Këtu, matanë dritares, ka qenë një pjeshkë. Ne prisnim që të hynte në klasë mësuesi i vizatimit. Bënim zhurmë se nuk e donim atë mësues. Na rrihte dhe na fyente për hiçgjë. Ora e vizatimit na ishte bërë më e mërzitshmja, edhe mua, që e doja vizatimin shumë, më ishte vështirosur. Na sillte në klasë lloj-lloj vjetërsirash dhe na detyronte që t'i vizatonim. E quanin Hasan. Ishte injorant dhe nuk merrte vesh fare nga vizatimi. Disa vite më parë kishte shërbyer si dervish te sheh Bajrami dhe, me vdekjen e këtij të fundit, bëri si bëri dhe e rregulloi të bëhej mësues.

Ishte mik i ngushtë i mësuesit të fesë, sheh Mazllumit, që të bardhën e syve e kishte përherë të kuqe dhe rrinte vetullngrysur. Ndërsa te Mazllumi injoranca ishte disi e maskuar, te Hasani binte në sy menjëherë. Mazllumi mendonte para se të fliste, kurse Hasani fliste gjithnjë pa menduar.

Njëherë në klasën tonë një nxënës, Feriti, që më pas ra dëshmor, i punoi një reng Hasanit. Mbase ishte i vetmi nxënës në klasë që urrejtjen dhe përbuzjen i shfaqte hapur. Feriti atë ditë mori koshin e plehrave, e mbushi përgjysmë me hi dhe, si hapi derën e klasës paksa, e vuri koshin lart. Hasani erdhi me atë hapin e tij të rëndë dhe u habit kur na pa ulur nëpër banka dhe në qetësi të plotë. Kur e hapi plotësisht derën, koshi bëri

një rrotullim dhe iu rras në kokë. Hasanin e mbuloi hiri dhe klasa shungulloi nga të qeshurat. Kur u shkund dhe u fshi disi, sa mund të na shikonte, me një zë të egër e të lartë pyeti:

— Kush e bëri këtë?

Ne, kuptohet, nuk përgjigjeshim dhe ai përplaste këmbët nga zemërimi.

— Rebelë, horra! — u çor ai. — O do të tregoni fajtorin, o do t'ju kalb në dru të gjithë!

Prapë asnjeri nuk foli. Na rrahu të gjithë, megjithatë askush nuk nxori një fjalë nga goja. Thirri edhe drejtorin. Hiç, prapë askush nuk foli. Që nga ajo kohë klasën tonë e mori shumë inat.

Kjo që do t'ju tregoj tani ndodhi tri javë më vonë. Hyri në klasë dhe, si përherë, na shikoi me inat. Kur hynte ai në klasë, bëhej një rrëmujë e madhe. Disa uleshin e të tjerët ngriheshin. Ashtu ndodhi dhe atë orë. Ai nisi nga të bërtiturat: «Ngrihuni! Uluni! që ne i quanim «ushtrimet». Kjo ishte një lloj hakmarrjeje që ai e përdorte kundër nesh, por që nuk i sillte asnjë dobi. Atë ditë i vazhdoi për një kohë më të gjatë «ushtrimet». Po sa më shumë zgjateshin ato, aq më shumë rrëmujë bëhej. Më në fund u ulëm të gjithë dhe ai filloi mësimin. Në duar mbante diçka të mbështjellë me një cohë të kuqe. Mori një pamje fodulle dhe filloi ta shpëstjillte sendin ngadalë, që të na zgjonte kureshtje. Ishte një libër i vjetër, shumë i vjetër. E mbante në duar me respekt dhe këtë ndjenjë donte të na e detyronte edhe neve. Po ne rrinim krejt mospërfillës.

— Ky është Kurani, libri i shenjtë, — tha ai. — Sot do të vizatojmë kuranin.

E vuri vjetërsirën në tryezë që ta shikonim të gjithë. Sefa, një dialë çapkën, oë hiqej sikur e respektonte Hasanin, u ngrit e tha:

— Zotni, ne nga fundi nuk e shikojmë mirë.

Sikur ta vëmë pak më lart librin e shenjtë!

Sefa fliste me një seriozitet të shtirur, madje ai përpiqej t'i jepte fytyrës një shprehje përlësie e mirësie, por ne e dinim se ai mezi e mbante gazin. Mësuesi e shikoi me vëmendje, sikur donte ta hetonte nëse e kishte me gjithë mend apo tallej.

— Ke të drejtë, Sefë! Po ku ta vëmë? — tha Hasani.

— E rregulloj unë, — tha Sefa dhe doli nga banka e shkoi gati me vrap te tryeza.

E mori ngadalë Kuranin në dorë sikur të ishte diçka që lëngonte, por, nga mënyra se si e mban-te, dukej që tallej. Ne e mbanim të qeshurën me zor. Veç sytë e Hasanit shkëlqenin kur shikonte Sefën që me shumë kujdes vuri një karrige në tryezë, mbi karrige vuri një stol dhe sipër tij Kuranin... Por, kur bëri të ulej në vend, e lëvizi si padashur tryezën dhe karrigia, stoli dhe libri i shenjtë u rrokullisën e ranë në dysheme. Në klasë shpërthyen të qeshurat si asnjëherë tjetër.

— Ç'na bëre, bre Sefë, — thirri Hasani, që nuk e kishte kuptuar lojën.

— Më falni, zoti mësues. Më shkoi gjithë ai mund kot. Po e rregulloj prapë unë.

U deshën edhe dhjetë minuta që Sefa ta rregullonte Kuranin jo tamam siç qe, se Hasani nuk deshë më që ta vinin sipër stolit. Me mërzë dhe ngathtësi nxorëm fletoret e vizatimit. Mua nuk më bëhej ta filloja punën fare. Qëndroja kot, me fletoren përpara dhe me lapsin në dorë. Hapa përgjysmë dritaren. Ishte pranverë dhe kishte shpërthyer dushku në pyllin e vogël. Ai të joshte me blerimin e tij, që kishte diçka prekëse. Ndihej jeta dhe kraharori sikur po më zgjerohej nga filladi i lehtë i pranverës. Këtu, afër dritares, ka qenë një pjeshkë. Më vjen keq që ajo nuk është më.

Pjeshka kishte lulëzuar dhe lulet rozë të saj ngjnin si të stampuara në sfondin e blertë të pyllit.

Te një degë e pjeshkës kishte qëndruar një zog. Ishte një bilbil. E kisha dëgjuar edhe herë të tjera këngën e tij, por kurrë nuk më ishte dukur aq e bukur, aq e ngrohtë. Bilbili bënte fitcurr, fi-tcurr, fi-tcurr, lju-lit, çoçoço, teeerrccc... dhe mua më dallgëzohej zemra. Bilbilin fillova ta skicoja në fletore. Ai shikonte nga unë dhe mua më dukej se ishte i kënaqur që po merresha me të. Dora më dridhej nga emocioni, por vijat në fletore i hiqja të sigurta. Provoja njëfarë dehjeje të ëmbël që ma ngrinte zemrën peshë. Nxitoja si në ethe, ngaqë kisha frikë se mos zogu fluturonte. Por ai, sikur ta dinte hallin tim, kërcente nga dega në degë dhe nuk largohej. «Jo, zogu ka për të ndenjtur edhe pak», thosha me vete dhe fillova të punoja me dëshirë të madhe, por, kur ngrita kokën nga fletorja dhe shikova matanë dritares, ai kishte ikur. Mua nuk më erdhi keq, se më dukej se ai rrinte prapë aty, në ato degë, dhe këndonte si pak çaste më parë...

As që e vura re mësuesin kur, me atë hapin e rëndë e të ngadaltë, kaloi përmes bankave. Erdha në vete nga zëri i tij i vrazhdë që më buçiti mu te veshi:

— Ç'po bën, or horr? Kush të tha të vizatosh zogj?!

E vështrova në sy, pa ditur ç't'i thosha.

— Po ja... — m'u mor goja mua.

Nxënësit e tjerë ngritën kokat nga fletoret. Disa u ngritën më këmbë dhe erdhën te banka ime.

— Sa bukur. — tha Feriti për vizatimin tim.

— Ç'mrekulli, — tha një tjetër.

— Ah, të dija të vizatoja edhe unë një zog si ky.



— Abdyli është piktor i vërtetë!

— Rebelë! Horra! Kush ju dha leje të lëvizni nga vendet?! — u bërtiti Hasani.

Nxënësit shkuan secili në bankën e vet. Prisin me ankth ç'do të më punonte mua Hasani. Ai i revoltuar dhe unë me bukurinë e pafajësinë e frymëzimit në zemër qëndronim përballë njëri-tjetrit. Më goditi fort me shuplakë, sa m'u errën sytë. Mori fletoren time e doli para klasës, te dërrasa e zezë.

— Shikojeni! — u tha të gjithëve. — Shikojeni ç'ka bërë horri!

— Sa bukur, — tha Feriti prapë.

— Bukur, ë? Horr horri, qafir! — ulëriu Hasani dhe, si vuri fletoren time mbi tryezë, nxitoi drejt Feritit, që ta ndëshkonte. Por ai, si një kaproll i vogël, kërceu midis bankave, i vendosur të mos i binte në dorë. Pas disa çastesh u ndodh para dërrasës së zezë me fshirësen në dorë. Hasani ishte atë çast në fund të klasës, i tronditur nga vrapit që kishte bërë.

— Përjashta, rebel! — ulëriu ai.

— Na, mbaje, — thirri Feriti duke e goditur Kuranin me fshirëse.

Kurani u lëkund dhe ra në dysHEME, Feriti vrapoi e doli përjashta. Në klasë u bë rrëmujë e madhe, dhe Hasani, pasi vendosi qetësinë, e mori fletoren time dhe, duke e mbajtur lart që ta shikonte tërë klasa, tha:

— Ky është mëkat, mëkat i madh, i rëndë. Ju po dilni kundër zotit, po ikni nga rruga e tij!

— Përse qenka mëkat? — mora guximin dhe e pyeta.

— Se është qenie e gjallë, prandaj. Qeniet e gjalla i bën veç zoti e jo njeriu. Ato nuk vizatohen. Ja, ia bërë këtij zogu krahët, kokën, këmbët, po shpirt a i jep vallë? Jo, nuk i jep. Shpirt i

jep veç zoti. Qenie të gjallë pa shpirt nuk ka... Mëkat, mëkat i madh!

Ra zilja dhe ne u kënaqëm shumë. Morëm frymë të lehtësuar se do të na hiqej nga sytë fytyra e Hasanit. Por ai, i përskuqur dhe i ngrehosur, qëndronte para klasës sikur donte të bënte hatanë. Shkoi te dera dhe e hapi atë.

— Zoti Mazllum, zoti Mazllum, — thirri mësuesin e fesë, i cili ato çaste po shkonte në korridor.

Mazllumi hyri në klasë me atë pamjen lajkatare që e karakterizonte dhe me qetësinë e shtirur.

— Në shpirtin e këtij fëmije ka hyrë djalli, zoti Mazllum, dhe ka dalë zoti, — i tha atij Hasani duke i treguar vizatimin tim.

Mazllumi e shikoi vizatimin një copë herë të mirë.

— Mëkati është i rëndë, shumë i rëndë, — tha ai duke na përfshirë me një shikim të gjithë, — por zoti i fal ata që pendohen, bijtë e mi, është mëshirëmadh dhe i fal.

Fjalët e fundit i tha duke më ngulur sytë e tij ngjyrë hiri.

— Nuk kam përse të pendohem, — thashë i vendosur dhe pa asnjë grimë frike. — Unë vizatova një zog dhe nuk e kuptoj se ç'mëkat kam bërë!

Mazllumi tundi kokën sikur të ndiente një keqardhje të madhe për mua dhe më tha:

— Qoftëlargu paska punuar me kohë në shpirtin tënd, biri im. Ta paska gërryer shpirtin e zemrën dhe ti tani nuk di ç'thua e ç'bën.

Në klasë hyri mësuesi i letërsisë, me të cilin kishim mësim atë orë.

— C'ka ndodhur, kolegë të dashur, — u tha ai Mazllumit dhe Hasanit.

Na buzëqeshi neve, por buzëqeshja iu shua në çast kur pa të dy kolegët në fytyrë.

— Shikoni ç'ka ndodhur, zoti Haki, — i tha atij Hasani duke i vënë në dorë fletoren time të vizatimit. Mësuesi i letërsisë i hodhi një vështrim vizatimit tim, pastaj e largoi pak dhe filloi ta kundronte me një kënaqësi që i dukej në bebëzat e syve.

— Kush e bëri këtë? — na pyeti ne. Vështrimi i tij ishte i qeshur e zemërdhënës.

Unë u ngrita më këmbë. Mësuesi i letërsisë më shikoi në sy sikur donte të më thoshte: «Të lumtë, Abdyl, paske vizatuar bukur!» Po me gojë u shpreh pak ndryshe:

— Hë, Abdyl, ti i bën këto gjëra? Po mirë, mirë, paske vizatuar bukur... Unë të përgëzoj, Abdyl!

Mazllumi, që gjer atëherë e kishte ruajtur gjakftohtësinë, kur dëgjoji mësuesin e letërsisë që foli ashtu, u kthye me vrull nga ai, e shikoi me ngulm në sy dhe i tha:

— Zoti Haki, ju s'shikoni ndonjë gjë të keqe në këtë vizatim?

— Përkundrazi, shoh diçka shumë të bukur. Abdyli ka talent dhe me siguri do të bëhet piktor i mirë... Kjo duhet të na gëzojë, kolegë të dashur.

— Zoti Haki, — ia preu fjalën Mazllumi. i bërë flakë në fytyrë, — mos bëni sikur nuk e shikoni mëkatën e rëndë të nxënësit tuaj. Ai fëmijë ka vizatuar një krijesë të zotit, një qenie të gjallë, një gjë me shpirt. Ju e dini fare mirë që ky është një mëkat i rëndë. Shpirtin e jep vec zoti.

— Mua më duket se Abdyli edhe shpirtin ia ka dhënë këtij zogu, zoti Mazllum, — ia preu fjalën kësaj radhe mësuesi i letërsisë. — Ja, nuk të duket sikur këndon në fletore ky zog? Nuk të duket sikur po bie pranverën në klasë?!

— Ne po përpiqemi të ruajmë tufën, por nuk paskemi bariun në rregull, — tha Mazllumi duke i hedhur një vështrim të egër mësuesit të letërsisë.

— Ja pse ndodhkan këto gjëra në klasën tuaj! I frymëzoki ju, zoti Haki. Ky është vizatim në kundërshtim me mësimet e fesë dhe, siç del, unë ndenjкам kot këtu... He, zoti Haki, është në kundërshtim me fenë apo jo? M'u përgjigj!

— Me fenë është në kundërshtim, por nuk është në kundërshtim me jetën, — tha mësuesi i letërsisë. — Arti pasqyron jetën. Këtë e pohon tërë krijimtaria e shkrimtarëve dhe artistëve të mëdhenj... Mos doni t'ju kujtoj inkuizionin, zoti Mazllum?! Të vërtetën nuk e mposht as shpata, as zjarri...

— Të mora vesh se kush je, — i tha me zjarr Mazllumi duke iu hedhur t'i rrëmbente nga duart fletoren time të vizatimit.

Po mësuesi i letërsisë e ngriti dorën lart dhe, me një vështrim përbuzës e në të njëjtën kohë kërcënues, e bëri Mazllumin të stepej.

— Ma jepni këtë fletore se do t'ia çoj drejtorit, — tha Mazllumi.

— Mund të shkoni te drejtori, derën e keni të hapur, — i tha me ton të rreptë mësuesi i letërsisë. — Fletoren do ta mbaj unë. Këtë mëkat të madh, — tha me tallje mësues Hakiu, — do ta bëjmë problem këtu në klasë, pastaj, po qe nevoja, në drejtori. Tani kam mësim dhe, ju lutem, më lini ta zhvilloj atë.

Hasani, që nuk kishte folur asnjë fjalë gjer atëherë, tha:

— Jo, more, dashke ta mbyllësh këtë punë ti. Po ku të lëmë ne.

Iu afrua mësuesit të letërsisë që t'i merrte fletoren e vizatimit.

— Përjashta, — u bërtiti mësuesi i letërsisë të dyve.

Ata dolën të trembur deri te dera.

— Kjo punë nuk ka për të mbaruar kështu, — thanë njëzëri Mazllumi dhe Hasani dhe, të revoltuar, mbyllën derën. Hapat e tyre trokëllinë në korridor.

Unë për atë vizatim gati sa nuk u përjashtova nga shkolla. Mësuesin e letërsisë pas ca ditësh e transferuan. Nuk pata mundësi më të pyesja për fletoren e vizatimit. Por edhe s'kisha pse të pyesja, se mendja më thoshte që ajo kishte përfunduar në sobën e drejtorit të shkollës.

Piktori Abdyl Buzani ndihej i lodhur dhe disi i mallëngjyer. Vështroi përjashta sikur donte të gjente prapë atë zogun e vogël në degën e pjeshkës. Drejtori i shkollës i tha:

— Sikur të shikonit edhe vizatimet e nxënësve. Kemi hapur një ekspozitë të thjeshtë...

— Patjetër, patjetër, — tha piktori dhe u ngrit.

Salla ku kishim ekspozuar punimet e nxënësve ishte në aneksin e shkollës, nja dy klasa të reja që ishin ndërtuar një vit më parë. Duke shkuar aty, u ndalëm para tabelës, ku shkruhej: Shkolla tetëvjeçare «Ferit Drini». Piktori e vështroi gjatë tabelën dhe përmendi emrin e shokut të dikurshëm të klasës, të dëshmorit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

— Që atëherë të merrte gjak në vetull, — tha ai për Feritin. — Sikur të ngrini bustin e tij këtu, në sheshin para shkollës. Do të bisedoj unë me një skulptor...

— Shumë mirë, ju falemi nderit, — tha drejtori.

U futëm në sallën e ekspozitës. Vizatimet ishin të thjeshta, shumica vizatime nga orët e mësimit, por kishte edhe akuarele...

— Këtu kemi edhe vizatimin e një nxënësi të vitit 1928, — tha drejtori i shkollës. — Është ruajtur prej pesëdhjetë vjetësh dhe do të ruhet gjithmonë.

— Piktori shkoi drejt atij vizatimi i vëmendshëm dhe i çuditur. Në një fletë fletoreje vizatimi ishte vizatuar një zog i vogël mbi një degë pjeshke. Piktori shtangu nga habia dhe mallëngjimi.

— Si... si ka mundësi?! — pyeti i çuditur.

— Një vit para se të vdiste, na e dorëzoi mësuasi juaj i letërsisë, zoti Haki... — i tha drejtori.

Piktorit përsëri iu drodhën duart. Zogu qëndronte aty, mbi degën e pjeshkës, si të ishte i gjallë, sikur po bëhej gati të fluturonte. Në atë fletë vizatimi mungonin ngjyrat, mungonte blerimi i pyllit, mungonte roza e pjeshkës, pendët e shkruara të bilbilit, megjithatë në atë vizatim, sikur ishin të gjitha: edhe ngjyrat, edhe pranvera, edhe kënga e paharruar e atij zogu: fitcurr, fi-tcurr, lju-lit, çoçoço, trrccc...

## Fytyra e miqësisë

Dega e Lidhjes së Shkrimtarëve më ngarkoi me detyrë të shkoja në ndërmarrjen e punimeve të ndryshme, sepse organizata e rinisë do të bënte diskutimin e një romani me temë për familjen. Unë do të jepja konkluzionet e këtij diskutimi. Po kjo është tjetër punë. Ajo që dua t'ju tregoj, nuk ndodhi gjatë diskutimit, por kur pjesëmarrësit u shpërndanë. M'u afrua Elvira, një vajzë shtathedhur, me tipare të bukura. Ajo nuk diskutoi, por unë e kuptova se kishte diçka për të thënë. Nganjëherë diskutimet më interesante bëhen pasi ka mbaruar, si të thuash, diskutimi zyrtar.

— Desha t'ju pyes për diçka, — më tha ajo.

— Urdhëroni, — i thashë, i gatshëm për ta dëgjuar.

Ajo, kur pa interesimin tim, sikur mori guxim.

— Ju mendoni se mund të ketë vetëm shoqëri midis një djali dhe një vajze?

Kuptova ato që thashë në mbyllje të diskutimeve për romanin dhe nuk mbaja mend të ki-

sha shfaqur ndonjë mendim të tillë. Në të vërtetë kisha folur për gjëra të tjera dhe këtë problem nuk e preka.

— Më duket se nuk e thashë një gjë të tillë, — u përgjigja. — Por, meqë po më pyetni, unë mendoj se midis një djali dhe një vajze mund të ketë edhe vetëm shoqëri, miqësi të singërtë. Natyrisht jo në të gjitha rastet.

— Po dashuria a kalon përmes shoqërisë? — më pyeti ajo.

Unë kisha dyfishin e moshës së saj dhe kjo e lehtësonte bisedën me Elvirën edhe për probleme të tilla.

— Jo gjithmonë, — i thashë. — Ka shoqëri që kthehet në dashuri, por edhe mund të mos ndodhë kështu, mund të mbetet një shoqëri e pastër, vetëm shoqëri, për tërë jetën.

— Kjo mund të ndodhë, por unë e kam fjalën për një rast më të vështirë, — tha Elvira duke e vënë theksin mbi fjalën e fundit.

— Për ç'rast e keni fjalën? — e pyeta.

— Ja, për ndonjë rast kur djali e vajza kanë shoqëri të ngushtë me njëri-tjetrin. Po vjen një kohë që djali i shfaq dashurinë vajzës, ose vajza djalit. Po njëri nuk pranon dhe thotë që duhet të mbeten siç kanë qenë, shokë... Në këtë rast a mund të vazhdojë shoqëria e singërtë midis tyre?

Ecnim drejt parkut me hapa të ngadaltë. Doja që biseda të ishte sa më e shpenguar dhe intime. U përpoqa të bëja shaka:

— Nga përvoja ime nuk di ç'të them, por jam i mendjes që edhe në këtë rast shoqëria mund të vazhdojë. Kjo është plotësisht e natyrshme.

— Teorikisht? — qeshi ajo.

— Jo, edhe praktikisht. Unë di mjaft raste...

— Unë di dy raste nga praktika, — tha Elvi-



ra. Tani ajo u skuq pak dhe unë e kuptova se do të tregonte diçka për veten.

— Unë po flas me një njeri që më kupton, — tha ajo. — Ju jeni shkrimtar dhe në tregimet tuaja kemi ndeshur edhe tema të tilla, që flasin për marrëdhëniet midis të rinjve dhe të rejave, por, të them të drejtën, vetëm sa ceken. Nuk ju vjen keq?

— Jo, aspak. Përkundrazi.

— Po nejtse, tani e kam fjalën për tjetër gjë. Ju e patë si diskutoi Shpresa. Ishte ajo vajza me flokë të verdhë që foli e fundit.

Mua nuk më kujtohej Shpresa, të paktën si fytyrë, por diskutimin e saj dhe të të gjithë atyre që folën i kisha shënuar në bllok në mënyrë të përmbledhur. E hapa që ta kujtoja ç'kishte folur Shpresa, por Elvira më tha:

— Shpresa shfaqti mendimin se një vajzë, po nuk iu përgjigj dashurisë së një djali, nuk mbahet më për shoqe prej tij. Përkundrazi, ai e urren, se ndihet i fyer në sedrën prej djali, sado që nuk ka të drejtë. Shpresa niset nga një rast konkret, që i ka ndodhur vetë asaj. Ajo katër vjet më parë kishte shoqëri me një djalë, shoqëri të ngushtë. Po një ditë ai i shprehu dashurinë, sado që ajo ishte sjellë shumë korrekte dhe nuk i kishte dhënë asnjë rast për një gjë të tillë. Dua të them që e donte vetëm si shok. Edhe kur i shprehu dashurinë, ajo i kërkoi të mbeteshin shokë, sepse nuk ndiente gjë më tepër për të. Po djali iku i fyer dhe jo vetëm nuk e mbajti për shoqe, por filloi të trillonte poshtë e lart gjëra të paqena dhe të hidhte baltë mbi shoqërinë e sinqertë që kishte pasur dikur me shoqen e tij.

— Ju kuptoj. — i thashë për ta nxitur.

— Tani unë dua t'ju tregoj diçka nga jeta ime, — tha Elvira dhe një të kuq i lehtë ia përflaku

tërë fytyrën. — Si shkrimtar mbase edhe mund t'ju hyjë në punë...

— Sigurisht.

— Atëherë unë isha në vitin e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme pa shkëputje nga puna. Lejen shkova ta kaloja në Lurë. Aty u njoha me Gonin, që kishte mbaruar gjimnazin katër vjet para meje. Punonte si ekonomist në një ndërmarrje. Me të njihesha edhe më parë, se qyteti ynë është i vogël dhe njerëzit njihen pothuaj të gjithë me njëri-tjetrin, por shoqëri nuk kisha pasur. Ai më tërhoqi menjëherë se ishte djalë me karakter dhe lexonte shumë. Edhe unë lexoj, por Goni jepte mendime të vlefshme për librat dhe, të them të drejtën, përfitova shumë prej tij. Po pushimet mbaruan dhe ne u kthyem prapë në qytetin tonë. Kujtova shoqërinë time me Gonin dhe mendova se aq e pati, se njerëzit, kur janë larg vendit të lindjes, punës, familjes, fjala vjen, në një shtëpi pushimi, zënë ndonjë shok a shoqe, por në mjaft raste këto zëvendësojnë si të thuash përkohësisht shokët dhe shoqet e tua të ngushta që nuk janë me ty ato ditë. Më vonë harrohen dhe kur vjen, fjala vjen, në qytet, mund edhe të mos u flasësh fare. Po ditët kalonin dhe, të them të drejtën, për Gonin më mori malli. Edhe në qytet e ndieja nevojën për t'u takuar me të dhe për të biseduar. Ai, sa erdhi nga kampi, shkoi disa ditë me shërbim dhe nuk patëm rast të shiheshim. Kur shkoja në punë ose kur dilja nga puna, kur shëtitja, e kërkoja Gonin me sy dhe kisha dëshirë ta takoja. Po a e dashuroja Gonin? Këtë pyetje ia kisha bërë vetes shumë herë dhe isha e sigurt për ndjenjën time se nuk e dashuroja! Po ç'ishte pra ajo dëshirë për ta takuar Gonin dhe për të biseduar me të? Ishte e nxitur vetëm nga sho-

qëria, ajo shoqëri që lindi në kamp. Këtë e them me bindje dhe siguri të plotë. Dhe koha e vërtetoi këtë.

Një ditë, krejt papritur, kur unë thuajse e kisha harruar Gonin, e pashë në shëtitore. E thirra dhe ai erdhi pothuaj me vrap. Kuptohej që edhe atë e kishte marrë malli dhe e kishte ndier mungesën time. Ky takim u bëri përshtypje atyre që na panë, i bëri përshtypje edhe Shpresës, shoqes sime, për të cilën ju fola pak më parë.

— Ç'ke me këtë Agronin ti? — më pyeti ajo sapo u ndamë me Gonin.

— Asgjë, vetëm shoqëri, — i thashë.

— Vërtet thua? — më pyeti me njëfarë dyshimi.

— Po të kisha tjetër gjë, do të ta kisha thënë.

— Prite kur të të propozojë ndonjë ditë, — tha Shpresa disi e lënduar. Vetëm te propozimet u rri mendja atyre...

— Mos fol kështu, Shpresa, — i hoga vërejtjen unë, sepse më dukej se me ato fjalë po fyente shoqërinë time të singertë.

— Ke për të parë, — tha ajo e sigurt.

— Nuk ka për të ndodhur ashtu, — i thashë.

— Po sikur të ndodhë, si do t'i përgjigjesh? — më pyeti Shpresa duke më vështruar në sy.

— Derisa e dua vetëm si shok, kështu do t'i them.

— Po ai nuk ka për ta kuptuar këtë, moj Shpresa.

Ato çaste nuk i besoja kurrë ato që thoshte Shpresa. Fjalët e Shpresës i lidhja me qëndrimin që kishte mbajtur ndaj saj ai djali...

Takohesha vazhdimisht me Gonin, shëtitnim bashkë dhe një ditë, ishte e para herë, u ulëm në «Turizëm» dhe morëm nga një limonadë. Atë

ditë në sytë e tij seç pashë një dritë tjetër, të ndryshme nga ajo e herëve të tjera. Atë ditë ai rrinte i menduar dhe sikur e kishte humbur shpengimin që zakonisht kishte në bisedat me mua. Po njeriu mund të ketë plot halle...

— Të shikoj pak të menduar, — i thashë. kur kishim dalë nga «Turizmi» dhe po ecnim në rrugën më të bukur të qytetit, që është ajo malorja e vogël. Ishte mbrëmje dhe nata kishte hënë. Mendova të bëja shaka me Gonin. E pyeta pa të keq:

— Mos ke rënë në dashuri. vëllaçko?

Këtë pyetje nuk mund ta bëja pa përdorur fjalën *vëllaçko*, që nuk ia kisha thënë ndonjëherë. Ajo do të ishte, si të thuash, një barrierë që mbyll çdo shteg për atë që unë kisha frikë. Po Goni nuk u ndal para asaj fiale, sado që, e vura re, e pati shumë të vështirë.

— Po, tha ai i qetë dhe si i lodhur, — kam rënë në dashuri! Dua një vajzë.

— Po cila qenka ajo vajzë?

Po të flasim me gjuhën e shifrave, siç thonë, do të thosha se 90 për qind isha e sigurt që ajo vajzë isha unë. Dhe ashtu doli.

— Je ti, Elvira. — më tha Goni duke më vështruar në sy dhe si i cilruar nga gjithë ai ankth që e kishte mbajtur përbrenda tërë ato ditë.

Kaluan disa caste pa folur fare as unë, as ai. Ai priste përgjigjen time. U ndala dhe e shikova në sy.

— Goni, unë të kam vetëm shok, — i thashë. — Nuk të kam dhënë asnjë rast për të më bërë një propozim të tillë...

— Mos vallë të fyej kur të them të dua? — më pveti.

Atij i dridhej zëri dhe ishte krejt ndjenjë. E kuptova që më donte sinqerisht, se ia njihja

karakterin, por unë nuk ndieja asgjë për të.

— Jo, Goni, nuk më fyen, por sesi më vjen. Në fakt njëfarë fyerjeje ka këtu: fyhet shoqëria jonë e sinqertë. Po të të doja më shumë se një shok, do të të kisha dhënë të kuptoje sadopak. Natyrisht, po ta kuptoja se edhe ti më do.

— T'i lëmë filozofimet, — më tha ai disi i prekur. — Domethënë ti nuk ndien asgjë për mua? Kështu?

— Kështu, — thashë, — veç shoqërisë...

— Dhe unë gabova?!

— Po.

Ai u nxi në fytyrë dhe më erdhi vërtet keq për të. Nuk dija ç'të bëja që ai të mos ndodhej në atë gjendje. Veç t'i thosha të dua pa e dashur. Po këtë nuk do ta donte as Goni.

— Nuk ndiej, Goni, — i thashë me një zë të dhembshur e të butë që të mos e lëndoja.

Atë pjesë të rrugës që na kishte mbetur e bëmë pa folur. Ecnim pranë njëri-tjetrit si dy të panjohur. Diku, në njëfarë vendi, i thashë:

— Më fal, Goni, po nuk mund të bëj ndryshe...

— Më fal ti, Elvira. Do të mbetemi shokë, siç kemi qenë.

Unë u gëzova si fëmijë, sado që e dija se ajo që thoshte Goni nuk mund të vendosej aq lehtë e aq shpejt.

— Vërtet, Goni, do të mbetemi prapë shokë? — e pyeta.

— Kjo nuk ka diskutim, Elvira, sado që nuk e kam të lehtë.

Tani ai e kishte kaluar atë hutimin dhe tron-ditjen e fillimit. Ndonëse dukej i menduar, kishte një pamje tjetër, gjithë vendosmëri. I ramë në fund rrugicës dhe duhej të ktheheshim. Në të

vërtetë nuk duhej të ktheheshim, por të ndahe-  
shim. Ai tha: të ecim edhe ca. Dhe ecëm.

— A nuk ishte e mundur të mos ndodhte  
kështu, Goni? — e pyeta.

— Nuk ishte e pashmangshme, Elvira, — tha,  
— po ja që ndodhi.

— Unë qesha, se ai nuk dukej shumë i mër-  
zitur. Ndenjëm te një hli.

— Mirupafshim, Elvira, — më tha Goni duke  
më dhënë dorën.

— Mirupafshim, — i thashë.

Dora e tij qe akull e ftohtë. M'u duk sikur  
humba përgjithmonë një shok të ngushtë. Dhe  
humbja e një shoku nuk është gjë e lehtë. Në  
ato çaste e kam provuar më mirë se kurrë këtë  
që po them. Unë sapo kisha filluar t'i besoja  
asaj ndjenje të bukur sic është ajo e shoqërisë  
dhe ja tani besimi im kishte marrë një goditje të  
fortë, pikërisht nga ai që ma kishte krijuar kë-  
të besim. Arsyetoja me vete. Herë më dukej e  
pashmangshme ajo që ndodhi, por, disa çaste  
më vonë, e rrëzoja atë arsyetim dhe bindesha për  
të kundërtën... Kisha një rrëmujë mendimesh.

Të nesërmen, në punë shkova e vrarë dhe e  
lodhur. Natën kisha bërë një gjumë të keq dhe  
me shumë ëndrra. Shpresa e vuri re që isha e  
shqetësuar dhe më tha:

— Hë, moj, ndodhi ajo që të kam thënë, apo  
jo? Dje me Gonin rrinit të mërzitur.

Ajo sikur i tha këto fjalë me kënaqësi dhe  
ato çaste, të them atë të zemrës, iu zemërova, sado  
që e kisha dhe e kam shoqe të ngushtë. Kisha dë-  
shirë t'i thosha se midis meje dhe Gonit nuk  
kishte ndodhur asgjë nga ato që mendonte ajo,  
ndonëse në premtimin e tij nuk kisha shumë be-  
sim.

— Ndodhi, — i thashë ftohtë.

- Është e pashmangshme, — tha ajo.
- Skeptike, — i thashë.
- Shpresa qeshi dhe më përqafoi.
- Të thashë, moj motër, se djemtë janë të gjithë njëloj.
- Nuk janë njëloj të gjithë, — i thashë, — Goni nuk...
- Nuk e mbarova fjalën, se nuk dija ç't'i thosha.
- Le të bëhemi realiste, — filloi Shpresa të arsyetonte, — po t'i propozoje ti Gonit dhe ai të mos pranonte, siç bëre ti, do t'i mbaje mëri?
- Kësaj pyetjeje unë gjatë asaj nate i kisha dhënë një përgjigje dhjetëra herë me veten time.
- Nuk do t'i mbaja mëri, — thashë.
- Të besoj, — tha ajo disi e mallëngjyer. — Po ne, vajzat, jemi ndryshe...
- Si jemi?
- Falim më shumë ne.
- Këtu nuk ka asgjë për të falur.
- Ka, si nuk paska, — tha Shpresa. — Nuk të fal sedra e fyer e djalit. Ja, kjo është e gjitha.

Të nesërmen u ndodha në shëtitore përballë me Gonin. Më përshëndeti ftohtë, si një të njohur të largët. Po të mos kishte ndodhur ajo që tregova, ai do të sillej krejt ndryshe. Kjo gjendje midis nesh zgjati një dy muaj.

Por, për çudinë time, ai një ditë vjen dhe më kërkon në punë. Elvira, dua të bisedoj me ty, më tha. Dolëm nëpër rrugicën me pisha të oborrit.

— Ç'do të më thuash, Goni? — e pyeta kur e pashë se ai nuk po fliste.

— Pothuaj asgjë të re, — tha ai. — Atëherë as vetë nuk u besoja fjalëve që të thashë. Të premtova se do të mbetemi shokë, por në të vërtetë ka dy muaj e ca që ne përshëndetemi si

të njohur të largët. Po tani e mposhta sedrën e sëmurë, Elvira. Do të të kem shoqe, shoqe të ngushtë. Natyrisht, nëse edhe ti do të jesh dakord.

U gëzova shumë dhe i thashë Gonit:

— Po si nuk dashkam të të kem shok? Unë për këtë kam luftuar! Nuk pyeta fare se kishte njerëz në rrugë dhe çfarë do të mendonin ata, por i vura dorën në sup si vëllait.

— Unë këtë doja, këtë kam dashur, — ia përsërita prapë.

Dhe që nga ajo ditë kanë kaluar katër vjet. Goni tani është martuar dhe ka një vajzë. Ish-te dhe ka mbetur shoku im më i mirë.



## «Na zure ngushtë, kryetar!»

Parcela e madhe, gjer dje me grurë, tani, pas korrjes, dukej e kapiçur, si pas një lindjeje të lodhshme. Në fund të saj ishte mbledhur gruri. Makina shirëse punonte pa pushim: natë-ditë. Peizazhi matanë parcelës ishte i bukur, por njerëzit nuk e kishin mendjen tek ai. Ishte edhe kryetari i kooperativës, Dritani. Ai sapo kishte mbushur të tridhjetat. Kishte mbaruar për veteriner dhe, si kishte shërbyer tre vjet në profesion, e kishin zgjedhur kryetar. Ditët e para lodhej shumë dhe i dukej se nuk do t'ia merrte kurrë dorën punës. Tjetër ishte atëherë, kur ai kujdesej dhe përgjigjej vetëm për sektorin e blegtorisë dhe tjetër tani, kur duhej të përgjigjej për të gjitha. Apo nuk ishte kooperativë e madhe ajo e Shushajt! Pesëmbëdhjetë fshatra mblidheshin në katër sektorë. Sektori i parë me të katërtin ishin plot tri orë më këmbë larg njëri-tjetrit.

— E ndezim, kryetar?

Ai që pyeti, ishte Vledin Nuzi, një plak i vjetër.

— E ndezim, — tha Dritani.

U larguan mjaft nga makina shirëse e dolën nën hijen e një molle. Pranë tyre shkuan dhe

dy-tre pleq të tjerë. Me ta ishte edhe shoferi i gazit të kryetarit. Atë mbrëmje kryetari do të shkante në sektorin e katërt dhe gazi priste poshië në xhade.

— Kemi grurë, jo shaka, — tha Veledini.

— Kështu them edhe unë, — tha kryetari.

— Mirë ia bëre atij Sherifit, Rojë është ai, që ia këput me gjumë? — foli Veledini pas pak.

— Eh, — ia bëri kryetari si më dhembje.

— Shkoi për t'u ankuar, — tha shoferi për Sherifin.

— E ka atë të drejtë, — tha kryetari.

Dy net më parë kryetari e kishte gjetur Sherif Fidën, rojën, duke fjetur. «Nesër nuk je më rojë dhe ditë pune për këto dhjetë ditë që nuk do të marrësh», i kishte thënë kryetari. «Do të marr, si nuk do të marr», iu vërsul Sherifi. «Nuk kam fjetur dhjetë net, po veç sonte. Po as sonte nuk po flija.» «Nuk po flije, veç ia kishe këputur me gjumë,» i tha kryetari.

Të nesërmen u mblodh brigada dhe caktoi rojë tjetër për grurin. Roja ishte caktuar, kur erdhën pensionistët. «Ç'e duam rojën? — pyeti Veledin Nuzi. — Pak jemi ne pensionistët për të ruajtur grurin? Haram na qofshin lekët që marrim, po nuk ruajtëm grurin tonë...» Dhe ashtu u bë...

— Kryetar, po shkoj të marr një paketë, — i foli shoferi.

Kryetari hodhi sytë nga klubi sikur donte të maste largësinë.

— Mos u vono, se do të nisemi, — i tha.

— Për pesë minuta më ke këtu.

Veledini nxori qesen prej plastmase me duhan të verdhë dhe ia vuri kryetarit përpara:

— Dridhe një, kryetar, po mos e bëj të trashë, se është shumë i fortë.

Kryetari po dridhte cigaren, kur pa një grua që po vinte me vrap drejt lëmit.

— Lopa, lopa, — bërtiste ajo e alarmuar. Kryetarin nuk e linte zhurma e makinës shirëse të dëgjonte mirë.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti.

— Kryetar, — tha gruaja duke iu marrë fryma nga vrapi që kishte bërë, — po më ngordh lopa... Të lutem shumë, ti je veteriner.

Ishte gruaja e Sherif Fidës.

— Gjej veterinerin, — i tha njëri nga pleqtë gruas. — Kryetari s'ka kohë të rrijë pas lopëve, se ka punë të tjera.

Po kryetari u ngrit më këmbë. Ia bëri me shenjë shoferit që të kthehej nga rruga. Pas disa sekondave kryetari, gruaja e Sherifit dhe Velledini hipën në gaz.

— Mos qaj, — i tha gruas së Sherifit kryetari. — Ç'ka lopa?

— Nuk e di... e kisha në ahur... Kur e nxora për ta kullotur, nuk bëri as dy hapa dhe u rrëzua.

Pas dy minutash kishin mbërritur te shtëpia e Sherifit. Lopa ishte shtrirë në oborr. Dy fëmijë qanin rrotull saj, kurse Sherifi qëndronte më këmbë, i zverdhur e i bërë ftua në fytyrë.

— Ç'e gjeti? — pyeti kryetari për lopën.

Sherifi ngriti supet dhe nuk foli fare. Kryetari u përkul mbi lopën dhe e shikoi me kujdes në gojë.

— Është helmuar, — tha kryetari. — Nuk ka asnjë shpëtim. Vëri thikën, Sherif! Të bëhen analizat e mishit, mbase...

— Ç'thua, kryetar?! — u hodh Sherifi, — T'i vë thikën lopës?! Pse nuk më thua më mirë t'u vë thikën fëmijëve?! — Pastaj ai iu drejtua së shoqes dhe i tha: — Të thashë të gjeje

Verdiun. Ky është kryetar dhe nuk ka nge të merret me lopën tonë.

— Turp të kesh për këto që thua, — i tha Veleđini Sherifit.

— Turp, — i tha dhe e shoqja.

Kryetari bënte sikur nuk i dëgjonte fare ato fjalë.

— Lopa është helmuar, pas pak do të ngordhë, — i tha ai prapë gruas së Sherifit.

— Po ku u helmua kjo e shkretë?! — pyeti ajo. — E kam kullotur në meja, atje ku e kam kullotur çdo ditë.

Kryetari nuk foli. Hodhi përtokë xhaketën, që e mbante në dorë, dhe hyri me nxitim në ahur. Të gjithëve iu duk i çuditshëm veprimi i tij. U kthye me një thes plastmase, ku kishte diçka të bardhë.

— Ja, — tha ai duke treguar thesin. — Ka ngrënë pleh kimik lopa. Çdo gjë tani është e kotë.

— Vërtet në këtë thes ka pleh kimik, — tha gruaja. Ajo vështroi të shoqin me qortim sikur donte t'i thoshte «ti i bën këto punë të bukura», po nuk foli.

Lopa filloi të dridhej dhe, pas dy-tri minutash, ngordhi.

— Ju marrtë të keqen e fëmijëve, — i tha kryetari Sherifit dhe gruas që qante.

— Faleminderit, — tha gruaja përmes lotëve. Sherifi nuk foli fare.

Edhe kryetari u largua pa folur asnjë fjalë. Kur po hipte në makinë, i zunë sytë djalin e vogël të Sherifit. Ishte një vogëlush nja katër vjeç. Kaçurrelat e verdha i vareshin mbi ballë dhe sytë i ishin skuqur nga të qarët.

— Do të hipësh në makinë? — e pyeti atë kryetari.

Fëmija ngurroi një çast, pastaj qeshi përmes lotëve.

— Hip, — i tha përsëri.

Te qendra e kryesisë ishte ndaluar autoambulanca. Kryetarit iu drodh zemra kur pa të kunatin, vëllanë e gruas. Paska ardhur për Verën, tha me vete. Vera, e shoqja e kryetarit, nuk kishte fëmijë, ndonëse kishin dhjetë vjet martuar, sepse që në fillim të barrës dështonte. I vëllai i Verës, mjek gjinekolog, ishte marrë vesh që Verën kësaj radhe ta shtronin në spital që në muajin e parë.

— Eh, — ia bëri kryetari kur u takuan.

— Erdha për Verën, — i tha kunati.

— Më latë vetëm, ë?

— Nuk ke ç'të bësh, — tha tjetri me keqardhje.

— Pimë nga një kafe, — i tha kryetari.

— Nuk kam fare kohë. Duhet të nisem menjëherë, se vetëm këtë makinë kemi për urgjencat.

— Mirë, si ta keni punën.

Verën e morën nga spitali rural, ku ishte shtruar dy ditë më parë. Ishte me lot në sy.

— Mirë ardhsh, — i tha i shoqi, — mos u mërzit se do të vij të të shoh.

— Mërzitem për ty, se po të lë në pikë të hallit, — i tha gruaja me dhembje.

— Për mua mos u mërzit fare...

— Ti nuk di të mjelësh as lopën, — tha ajo dhe qeshi përmes lotëve. — Thirr Rabijen.

— Rabija ishte motra e të shoqit, martuar në fshat.

— Mos u bëj merak, — i tha ai gruas.

Autoambulanca u nis. Në kthesë Vera e përshëndeti të shoqin me dorë.

— Hajde të pimë një kafe, — i tha Veledinit kryetari.

Gazi u ndal dhe ata hynë në kafe. Ishte koha kur në klub kishte fare pak njerëz. Kryetari i mbushi djalit të Sherifit duart me karamelle dhe i tha të shkonte në shtëpi. Ai iku i gëzuar.

— Na bëj dy kafe, babë, — i tha kryetari banakierit.

Banakieri bëri tri kafe me pak. I zjeu mirë, siç e donte kafen kryetari. Ai, sa herë kishte kohë, gjente mundësinë të pinte një kafe me kryetarin. U ulën të tre në një tryezë pranë dritares. Shoferi po pinte një arançatë te banaku.

— E more vesh që Sherifit i ngordhi lopa? — e pyeti kryetari babën.

— Po, — tha baba, — mora vesh edhe fjalët që të tha...

— Ç'i do fjalët, babë. Nuk ngrenë peshë fjalët, — tha kryetari i mërziur. — Lopa ngordhi dhe unë nuk pata mundësi të bëja asgjë.

Baba e shikoi me përkëdhelje.

— Po thinjesh pak si shpejt, more bir!

— E, e, — tha kryetari sikur donte të thoshte: nuk ka rëndësi.

Pas dy ditësh, kur kryetari po shkonte në zyrë me përgjegjës të blektorisë, Liman Shelen, iu afrua Sherif Fida. Vetëm u tha një «tungjatjeta» e vazhdoi rrugën pas tyre. Kryetari mendoi se Sherifi mund të kishte punë me të, prandaj i tha:

— Mos ke gjë me mua, Sherif?

— Kisha një fjalë, shoku kryetar!

Tjetri u ndal.

— Po fol!

— Ta them në zyrë, — tha ftohtë Sherifi.

— Po ti mua do të ma thuash, apo zyrës?

— Nuk e hedh fjalën si lopa bajgën unë, kryetar!

— Mos e ke ngaqë jam edhe unë? Të iki para? — e pyeti Limani.

— Nuk e kam nga ti, por kam një hall që nuk thuhet rrugëve.

Sa vajtën në kryesi, kryetarit i dolën përpara përgjegjësi i sektorit të parë, brigadieri i brigadës së tretë të sektorit të katërt dhe mjaft njerëz të tjerë, që donin ta takonin për punë ose për ndonjë hall. Kryetari u jepte përgjigje me buzë në gaz dhe përpiquej t'i sqaronte sa më mirë. Kaloj mjaft kohë derisa ngjiti shkallët dhe u fut në zyrë. Sherifi e priste te dera.

— Hajde, Sherif, — i tha kryetari atij.

Sherifi qëndroi në këmbë në mes të zyrës, kurse Limani u ul.

— Ulu, Sherif. — e ftoi kryetari.

— Nuk kam kohë për t'u ulur. Për dy llafe që kisha, prita një orë, — tha ai qejfprishur.

— Ti vetë deshe të vije në zyrë. Ta kisha mbaruar hallin me kohë, ose, të paktën, të të kisha dhënë një mendje, — i tha kryetari.

Edhe pse në fillim nuk desh të ulej, Sherifi mori një karrige dhe iu afrua kryetarit.

— Ti e pe vetë ç'më ndodhi, — tha ai, — më mbetën fëmijët me kripë.

— E di, — tha kryetari.

Liman Shela, burrë pesëdhjetë vjeç, ia qepi sytë kryetarit. Ai e njihte më mirë se cilido këtë djalë, se kishin punuar bashkë për një kohë të gjatë, kur ai kishte qenë veteriner.

— Ç'do nga unë? — e pyeti kryetari Sherifin.

— Qumësht dua. Të më japësh një letër, ja,

për këtë Limanin, që ta marr qumështin çdo ditë nga stallat. Dy kile në ditë dua, me para në dorë.

Kryetari e shikoi me keqardhje.

— Më ke kapur ngushtë, — tha sikur të ishte fajtor. — Ka rregulla për shitjen e qumështit. Nuk mund të shitet drejt nga stallat. Lëre se, edhe po të duam ne, nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë. Te stallat nuk do të ketë më qumësht.

— Bile tufa e madhe ka shkuar në mal. Pak lopë kanë mbetur, — tha Limani për të plotësuar atë që tha kryetari.

— Po restorantin me se do ta furnizoni? — pyeti Sherifi.

— Me qumësht, — tha Limani.

— Hë pra, përse nuk më jepni mua qumësht?

— Ky qumësht vjen nga sektori i katërt. Vetëm atje do të mbeten ca lopë për furnizimin e tregtisë, për kopshte dhe për çerdhe. Po që këtu dhe atje mban tri orë të mira dhe ty, o Sherif, nuk të leverdis kjo punë, — e sqaroi kryetari.

— Atëherë të më mbeten fëmijët pa qumësht. ë?

— Pa qumësht jo, — tha kryetari, — blije në dyqan.

— Po pse ta blej në dyqan, gjysmë ore larg, kur i kam stallat te dera? — tha Sherifi.

— Nuk ke ç'të bësh, — foli Limani.

— Ty nuk të qajnë fëmijët për qumësht, prandaj më flet kështu, — u nxeh Sherifi.

— Nuk të ka hije të flasësh kështu, — i tha Limani.

— Ik, o Sherif, ik, — ndërhyri kryetari, — nuk do të t'i lëmë fëmijët pa qumësht. Po kjo që po të themi është e drejtë dhe kështu do të veprohet në të ardhmen io veç për ty, po për të gjithë. Ti e di se në mjaft kooperativa ka filluar tufëzimi i bagëtisë dhe në disa është bërë i plotë. Edhe te



ne një gjë e tillë do të bëhet, se është për të mirën tonë. Qumësht do të ketë në dyqan sa të duash dhe shkojmë e blejmë ti, unë dhe kushdo tjetër...

— Po ai tufëzimi, kur të bëhet, bëhet për të gjithë, kurse sot për sot vetëm mua më mbetet ibriku në dorë për qumësht, — tha Sherifi.

— Mirë, mirë, do ta shikojmë, — tha kryetari.

Sherifi doli nga zyra duke e tërhequr derën ngadalë. Doli me mosbesim. Për një çast kryetari dhe Limani shikuan njëri-tjetrin.

— Ky nuk meriton asnjë nder, kryetar, — foli Limani për Sherifin. — E mora vesh se ç'kishite thënë për ty kur iu sëmur lopa dhe më erdhi çudi. Të arrijë burri deri aty, sa të dyshojë që kryetari nuk do t'i shërojë lopën?! Kjo është e çuditshme, bile e poshtër... Për nder, për disa njerëz... Por e ke zemrën të madhe ti... Ja, e pushove si rojë dhe të bëri hasm... Po hak e bëri pushimin, nuk ia bëre nga inati... Demek, për disa njerëz di unë, po të kem gjë në dorë...

— Mirë, or Liman, mirë, ai flet si Sherif, por ne nuk duhet të mendojmë dhe të flasim si ai. Duhet të jemi të ndershëm e të drejtë, se jemi komunistë dhe kuadro, na ka besuar Partia që të drejtojmë popullin. Tjetri nuk mendon që ia bëri këtë apo atë padrejtësi Limani apo Dritani. por thotë, ja, kështu ma zgjidhi këtë hall kryesia. Duhet të kemi zemër të qëruar, Liman.

Limani nuk foli, ai ra në mendime.

Në mbrëmje Rabija erdhi për të mjelë lopën. Po fuste kusinë me qumësht në qur, kur kryetari hyri brenda.

— E, Rabije, e mole lopën? — e pyeti ai të motrën.

— Po, — tha ajo. — Mund ta ziesh vetë qu-mështin?

— E ziej, — tha kryetari. — Nesër mos hajde as për ta mjelë, se do ta mjel vetë.

— Mirë, — i tha ajo, — si të duash. Po kur qenke bërë kaq i zoti ti?

Ai qeshi dhe nuk i foli asnjë fjalë.

Lopa përtypej në oborr, te ftoi. Doli hëna, një hënë e plotë, që ndriçonte shumë. Kryetari e zgjidhi lopën dhe e vuri të hante në mejën e arës. I shkante pas duke i mbajtur litarin. Shkoi kësh-tu duke kullotur lopën deri afër shtëpisë së Sher-ri-fidës.

— Mbetë me lopë për dore, kryetar, — i tha atij e shoqja e Sherifit. — Ju burrat nuk ua dini kimetin grave.

— Ua dimë, si nuk ua dimë?! — foli kryetari.

— Kur nuk i keni, ua dini, — tha ajo.

Kryetari qeshi.

— Sherifi brenda është? — pyeti pas pak.

— Po.

— I thuaj të dalë, të pimë nga një cigare. Është natë e bukur dhe nuk ta ka ënda të futesh brenda.

Gruaja i thirri dhe Sherifi doli me njërin nga djemtë e vegjël. Ishte ai djali që kryetari e kishte hipur në makinë dhe i kishte dhënë karamele.

— Po hajde brenda, kryetar, — i tha atij Sher-ri-fidës. — Lopën e mban djali.

— Rrimë përjashta, Sherif. Është natë e bu-ku-ur.

— Si të duash, — tha Sherifi dhe u ul. — Mbaje lopën, — iu drejtua ai djalit të vet.

U ulën te trangu i qershisë së re. Domatet, që ishin gati në të pjekur, lëshonin një erë të mirë. Ndërruan kutitë e duhanit dhe drodhën nga një cigare.

— U lodhe sot, — e pyeti Sherifi.

— U lodha ca, — tha kryetari. — Po lëre lodhjen e punës, se me të u mësua, po hallall mos qoftë kjo, — dhe ai ktheu kokën nga lopa. — Që kur iku Vera në spital, kam rënë ngushtë me këtë. Nuk di nëse ke mundësi të ma mbash ti derisa të vijë gruaja nga spitali. Ja, vjen çobani ta marrë, unë nuk jam aty, e sjell, prapë nuk jam aty. Për të mjelë, nuk e mjel dot. Shkurt, kam rënë në hall. Do më bësh një nder që s'di si të të them, po të ma mbash. Ti ke plot njerëz dhe kujdesen për të...

Sherifi ia nguli sytë kryetarit.

— Nuk po të marr vesh, o kryetar, — foli ai pas pak. — Mos do ta zgjidhësh kështu atë kërkesën time për qumësht?

— Ku të vete mendja edhe ty, bre Sherif! Nuk po ta fal lopën. Pas disa muajsh do ta marr prapë. Nëse dikush i bën nder shokut në këtë rast, ai je ti. Kështu rregullohemi të dy, por, të thashë, nder më bën ti.

— Ngushtë më ke zënë, kryetar, — tha Sherifi duke buzëqeshur i kënaqur.

— Dëgjo, Sherif, — foli kryetari. — Unë nuk po përpiqem të zgjidh hallin tënd, se hallet e popullit nuk zgjidhen në këtë mënyrë. Do të vijë koha që, edhe po nuk pate lopë, qumësht do të kesh. Ta thashë edhe atë ditë. Në mjaft kooperative tufëzimi është bërë dhe të mira të mëdha do të na vijnë prej tij.

— Po fol, o kryetar, të lumtë ajo gojë, — tha Sherifi i ngazëllyer. — Atë ditë, të them të drej-

tën, i kisha hipur gomarit nga bishti dhe më vjen turp kur e kujtoj.

— Do të tufëzohen bagëtia, o Sherif. Do të krijohen tufa të përbashkëta. Kjo ka shumë të mira. E para, do të mbeten shumë krahë pune për të punuar në fushë, se ti e di, bagëtia do njerëz, kështu, nga një kokë e nga një kokë, siç e kemi ne tani... Një lopë po të kesh, e do njeriun pas bishiti. Po do të thuash ti se i ruajnë fëmijët, po edhe fëmijët do të jenë të lirë dhe të merren më shumë me mësimet.

— Po mirë, bre kryetar, — e ndërpreu Sherifi nga dëshira për të mësuar, — po ku do të hajë gjithë ajo tufë lopësh, fjala vjen, se ja, kur e ke kështu, tënden, një kashtë këtu, një aty, e bën idare, siç thonë...

— Po edhe tani në tokë të kooperativës hanë, edhe atëherë në tokë të kooperativës do të hanë... Veç do të tregohet kujdes edhe për rritjen e përmirësimin e bazës ushqimore. Tufa e përbashkët do të trajtohet mbi baza shkencore dhe jo kështu si sot.

— Grua, na piq nga një kafe, — iu drejtua Sherifi së shoqes. — Mirë, o kryetar, po ja, ta zëmë, unë kam dasmë dhe dua të ther një dele a ç'të kem, si i bëhet hallit në këso rastesh? A mund ta marr nga tufa e përbashkët?

— E merr kur të duash, — tha kryetari. — Po, kur delja e mëshqerra jote janë për mbarë, atëherë kooperativa të jep mish nga bagëtitë që janë për t'u skartuar.

Sherif Fida kishte edhe një pyetje. Dhe kjo ishte më konkrete se lidhej drejtpërdrejt me hallin e tij. Tha:

— Po unë, që nuk kam lopë, si t'ia bëj?

— Ta blesh, — tha kryetari. — Për dy arsye:

e para, tufëzimi nuk do të bëhet sot, e dyta, edhe kur të bëhet, ke leverdi ta kesh lopën në tufën e përbashkët. Tufëzimi bëhet për të mirën tonë, bre Sherif.

— Të lumtë ajo gojë, — tha Sherif Fida disi i mallëngjyer. — Çfarë nuk tha Partia dhe nuk na doli për mbarë, o kryetar.

E shoqja e Sherifit solli kafet dhe ata i pinë duke kuvenduar për të ardhmen.

## P È R M B A J T J A

<b>PËLLUMBI PËRPLASTE KRAHËT NË AJËR</b> .....	3
<b>ZBUTËSI I KANUNIT</b> .....	11
<b>NUK MJAFTOJNË VETËM ARKIVAT</b> .....	22
<b>NJOHJE</b> .....	32
<b>MELODIA E MALIT</b> .....	46
<b>DRITA E NJË MBRËMJEJE</b> .....	55
<b>NJË KRAH JONXHË</b> .....	69
<b>ROTI</b> .....	77
<b>NAFIJA</b> .....	88
<b>ZËNKË BURRASH</b> .....	98
<b>BIRI I DASHUR I FSHATIT</b> .....	108
<b>ZOGU I VOGËL</b> .....	115
<b>FYTRA E MIQËSISË</b> .....	126
<b>«NA ZURE NGUSHTË, KRYETAR!»</b> .....	136